
Tekstet e meditimit mbi një perandori të frikësuar	4
Ballkani global	3
Darfur-Sudan	5
Një studim mbi konvertimin e danezëve në Islam	7
Jeta pa fe është projekt pa garanci	8
Kohë e humbur?!	10
Shenjat e besimit të dobët	11
Ule shikimin!	12
Sipas veprës edhe shpërblimi (mbi zinanë)	17
Kur të humbë amaneti, prite kijametin	19
Komponentet e personalitetit islam	24
Kur'ani fisnik, sfidë dhe mrekulli	38
Istiadhe dhe istigathe	44
Kur një vlla kujton për motrën!	46
Edukoni ate që edukon djepin!	46
Shmangje nga bisedat e kota	47
Të drejtat politike të grave	47
Imam Kurtubi	49
Imam El-Lejthi	54
El Hafidh el-Iraki	55
Tema: Kurani	57
Një sqarim nga dy hadithe	60
13. Durimi	61

Muaji Rexheb

Veçimi i muajit Rexheb me namaz regaib, ose festimin e natës së 27, duke menduar se në këtë natë ka ndodhur israja dhe miraxhi, krejt këto janë bidate që nuk vlejnë dhe nuk kanë bazë në sherijat. Këtë e kanë treguar dijetarët e mëdhenjë, kurse ne kemi shkruar disa herë dhe ua kemi bërë të qartë njerëzve se namazi regaib është bidat (adhurim i shpikur), domethënë namazin që e falin disa njerëz në natën e parë të muajit Rexheb. Po e njëjta vlen edhe për festimin e natës 27, duke u nisur nga besimi se në këtë natë ka ndodhur Israja dhe Miraxhi. E tërë kjo është bidat dhe nuk ka bazë në sherijat. Nuk e dimë se kur ka ndodhur Israja dhe Miraxhi në mënyrë të saktë, po edhe po ta dinim nuk do të lejoheshte festimi i asaj dite, sepse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk e ka festuar, poashtu edhe halifet e drejtë, e sahabet e tjerë. Po të ishte kjo sunnet, do ta bënin ata para nesh.

E tërë mirësia është në pasimin e tyre dhe ecjen rrugës së tyre, ashtu siç thotë All-llahu, subhanehu ve teal: “All-llahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhennete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh”. (Et-Teube: 100).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në një hadith të vërtetë ka thënë: “Kush shpik në çështjen tonë gjëra që nuk janë të saja, ato janë të refuzuara”. (mutefekun alejhi).

Poashtu thotë: “Kush ban ndonjë vepër, jashtë çështjes sonë, ajo është e refuzuar”. (Muslimi).

Ibën Baz

Albislam.Com nr.1

Marrë nga: “Ed-Davetu”, nr. 1566, Xhemadul-Ahire, 1417

edicion i botuar / viti i dytë / nr: 13

kryeredaktor: Ramadan Ramadani

redaksia: Bekir Halimi, Talha Kurtishi, Alajdin Idriz

Fatmir Zaimi, Agim Bekiri

www.albislam.com

albislam@albislam.com

str: 386 no: 11 lokal: 44

1000 Shkup

fax: +389 2 3290 408

Balkani global

E vjetër është tendenca e planifikuesve të politikës strategjike përbrenda pushtetit amerikan që ta bëjnë Amerikën ta udhëheqë botën, të dominon me resurset e energjisë në te, ta përhap ushtrinë e vet në çdo vend dhe ta formulon civilizimin botëror. Këtë e konfirmon njëri prej planifikuesve më të dukshëm, e ai është Zbigniew Brzezinski.

Ai shpreh pëlqimin e tij për politikën e futjes së Bashkimit Sovjetik në "kurthën" afgane duke e ndihmuar rebelimin dhe rrjetet islamike...

Në librin e tij të ri ai ofron shikim apokaliptik për kaosin botëror duke potencuar se Sh.B.A- të duhet ti japin fund këtij kaosi. Por ai nuk pajtohet me metodën e Bushit.

Ky demokrat liberal e kritikon Shtëpinë e Bardhë për shkak të manisë "anti terroriste" dhe veprimtarisë unilaterale. Ai e dallon veten nga devijimi i cili kundërshton Islamit dhe thërret në një "grumbull shtetesh me interes të përbashkët", të cilën e udhëheq Amerika, por që nuk e sundon.

Brzezinski e mban përqendrimin në kontinentin euro-aziatik[1] në mesin e të cilit qëndron ish BRSS, i cili është "boshllëku i zi" i madh, edhe përskej rrezikut dhe thesareve të mëdha që i ka poseduar. Sipas mendimit të tij duhet të shpiket ndarje definitive mes Ruisë, e cila nuk ka humbur natyrën sovjetike dhe Ukrainës, ashtu sikurse duhet larguar Ruisë nga "Ballkani Euro-Aziatik" (nga Kaukazi e deri në Azinë e mesme), të cilët duhet ta eksportojnë naftën jashtë dominit

të kësaj.[2]

Me sigurimin e Kaukazit, nëpërmjet NATO-së dhe dobësimin e Ruisë, arrihet barazpesha gjeo-strategjike në interes të Amerikës. Kërkohet çlirimi i disa republikave të Kaukazit verior. Ato "Yje të fortifikatave latine nën ndikimin rus".[3]

Atëherë ka mundësi që ish Azerbejxhani sovjetik dhe Irani të bashkohen.

Nga libri në libër Berzezinski e përforcon idenë e tij të gjërë dhe të qartë, e cila është e boshatisur prej kompleksit dhe kamuflazhave morale.

Në librin e tij të fundit paraqet natyrën shumë të rëndësishme të "gravitacionit kulturor të Sh.B.A-ve", e cila paraqet "rrugën e jetës" dhe kulturën populiste amerikane në praninë ndërkombëtare, aq sa që nuk mund të rezistohet dhe nuk mund të pengohen gjeneratat e reja rinore nga dëshira për ti përvehtësuar ushqimet e gatshme (fast food), Holivudin, gjuhën amerikane, markat (të prodhuara në Amerikë), të cilat kanë ndikim më të madh se sa përhapja politike dhe ajo ushtarake.

Autori ka frikë nga animi luftarak te përgjegjësit momental në Washington, të cilët ndoshta do ta sjellin këtë perandori në përrëndim. Andaj kërkon me të madhe që të dominohet mbi "Ballkanizmin e botës".[4] Për të arritur këtë duhet koordinuar Sh.B.A-të me NATO-në dhe Unionin Europian, nën një aleancë Euro-Atlantike, demokratike dhe përhapës së virusit.

[1] Euro-azia, sipas autorit kaplon Europën, ish Bashkimin Sovjetik, lindjen e largët, domethënë 75% të banorëve të botës dhe dy të tretat e prodhimit.

[2] Zbigniew Brzezinski, *Le Grand échiquier. L'Amérique et le reste du monde*, Bayard, Paris, 1997.

[3] Brzezinski është koordinatori i këshillit për paqë në Çeçeni dhe pjesmarrës në planin "Ahmadov" për ta venduar Çeçeninë nën juridiksionin e Kombeve të Bashkuara si hyjre në pamvarësi.

[4] Kjo nënkupton edhe "Ballkanin Evro-aziatik" dhe lindjen e mesme.

Përktheu: B. H.

Marrë nga: mondiploar.com

Jean – Marie CHAUVIER,

30.7.2004

Tekstet e meditimt mbi një perandori të frikësuar

Shkaqet për ta kritikuar administratën e Bushit janë të shumta, siç tregojnë ndodhitë që nga 11 shtatori i 2001-it. Mirëpo nuk është lehtë çdo herë sjellja e kritikave në tregun e publikimit francez;

Shumë intelektual dhe botues francez në armiqësinë kundër Amerikës shohin anim nga e majta ekstreme (refuzues i kapitalizmit) ose e djathta ekstreme (refuzues i demokracisë). Dyshimi në diplomacinë amerikane qortohet në emër të ineteresave madhore, aleancës demokratike dhe domosdoshmërisë së ecjes pas Washingtonit në luftën kundër terrorizmit.

Ata që refuzojnë kritikën i këshillojmë të lexojnë katër libra, të cilat dallojnë për nga gjuha dhe personalitetet që i kanë shkruar ato libra, mirëpo që të gjitha arrijë në një rezultat: Xhorxh Bushi udhëheqë diplomaci e cila nuk është në interes të Sh.B.A-ve, as në planin afatgjat e as në atë afatshkurtë.

Zbigniew Brzezinski, politikolog, "realist", të cilin nuk mund ta akuzojnë se është ithtar i qetësimt; Xhorxh Soros, kapitalist botëror, të cilin është vështirë ta rendisim në anën e armiqve të kapitalizmit; Benjamin Barber, profesor univerzitar opozitar dhe kinemaistin dhe dokumenataristin e njohur Majkl Mur. Të gjithë këta pajtohen në konkluzat e rreziqeve dhe reagimeve negative që i bart sjellja ndërkombetare e Washingtonit pas 11 shtatorit, 2001.

Brzezinski forcën amerikane e konsideron si garancën më të madhe ndërkombëtare [1], mirëpo Bushi, sipas mendimit të tij nuk ka ditur të përthekon rezultatet e globalizmit, që prej domethënies të veta ka edhe ndërlikojnë reciproke në rrafshin botëror. Nuk ka imunitet të veçantë asnjë shtet përballë revolucionit teknologjik, i cili e shumëfishoi mundësinë e njeriut për të përdorur dhunën. Ai konfirmon se urrejta e arabëve buron nga përkrahja amerikane dhe në Izraelit dhe se kjo ndjenjë është përhapur edhe në vendet islamike joarabe.

Xhorxh Sorosi është edhe më i ashpër, ai e akuzon Bushin se ka keqpërdorur me qëllim ndodhinë e 11 shtatorit për të pasuar një metodë politike, të cilën amerikanët nuk do ta pranonin në ambient tjetër. [2]

Ëndërra për epërsi botërore nuk mund të realizohet dhe është në kundërshtim me principet e Sh.B.A-ve. Ajo i rrënon vlerat dhe sigurinë nacionale, kurse mbarë botën e rrezikon, duke patur parasysh peshën dhe fuqinë e Sh.B.A- së.

Sorosi potencon fuqishëm: "Kjo nuk është ajo Amerikë që e kam zgjedhur të jet vendbanimi im".

Një pjesë shumë e vogël e 160 miliard dollarëve që janë varosur në Irak do të mund të realizonin shtytje përpara nëse shfrytëzoheshin pozitivisht, sidomos në sferën e edukimit.

Benjamin Barbari publikon kundërthëniet, të cilat e shtojnë Washingtonin që të ndih-

mojë totalitarizmin në një shtet që e emërtonte si mike dhe dëshiron t'ua imponon demokracinë me fuqinë e armëve armiqve që s'kanë as mundësi e as fuqi.

E kritikon ashpër iluzionin që thotë se tregjet e privatizuara dhe konsumimi i shtuar dhe i lirë nga çdo përkufizim demokratik është mjet të cilin e prodhon demokracia.[3]

Duke patur parasysh mënyrën e gëzuar dhe përbuzëse, libri i Majkl Murit[4] zbulon

perden nga marrëdhëniet mes administratës së Bushit, Saudisë dhe familjes së Bin Ladenit, ashtu sikurse mohon të nxitet tërë ajo zhurmë rreth "çështjes së Monika Levinskit" e mos ti jepet rëndësi të madhe kësaj politike luftarake, të cilën është duke e kultivuar Bushi, e cila është shumë më e rezikshme për Sh.B.A- të se sa sjellja personale e Klintonit.

[1] Zbigniew Brzezinski, *Le Vrai choix*, Odile Jacob, Paris, 2004, 310 pages

[2] George Soros, *Pour l'Amérique contre Bush*, Dunod, Paris, 2004, 232 pages

[3] Benjamin Barber, *L'empire de la peur*, Fayard, Paris, 2003, 280 pages

[4] Michael Moore, *Tous aux abris*, La Découverte, Paris, 2004, 310 pages

Pascal BONIFACE

Përkthyer nga versioni arabisht i "Le Mond diplomatique"

Përktheu: B. H.

Darfur-Sudan

Udhëheqës me influencë të organizatave evangjeliste të SHBA-së kanë nënshkruajtur një letër, në të cilën kërkojnë nga presidenti Bush që të ndërmer akcion ushtarak kundër Sudanit, pasi që qeveria e Sudanit tha se është e gatshme që ta ndaj fuqinë dhe pasurinë me "rebelët" e Darfurit.

"Tani është koha që Shtetet e Bashkuara të marrin një rolë më vendimtar për ndalimin e masakrave dhe vrasjeve", shkruan në letërën e nënshkruajtur nga 35 udhëheqës të organizatave evangjeliste të cilat së bashku kanë diku reth 50 milion anëtarë, publikuar nga agjencia Reuters më, 4 gusht.

Ata u ankuan se rezoluta e Kombeve të Bashkuara për Darfurin nuk ka shkuar aq larg, sa që të kërcënohet me intervenim ushtarak kundër Sudanit.

"Kjo administratë duhet ta kuptojë se gjendja në Darfur është shumë serioze", tha Richard Cizik, anëtar i Shoqatës Nacionale të Evangjelistëve.

"Nga këndvështrimi moral, ne nuk mund të rrimë duarkryq dhe të frikësohemi për pasojat e intervenimit, kur pasojat e mosintervenimit janë të mëdha" shtoi ai.

Ky mesazh bën presion ndaj presidentit Bush dhe përpjekjet e tij për të fituar në këto zgjedhje, meqë evangjelistat janë pjesë e bazës së tij politike.

Organizata Botërore Shëndetësore dhe "Doktorët pa kufij" më herët, i kanë kundërshtuar raportet e mediave perëndimore për vrasjet masive dhe dhunimet në Darfur, duke i konsideruar këto reporte si kampanjë propaganduese.

Ndërrimi i ngjyrës

Në mesin e atyre që kanë nënshkruajtur ishin udhëheqësit e disa sekteve krishtere, siç janë Asambleja e Zotit dhe Kisha Nazeriane. Poashtu edhe udhëheqësit e Shoqatës Nacionale të Evangjelistëve, Aleancës Botërore të Evangjelistëve dhe disa shkolla, organizata bamirëse dhe botuese evangjeliste.

“Ne këtë e shohim si një shansë që të depërtojmë në mesin e muslimanëve në emër të krishtit” është citat nga udhëheqësi i Shoqatës Nacionale të Evangjelistëve Ted Haggard, i cituar nga Washington Post.

“Të krishterët janë tmerruar nga ky lloj gjenocidi, dhe ne nuk duam që kjo të ndodh në gjeneratën tonë” shtoi ai.

Kjo letër shënon ndërrimin e qëndrimeve të organizatave evangjeliste të SHBA-së, të cilat janë munduar me vite ta zgjidhin problemin në mes të qeverisë islamike në Sudan dhe krishterëve të Jugut.

Kjo letër erdhi disa ditë pasi një ekspert Sudanez tërhoqi vërejtjen nga një “vërshim” i misionarëve krishterë të cilët do të hynë me maskën e organizatave humanitare nëse ndërmiret intervenim ushtarak në këtë regjion ku shumica e popullatës janë muslimanë.

Në vitin 2000, mediat kanë raportuar se grupe misionare Amerikane kanë hapur “Institutin për studime Islame” dikund në Amerikën Latine që të mund të mësojnë për islamin e pastaj t’i pushtojn vendet islame e të mundohen t’i konvertojnë në të krishterë.

Disa studiues kanë frikë se intervenimi ushtarak në Sudan ka për qëllim që ta dobë-

soj rolin e mbetjes së identitetit islam në Darfur, ku nuk ka krishterë e as kisha. Sudani jugor nuk ka më shumë se tre milion krishterë edhe pas valëve masive të konvertimit që filloi që në vitin 1919.

Ndarja e forcës

Kjo erdhi pasi i dërguari special i Kofi Ananit, Jan Pronk tha se sigurimi në kampet e Darfurit është përmirësuar.

Qeveria e Hartumit gjithashtu ka ndërmar hapa për përmirësimin e sigurimit dhe lejimit të refugjatëve të kthehen në Darfur.

Sudani ka ndërmend ta rrit numrin e policëve në Darfur prej 5000 në 6000 dhe të dërgon më shumë trupa.

Qeveria gjithashtu shpreh gatishmëri që ta ndaj forcën dhe pasurinë me “rebelat” e Darfurit.

“Ne jemi të gatshëm të ndajmë forcën dhe të ardhurat në Darfur, në jemi të gatshëm për federalizim” tha për AFP-në ministri i informatave Al-Zhaëi Ibrahim Malik.

“Ne jemi të gatshëm që të arrijmë marrëveshje, siç kemi vepruar në zgjidhjen e problemit në Sudanin Jugor” tha Malik duke i referuar bisedave paqësore në mes Ushtrisë Popullore Çlirimtare të Sudanit dhe Kenisë me qëllim të dhënies fund luftës civile dy dekadëshe.

Këshilli i Sigurimit i KB e ka miratuar rezolutën të premtën e kaluar duke i dhënë Hartumit afat prej 30 ditëve që t’i çarmatosen formacionet paramilitare, në të kundërtën do të ketë sanksione kundër Sudanit.

Marrë nga: Islam Online.net
Përktheu: Omer Islami
6.8.2004

Një studim mbi konvertimin e danezëve në Islam

Nga dy hulumtues është kërkuar të zbulojnë pse 3.000 deri në 5.000 danez etnik janë konvertuar në fenë islame vitet e fundit. Këta dy hulumtues kanë filluar një studim në shkallë të lartë për të nxjerrë një përfundim në pyetjen se pse mijëra etnik danez me vetdëshirë janë konvertuar në islam që nga viti 1990.

Megjithëse nuk ka një numër ekzakt të figurave të të konvertuarve danez në islam, hulumtuesit nga projekti "Islamic Conversion in Denmark" thonë se numri i tyre është përafërsisht midis 3.000 deri në 5.000 vetë.

Hulumtuesit kanë bërë intervista kualitative me disa qindra danez të konvertuar dhe janë duke shpresuar që një pyetsor që do ti shpërndahet 500 të konvertuarve do të hedh dritë mbi motivet e tjera për konvertimin në fenë muslimane.

Tina G. Jensen, PhD, e Institutit Antropologjik të Danimarkës, ka bërë studime në këtë fushë dhe i ka ofruar gazetës ditore Jyllands-Posten mendimin e saj mbi këtë: "Unë mendoj që shumë njerëz ndjejnë që një farë religjioziteti është i mangët në jetët e tyre ditore. Angazhimi fetar është i konsideruar si jashtë mode në shoqërinë tonë. Njerëzit gjithmonë kanë pretenduar se feja është në rënie në shoqëritë moderne dhe laike por ajo sa po ka marrë forma të tjera. Islami është një nga fetë më të mëdha në Danimark, e dyta pas krishterimit dhe ofron një sens fetarë komuniteti dhe gjithashtu edhe më tepër vlera tradicionale" ka shpjeguar Jensen.

Kërkesja e përshkroi konvertimin danez në islam si një lloj tjetër integrimi. "Danezët aktualisht kanë përqafuar fenë dhe kulturën e emigrantëve. Të rinjtë, në veçanti ata të moshës midis 15 dhe 30 vjeç, janë duke u konvertuar. Këta janë shpesh shumë reflektiv, të edukuar mirë për të cilët konvertimi ka qenë një mjet për

të qenë një person modern dhe që aktivisht t'i përkasë një feje. Konvertimi mund gjithashtu të jetë një ndëshkim kundër botës moderne në të cilën botë gjërat janë të paqëndrueshme, vlerat janë të shëmtuara dhe asgjë nuk është e sigurtë" ka thënë Tina Jensen.

Imami Abdul Vahid Pendersen u kthye në islam para më tepër se 12 vjet. Në atë kohë, ai ka njohur 15-20 danez në të njëjtën situatë por ka shënuar disa shkaqe për interesin në rritje për islamin. "Një arsye është që ne kemi një gjeneratë të tërë të të rinjve në Danimark të cilët janë rritur përkrah muslimanëve" ka thënë Abdul Vahid Pedersen.

Është kjo një influencë reciproke. Ndërsa shumë të lindur dhe të rritur muslimanë nuk e ndjenjë si diç të veçantë afërsinë ndaj fesë, jo-muslimanët janë të thelluar në bindje të fuqishme fetare të fesë. Ka gjithashtu çështje të zemrës që veprojnë-disa njerëz bien në dashuri me fenë e dikujt tjetër" ka thënë Pendersen.

Tina G. Jensen dhe Abdul Vahid Pendersen kanë thënë se kanë parë çështje më çështje konvertimin e danezëve në islam në prag të kritikimit masiv të fesë. Shumë njerëz lexojnë Kur'anin vetëm për të parë se a është aq i keq sa thuhet. "Përqëndrimi madhor në islam ka një efekt ngjites madje përkundër asaj se shtypë në përgjithësi është negativ ndaj tij. Njerëzit eksplorojnë fenë sepse ata duan të dinë se çfarë është ajo që tërë bota nga ajo është e frikësuar" ka thënë Abdul Vahid Pendersen.

Projekti i kërkimit i udhëhequr nga PhD Tina G. Jensen dhe Kate Ostergaard është i financuar nga Këshilli i kërkimeve humanitare të shtetit (danez sh.r.) dhe është thënë se do të përfundojë në vitin 2006.

Marrë nga: "The Copenhagen Post"

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

13.8.2004

Jeta pa fe është projekt pa garanci

Po të shiqojmë historinë e njerëzimit dhe sa do larg që të kthehemi në periudha të ndryshme kohore, gjithnjë do të hasim gjurmë të mendimit fetar. Religjioni është cilësi universale e qenies njerëzore. Nevoja për fenë (besimin) është e rrënjësuar në kushtet themelore të egzistencës së gjinisë njerëzore. Nuk është njeri i kompletuar dhe i plotë ai që nuk ndalet në jetë, të paktën një herë e të pyes: "Çështë esenca e jetës", "Kush jam unë"? "Nga vij dhe nga do të shkojë"? "Çështë qëllimi i egzistencës"? dhe "Kush më krijoi?!

- Jeta pa Fe (besim) është projekt pa garanci dhe aventurë pa përfitim. As begatia e jetës nuk mund të jetë asnjëherë e barabartë me begatinë e fesë (besimit), e cila na ofron ngushëllim dhe ndihmë në të gjitha vështirësitë e kësaj bote dhe botës tjetër. Feja paraqet një sistem jetësor, dhe na paraqet në fakt se në këtë botë nuk jemi të huaj, të braktisur dhe të flakur tej, por... që të njihemi me Zotin e Botës dhe të pajtohemi me Të. Lënda e fesë është ajo që përfshin dhe mbulon besimi në: Zotin e Gjithëfuqishëm, të Përrjetshëm, të Drejtë dhe të Mëshirshëm, të Cilit i përkasim të gjithë ne dhe tek te i Cili të gjithë do të kthehemi në përjetësi. Nuk përfundon çdo gjë me vdekjen fizike në këtë botë! Sepse, po të ishte kështu, cili do të ishte kuptimi dhe qëllimi përfundimtar i kësaj jete kalimtare, në të cilën realizimi i drejtësisë nuk arrin as në gjysmë të rrugës.

-Feja e individit është besimi (iman), ndërsa feja si sistem shoqëror është Ligj i Zotit

(Sheriati). Në Islam feja dhe shkenca, besimi dhe arsyeja qëndrojnë përballë njëra-tjetrës. Zoti i dhuroi njeriut dy libra, Kur'anin dhe universin, i pari është fjala, kurse i dyti krijimi i Tij. Nuk egziston kontradiktë ndërmjet tyre. Nuk është e drejtë të mendohet se njeriu në fillim ishte i padijshëm i egër, dhe idhujtar, e se vetëm pas një kohe njeriu filloi të heqë dorë nga këto bestyturi dhe të besoj në një Zot të Vetëm. Besimi i njeriut nuk ka evoluar nga idhujtaria dhe poiteizmi drejt besimit në një Zot dhe monoteizmit. Përkundrazi ka pasur degradim të njeriut i cili është larguar nga besimi në Zotin e Vërtetë dhe është dhënë pas idhujtarisë, politeizmit dhe ateizmit. Prandaj, çështja nuk qëndron në prirjen e njeriut drejt të besuarit, sikurse është shkruar në librat e historisë të fesë të përpiluara nga jobesimtarët. Kjo është prirje e lindur tek njeriu dhe e natyrshme. Por përkundrazi duhet kërkuar pse njeriu ka devijuar dhe anuar kah idhujtaria, materializmi, ateizmi.

Njeriu përbëhet nga dy komponente ai shpirtëror dhe ai material. Që të mund të jetojë normalisht në këtë botë, ai duhet të rruajë baraspeshën në mes tyre, dhe sa herë që favorizon njërin prej tyre do të pësojë tronditje, trazim dhe humbje. Vetëm përmes bindjes ndaj Zotit dhe zbatimit të Ligjit të Tij, njeriu mund të arrijë paqe të vërtetë me vetëvetën, shoqërinë, natyrën dhe Krijuesin. Jeta e njeriut ka kuptim të plotë vetëm përmes fesë. Pa besim jeta është absurde dhe e zbrazët. Feja shpie drejt përsosmërisë dhe përmbush nevojat fizike e shpirtërore të njeriut.

Ateizmi (Mosbesimi) e kundërta e fesë (besimit) është doktrinë mohuese, sepse ai është i ngritur mbi bazën e mohimit dhe mospranimit të Zotit. Ateizmi është mohim i vlerave hyjnore dhe mbulim i së Vërtetës me të pavertetën. Ideologjitë ateiste zënë vendin e parë në listën e ideologjive që i kanë shkaktuar njeriut luftëra, vuajtje dhe fatëkeqësi shpirtërore. Vetëm të cekim ca shembuj prej tyre si Stalini, Lenini, Mao, Fidel Kastro, Enver Hoxha të cilët me idetë e tyre ateiste kanë shkaktuar vdekjen e miliona njerzëve të pafajshëm dhe vuajtje të pashpjeguara shpirtërore dhe morale. Ateizmi dhe filozofitë materialiste e verbërojnë dhe e zhveshin shpirtin e njeriut nga çdo vlerë dhe virtyt njerëzor. Ateizmi nuk edukon ndërgjegjen, dhe njeriun e privon nga ndjenja e respektit dhe frikës ndaj Zotit, dhe e mëson se njeriu është krijesë pa kurfarë përgjegjësie. Ateizmi (mosbesimi) supozon se njeriu jeton në këtë gjithësi vetëm duke u mbështetur në vetvetën e tij, pa Zotin i Cili e ka krijuar, i Cili e ndihmon dhe para të Cilit do të japë llogari, dhe e bën atë (njeriun) që në prirjen e tij të ketë egoizëm dhe individualizëm. Mosbesimi sjell vetëm shqetësim, trazim dhe zbrazëti të pallogaritshme shpirtërore. Me ateizëm jeta është absurde e kotë dhe e pakuptimtë. Ateizmi ka vetëm efekte negative në sjelljet njerëzore dhe në normat morale tek popujt dhe sistemet shoqërore. Ateizmi nën një maskë të ashtuquajtur shkencore ia doli që gjatë shekullit të kaluar të fitojë një ligjshmëri të rremë.

Ndërkaq, shkenca moderne po shtyen të ecurit drejt Zotit dhe është bërë mbështetje për fenë. Me përparimin e shkencës, besimi në Zotin e Plotfuqishëm po shtohet. Me shtimin e dijes, vlera e fesë po rritet. Ateizmi shkakton ikje nga vetvetja, duke bërë që individit të kërkojë arratisje nga mendime tmerruese dhe dërmuese, kështu që fillon të kërkojë strehim duke u

dëfryer, duke u kënaqur me gjëra të kota dhe që sjellin largim nga realiteti siç janë barërat, alkooli, drogat dhe mjetet tjera shkatëruese si për individin ashtu edhe për shoqërinë në tërësi. Ateizmi paraqet degradim të dinjitetit njerëzor. Ku qëndron dinjiteti njerëzor nëse pretendohet pa të drejtë dhe në mënyrë mashtruese, që njeriu është pasardhës i majmunit. Po nëse përjashtojmë egzistencën e Zotit, ku gjen njeriu të drejtën për tu respektuar, gjë që është e domosdoshme kur flasim për dinjitetin. Nëse një pikturë origjinale ka cilësinë e të bukurës, kurse “çdo kopje” është e shëmtuar, jo për faktin se kopjes i është shtuar apo larguar diçka, por vetëm ngase dallimi mes tyre qëndron në kontaktin personal ndërmjet veprës dhe artistit. Atëherë ku do të qëndronte bukuria dhe madhështia e njeriut nëse do të mohonim kontaktin e pandërmjetshëm mes njeriut dhe Krijuesit përmes aktit të Krijimit. Thjesht nëse ateistat pretendojnë se kemi prejardhjen prej majmunit atëherë pse edhe sot tek majmunët nuk gjejmë faza të kalimit majmun-njeri, mirpo majmuni ka mbetur në nivelin dhe krijimin e tij origjinal siç e ka krijuar Zoti Fuqiptotë dhe njeriu ka mbetur po në atë nivel. Kjo është një absurditet që mendja e pastërt dhe e shëndoshë e njeriut kurrë nuk do ta pranojë. Njerëzit që mendojnë se nuk do ti japim llogari Zotit, janë të prirur për shthurje. Në themel tek të gjitha sjelljet imorale dhe jonjerëzore shihet qartë mungesa e fesë (besimit). Pa Zot, nuk ka moral. Sipas ateizmit nuk ka vlera absolute, të shenjta, as parime të cilat duhet tu përmbahen njerëzit, duke mohuar parmiet bazë, dhe duke e bërë të pamundshme të përcaktohet se çka është e moralshme e çka e pamoralshme.

-Si do të dukej njerëzimi sikurse të ç'rrenjosej feja (besimi) nga jeta jonë? A do të kishte kuptim jeta? Cili do të ishte misioni i njeriut në Tokë?

Feja (besimi në Zotin) e lartëson njeriun në

virtutet më të larta humane e morale, e zhvillon lirinë personale dhe e forcon shoqërinë, e bën ate të drejtë para të gjitha krijesave të Zotit, ndimon në funksionimin normal të shoqërisë, riafirmon solidaritetin e grupit (martesa, lindja, vdekja), frymëzon aktivitetin individual, familjar, social, politikë, emocional etj.

-Të besosh në Zotin drejtë, nuk humbet asgjë, ndërsa fitohet çdo gjë, si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Ndërsa me mohimin e Zotit, humb çdo gjë, dhe fiton vetëm vuajtje, shkatërrim, degradim dhe dënim të përjetshëm.

Të gjitha falëndërimet dhe lavdërimet qofshin për Allahun, Krijuesin e Botrave.

Arlind Gusinja,
23.7.2004

Kohë e humbur?!

Që nga nata e kaluar djali im i vogël ka qenë i sëmurë. Kur u ktheva prej pune atë mbrëmje vendosa ta dërgojë atë në spital edhe pse isha shumë i lodhur. Në të vërtetë, lodhja për të mirën e tij më dukej pushim.

Aty kishte shumë njerëz që pritnin... mbase do të duhet të presim më shumë se një orë. Unë e mora numrin tim dhe u ula në dhomën e pritjes. Aty kishte shumë fytyra, të reja dhe të vjetra, por të gjithë të heshtur. Disa lexonin prej broshurave të shumta që gjendeshin në dhomën e pritjes.

Disa nga ata që prisnin i kishin mbyllur sytë, përderisa të tjerë shikonin përreth. Shumica ishin të bezdisur. Vetëm zëri i infermieres që thëriste ndonjë numër e thente heshtjen herë pas here. Gëzimi shfaqej te ai, numri i të cilit thiret, dhe ai ngrihej shpejt... pastaj heshtja kthehej përsëri.

Ma tërhoqi vëmendjen një djal i ri. Ai ishte duke lexuar nga një Mus-haf (Kuran) i vogël vazhdimisht, duke mos e ngritur aspak kokën. Në fillim nuk mendova shumë për të. Sidoqoft, pas një orë pritjeje shikimi im i rastit u kthye në një persiatje të thellë në lidhje me mënyrën se si ai jetonte dhe e shfrytëzonte kohën.

Një orë nga jeta e humbur! Në vend që të përfitohet nga ajo orë, ajo ishte vetëm një prit-

je e bezdisshme. Pastaj thirri ezani. Ne shkuam ta falim namazin në xhaminë e spitalit. Unë u mundova të falem në afërsi të atij djaloshtit që më herët lexonte Kuran në dhomën e pritjes. Pas namazit unë e bëra një shetitje me të. E informova ate se sa isha i impresionuar nga ajo se si ai mendohej të përfiton nga koha e tij.

Ai më tregoi se shumica e kohës sonë na humb pa përfituar prej saj. Këto janë ditët e jetës sonë që na ikin pa qenë të vetdijshëm ose duke u penduar për humbjen e tyre. Ai tha se kishte filluar ta mban me vete Kuranin me madhësi të xhepit atëherë kur një shok e kishte nxitur që ai ta shfrytëzonte plotësisht kohën e tij. Ai më tregoi se në kohën të cilën të tjerët e humbin ai arrinë të lexoj Kuran më shumë se kur është në shtëpi apo në xhami. Gjithashtu, përveç shpërblimit nga leximi i Kuranit, kjo shprehi e mbron atë nga bezdia dhe stresi. Ai shtoi se deri tash ishte duke pritur një orë e gjysëm.

Pastaj ai pyeti "Kur do të gjeshe një orë e gjysëm të lexosh Kuran?"

Unë u mendova... a thua sa kohë ne e humbim?

Sa shumë momente të jetës sonë na kalojnë, e ne përsëri nuk mbajmë llogari se si na kaluan ato?

Në të vërtetë, sa muaj na kalojnë e ne nuk lexojmë Kuran?

Mu rrit respekti për këtë shokun tim, dhe zbulova se jam i gatshëm të filloj më që të mbaj llogari dhe se kjo kohë nuk është në dorën time... e çfarë jam duke pritur atëherë?

Mendimet e mia i ndërpreu infermierja e cila e thirri numrin tim... shkova te mjeku.

Por tani doja të realizoja edhe diçka. Pasi do-
la nga spitali me shpejtësi shkova te libreria
dhe e bleva një mus-haf në format xhepi. Unë
vendosa të jem i ndërgjegjshëm se si e kaloj
kohën. Ky ishte qëllimi im kur e futa atë Kuran
në xhepin tim. Sa veta do ta bëjnë këtë?

E sa shpërblim të madh do të ketë ai i cili i
udhëzon të tjerët në këtë ide!?

Abdulmelik el-Kasim
Përktheu: Omer Islami

Shenjat e besimit të dobët

Shenjat e besimit të dobët janë:

1. Bërja e mëkateve duke mos ndier keqardhje.
2. Fortësia e zemrës dhe mosdëshira për të lexuar Kuran.
3. Ndjenja e përtacisë për në vepra të mira, p.sh. vonimi në namaz.
4. Neglizhimi i praktikimit të sunnetit të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.
5. Disponimi i lëkundshëm, për shembull; hidhërimi për gjëra të vogla dhe të qenurit gjithmonë i bezdisur dhe i irrituar.
6. Nuk ndjen asgjë kur dëgjon ajete nga Kurani, për shembull ajetet ku All-llahu na tërheq vërejtjen nga dënimi i Tij dhe na premtan gjëra të mira.
7. Vështirësi për në përkujtimin e All-llahut dhe bërjen e dhikrit.
8. Kur nuk ndjehet keq për raste kur shkelen dispozitat e All-llahut.
9. Lakmia për pozitë dhe pasuri.
10. Të qenurit i lig dhe koprac, mos dëshira për dhënie nga pasuria.
11. Urdhëron të tjerët në vepra të mira, kurse vet ato të njëjtat nuk i vepron.
12. Të ndjehet i kënaqur kur të tjerët nuk përparojnë.
13. Përkufizimi i interesimit për një vepër vetëm në atë se a është hallall apo haram një vepër, dhe duke mos u larguar nga mekruhet (veprat e urejtura).
14. Përqeshja e njerëzve që bëjnë punë të mira, në dukje të thjeshta, si p.sh. pastrimin e xhamisë.
15. Mos brengosja për gjendjen e muslimanëve.
16. Kur nuk ndjen përgjegjësi për të bërë diçka për fenë islame.
17. Dëshira për të bërë debat, vetëm për shkak të debatit, pa argument
18. Kur është i preokupuar gjithnjë me punë të dunjasë, dhe ndjehet keq vetëm kur humb të mira materiale.
19. Është i preokupuar me dukjen e tij.

Marrë nga: I s l a m w a y . c o m
Përktheu: Omer Islami
6.8.2004

Ule shikimin!

Epshtet dhe sprova me te ka arritur kulmin. Fotografitë e femrave kanë depërtuar çdo kund, ekzpozohen edhe gjatë ditës edhe gjatë natës. Të gjitha shtresat e shoqërisë kanë mundësi të arrijnë deri te ato fotografi. Andaj kjo fitne ka shkaktuar dobësimin e vullnetit dhe ambicjeve në rrugën e përmirësimit.

Pasiqë kjo e keqe ka arritur në këtë gradë, është bërë e domosdoshme për të gjithë ne, hoxhallarë dhe thirrës, njerëz që ia dojnë të mirën mbarë shoqërisë, që ta ngrisin zërin për ta përmirësuar këtë gabim dhe për ta eliminuar këtë shkak, i cili e sjell zemrimin e Plotfuqishmit, subhanehu ve tealë.

Të gjithë ne e kemi obligim të flasim rreth këtyre gjërave, të sqarojmë rrezikun e këtij mëkati dhe të përpiqemi me çdo kusht ta eliminojmë nga shoqëria jonë.

Mbarë ummeti, dijetarët e selefit (gjeneratave të para) dhe halefit (gjeneratat e mëvonshëm), fukahatë dhe dijetarët kanë thënë se shikimi i burrave në gratë e huaja është haram. Argument për këtë vepër është ajeti Kur'anor:

"Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), ...". (En-Nur: 30).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ia largoi shikimin e Fadl ibn Abbasit, radijall-llahu anhu, kur kaluan afër tij disa gra, siç transmeton Imam Muslimi në Sahihun e tij.

Ibn Kajjimi, rahimehull-llah, thotë:

"Kjo vepër është ndalesë konkrete nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, se po të ishte e lejuar, do ta konfirmonte Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,

shikimin e tij. Gjithashtu Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "All-llahu ka përcaktuar hisen e njeriut në imoralitet (zina), ai do të bjer në te domosdo. Syri bënë zina, kurse zinaja e syrit është shikimi". (Buhariu dhe Muslimi).

Pastaj përmendi gjuhën, këmbën, dorën, zemrën, mirëpo filloi nga syri, sepse syri është baza e zinasë së dorës, këmbës, zemrës dhe organit. Ky hadith është prej argumenteve më të qarta se syri ban mëkat duke shikuar dhe se kjo i llogaritet zina, njëkohësisht është argument kundër atyre që e lejojnë shikimin në përgjithësi". ("Reudetul-Muhibin", fq. 110).

Në çka nuk duhet të shikohet

Prej gjërave që nuk duhet shikuar janë këto:

1- Mos shikimi në avretin (organet e turpshme) e njerëzve.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Nuk shikon njeriu në avretin e tjetrit, e as gruaja në avretin e tjetrës". (Muslimi).

Secili njeri ka avret të cilin nuk duhet ta zbulon dhe nuk duhet të shikon në avretin e njeriut, i cili e ka zbuluar atë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Ruaje avretin tënd përveç se nga gruaja dhe robëresha yte". (hasen, Tirmidhiu).

2- Mosshikimi në shtëpitë e njerëzve.

Për këtë qëllim sherijati e ka bërë të ligjshme kërkimin e lejes para hyrjes në shtëpi të huaja, siç tregohet në sahihun e Imam

Buhariu dhe të Imam Muslimit, se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Kërkimi i lejës është bërë për shkak të shikimit". (Buhariu dhe Muslimi).

"Nuk ka të bëjë vetëm me avretin e trupit, por kësaj i shtohet edhe avreti i ushqimit, veshmbathjes, mobiljeve, që njerëzit nuk kanë dëshirë të shihen në atë gjendje, pa u përgaditur ose stolitur, e këto janë avret i ndjenjave dhe gjendje psikike. Sa prej nesh dëshirojnë që ti shohin njerëzit në gjendje të dobët, i cili qan nga shkak i ndonjë reagimi, ose hidhërohet për shkak të ndonjë ndikimi, ose ndien dhimbje për shkak sëmundjes që e fsheh nga të huajët. Të gjitha këto gjëra detale i ka parasysh metoda Kur'anore, me këtë edukatë të lartë, e që është edukata e kërkimit të lejës, sepse me këtë edukatë pakësohen mundësitë e shikimeve të befasishme dhe takimet e rastësishme, të cilat i zgjojnë epshet dhe dëshirat". ("Dhilali", 2509).

3- Mosshikimi i gjërave që i posedojnë njerëzit, qoftë pasuri, gra ose fëmijë, të cilat All-llahu i ka bërë stoli të jetës së kësaj bote.

All-llahu, subhanehu ve teala, na ka mësuar në Kur'an:

"Dhe mos ia ngul sytë bukurisë së kësaj jete me të cilën i bëmë të kënaqen disa prej tyre (mosbesimtarë), e për t'i sprovuar me të, sepse shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe është i përjetshëm". (Taha: 131).

Sadiu, rahimehull-llah, thotë: "Mos e zgjat shikimin drejt tyre duke u pëlqyer dhe mos e kthe shikimin drejt tyre duke patur ëndje për gjendjen e botës dhe ata që kënaqen me te...". (Tefsir Sadi, fq. 516).

4- Ulja e shikimit nga gratë e huaja dhe kjo është tema për të cilën flasim në këtë rast.

(Shiko më gjërësisht rreth kësaj teme librin: "Ahkamun-Nedher", Ali ibn Atije Hejtemi dhe "Gadul-Besar", Semariu).

Rreziku nga shikimi i pakontrolluar

1- Shikimi i gjërave të palejuara. E kjo është zina e syrit. Sepse Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Syri ban zina, e zinaja e syrit është shikimi".

2- Shikimi i pakontrolluar është shkak kryesor që e pengon njeriun nga ecja drejt Zotit, xhel-le shanuhu, dhe angazhohet me gjëra tjera në vend se me ato për të cilat e ka krijuar All-llahu, subhanehu ve teala.

Shikimi në gra të bukura mund të bëhet shkak që njeriu edhe të del tërësisht nga feja, duke i dhënë përparësi të dashurës më shumë se fesë, e nëse ajo kërkon edhe ndryshimin e fesë, ai do ta bëjë këtë pa ngurrim.

Ibn Kajim, rahimehull-llah, e tregon një rast duke thënë:

"Të dhënë pas dashurisë djallëzore (ishk shejtani) kanë miqësinë dhe participimin e shejtanit në ato vepra, pasi që i kanë bërë ortak All-llahu dhe pasi që u ka ikur sinqeriteti. Ata kanë hise në përshkrim të Zotit ortakë. Andaj shumica e tyre janë bërë robër të të dashurave të veta, mvaren prej tyre, bërtet kur është e pranishme ose kur mungon se është rob i saj. Më shumë e përmend ate se sa Zotin, tebareke ve teala, në zemrën e tij ka më shumë dashuri për te se sa për Zotin, xhel-le shanuhu, kurse kjo mjafton si dëshmi kundër vehtes, sepse All-llahu, subhanehu ve teala, ka thënë:

"Po njeriu është dëshmitar i vetvetes. Edhe nëse i paraqet arsyetimet e veta". (El- Kijame: 14- 15).

Poqëse i jepet mundësi të zgjedh mes pëlqimit të dashnores së vet dhe pëlqimit të Zotit të vet, ai do të zgjedhte pëlqimin e sajë, takimi me dashnoren e vet është më i dashur te ai se takimi me Zotin e vet, shpresimi të jetë afër saj është më i madh se sa shpresimi të jetë afër Tij, ikja nga mllefosja e saj është më i madh se sa ikja nga mllefosja e Tij, e hi-

dhëron All-llahun duke e fituar pëlqimin e dashnores, i jep përparësi interesit dhe nevojave të dashnores para respektit ndaj Zotit. E nese ka pak iman dhe ka pak kohë tepër, atëherë atë kohë që i tepron ia jep adhurimeve ndaj Zotit. Mirëpo nëse kryerja e nevojave të dashnores ia merr tërë kohën, ai tërë kohën e harxhon në atë drejtim dhe e neglizhon urdhërin e All-llahut, subhanehu ve teal. Flijon për dashnoren çdo gjë të shtrenjtë dhe të çmueshme, kurse Zotit i le gjërat e pavlefshme. Dashnores ia jep zemrën dhe mendjen, ambicjet, kohën dhe pasurinë, kurse Zotit atë që i tepron, Ate e ka lënë pas shpine dhe e ka haruar. Nëse ngritet me fal namaz, gjuha i flet Zotit, kurse zemra dashnores, trupi dhe fytyra i janë kthyer kah kibla, kurse zemra i është kthyer kah dashnorja. Ik nga shërbimet ndaj Zotit, ashtuqë kur është duke falur namazin, i duket sikur të është duke qëndruar mbi gaca dhe i vjen rëndë ta zbatojë, kurse nëse është në pyetje shërbimi ndaj dashnores, e ban me gjith qejf, me zemër dhe trup, i duket vepër e lehtë, nuk i vjen rëndë. Pa dyshim se këta janë prej atyre:

"E nga njerëzit që asish që në vend të All-llahut besojnë idhujt, që i duan (i madhërojnë) ata, sikur (që besimtarët e vërtetë e duan) All-llahun, ...". (El-Bekare: 165). (Shiko: "Iagethetul-Lehefan", fq. 572).

3- All-llahu, subhanehu ve teal, ka caktuar që burri të anon kah gruaja dhe gruaja kah burri, e kjo është një gjë e natyrshme, andaj Islami e ka rregulluar këtë anim dhe e ka udhëzuar në kahje të shëndoshë.

I ka ndarë burrat prej grave, gratë i ka urdhëruar të mbulohen, për ta mbrojtur shoqërinë nga prishja dhe çorodia.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Fitneja më e dëmshme që kam lënë pas veshes për burrat janë gratë". (Buhariu dhe Muslimi).

Andaj ka shumë të atillë që janë mobilizuar në rradhët e ushtrisë së shejtanit dhe mundohen me tërë potencialin e tyre të sjellin njerëzimin në fund të humnerës. Kurse All-llahu, subhanehu ve teal, atyre që kanë dëshirë të përhapin imoralitetin në mesin e muslimanëve u kërcënohet duke u thënë:

"Ata, të cilët dëshirojnë që të besimtarët të përhapet imoraliteti, ata i pret dënimi i dhembshëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu di (të fshehtat) e ju nuk i dini". (En-Nur: 19).

4- Shikimi i pakontrolluar shkakton "deponimin e atyre fotografive në kujtesë, pa marrë parasysh a janë të gjalla, ose fotografi të shtypura në revista ose që lëvizin në filme.

Andaj shikimi i herëpashershëm i tyre shkakton lehtësimin e rikthimit të këtyre pamjeve, e rikthimi i këtyre pamjeve shkakton parafytyrimin e tyre në forma të caktuara, e kjo e zgjon epshin, kurse ai që është zemërsëmurë, e kaplon stresi i madh". (shiko: "El-Fitne". Abdul-Hamid Suhejban, fq. 231).

Njerëzit po të respektonin All-llahun dhe Pejgamberin, e të mjaftoheshin me ate që ua ka lejuar All-llahu, do të qetësonin zemrën dhe mendjen nga shumë gjëra që paraqet për ta denim në këtë botë dhe lodhje për shumë bijë tanë.

5- Shikimi nëse nuk kontrollohet, ajo nuk ka të ndalur.

Nuk mjaftohet syri me një fotografi, por nëse i pëlqen njëra, do ti pëlqen edhe tjetra, edhe pse asnjëherë nuk do të ngopet nga të shikuarit.

Nga kjo mund të rruhem në fillim, se pas-taj edhe nëse përdorim shërim të madh, ndoshta nuk do të arrimë të shërohemi.

Shejh Ali Tantavi thotë: "Nëse do të kishe pasurinë e Karunit dhe trupin e Heraklit e të kishë marrëdhënie me dhjetë mijë gra prej më të bukurave, a mendon se do të mjaftohesh? Them me zë të lartë: jo. E shkruaj me shkrim të gjërë. Mirëpo një grua në më-

nyrë të lejuara të mjafton. Mos kërkoni prej meje argument, sepse kado që do të ktheheni përreth jush do të gjeni në jetë argument të dukshëm". ("Fetava Ali Tantavi", fq. 146).

Dobitë nga ulja e shikimit

Ulja e shikimit sjell shumë dobi në jetën e kësaj bote, e për në ahiret mos të flasim.

1- Zbatimi i urdhërit të All-llahut, e cila është kulmi i lumturisë së njeriut në jetën e kësaj bote dhe në ahiret.

Njeriu nuk ka as në botë e as në ahiret gjë më të dobishme se sa zbatimi i urdhërave të All-llahut, kjo e sjell lumturinë dhe moszbatimi i tyre shkakton vuajtjen në dynja dhe ahiret.

2- Pengon depërtimin e gjurmëve të shijetave të helmuara, në të cilat mund të ndodhet shkatërrimi i zemrës së tij.

3- Shkakton gëzim të zemrës me Zotin dhe koncentrohet i tërë potenciali i tij në All-llahun, sepse shikimi i pakontrolluar shkakton shkapërdëdhjen e zemrës, largimin e tij nga Zoti.

Gjëja më e dëmshme për njeriun është shikimi i pakontrolluar, i cili sjell egërsi mes njeriut dhe Zotit të vet.

4- E forcon zemrën dhe e gëzon, ashtu sikurse shikimi i pakontrolluar e dobëson dhe e mërzit.

5- Zemrës i jep dritë, ashtu sikurse shikimi i pakontrolluar i jep errësim. Andaj All-llahu, subhanehu ve tealë, e ka përmendur ajetin e dritës, pasi që ka urdhëruar uljen e shikimit.

"All-llahu është dritë (ndriçues, udhëzues) i qiejve e i tokës. Shembulli i dritës së Tij i gjason kandilit të vendosur në një zgavër të errët. Kandili gjendet brenda një qelqi si të ishte yll flakëruar e që ndizet prej (vajit të) një druri të bekuar, prej ullirit që nuk mund të quhet as i lidjes e as i perëndimit, e vaji i tij ndriçon pothuajse edhe pa e prekur zjarri. Dritë mbi dritë. All-llahu udhëzon kah drita e Vet atë që do Ai. All-llahu sjell shembuj për

njerëzit. All-llahu çdo gjë di shumë mirë". (En-Nur: 35).

Domethënë sikur drita që gjindet në zemrën e besimtarit, i cili i zbaton urdhërat e Tij dhe largohet nga ndalesat e Tij. Kur t'i ndriçohet zemra njeriut i vijnë delegacionet e të mirave nga çdo anë, ashtu sikurse kur t'i errësohet, i vijnë retë e sprovës dhe të këqijave nga çdo anë. I vijnë bidatet, devijimi, pasimi i epshit, largimi nga udhëzimi, largimi nga shkaqet e lumturisë dhe angazhohet me shkaqet e fatkeqësisë. Këtë ia zbulon drita që gjindet në zemrën e tij, e kur ta humbë këtë dritë, ai njeri mbetet sikur i verbëri, i cili bredhë në errësi.

6- I jep largpamësi të vërtetë, me të cilën e dallon të vërtetën nga e kota. Shah ibn Shuxha' el-Kermaniu, rahimehull-llah, thotë:

"Ai që jetën publike e ka mbushur me pasim të sunnetit, jetën sekrete me vetkontrollë, ai që ulë shikimin nga harami, e ndalon vehten nga epshet dhe zakonisht han hallall, nuk i gabon largpamësia".

Ky, njeri që e ka thënë këtë fjalë, asnjëherë nuk i ka gabuar vlerësimi (largpamësia).

7- I jep njeriut paluhatshmëri, trimëri dhe forcë. Këtij njeriu All-llahu i grumbullon mes fuqisë së vizionit dhe argumentit dhe fuqisë së pushtetit. Në disa gjurmë nga muslimanët e parë qëndron:

"Ai që kundërshton epshin e vet, nga hija e tij ik shejtani".

Kurse ate që e pason epshin e vet e sheh të nënçmuar, të mposhtur, të pavlefshëm, tërë këto ia lëshon All-llahu atij që bën mëkate ndaj Tij.

All-llahu, subhanehu ve tealë, krenarinë e ka bërë shoqërues të adhurimeve, kurse nënçmimin shoqërues të mëkateve.

All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

"...Ndërsa e tërë krenaria i takon All-llahut, të dërguarit të Tij dhe besimtarëve, ...". (El-Munafikun: 8).

"E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht) derisa ju jeni më të lartit, po qe se jeni besimtarë të sinqertë". (Ali Imran: 139).

Besimi është thënie dhe vepër, sekrete dhe publike. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

"Kush e dëshiron krenarinë (le ta dijë), e tërë krenaria i takon All-llahut (pra le të kërkojë prej Tij), te Ai ngrihet fjala e mirë (besimi) dhe veprimi i mirë, e Ai i pranon...". (Fratir: 10).

Domethënë ai që dëshiron krenarinë, duhet ta kërkon duke e adhuruar All-llahun dhe duke e përmendur Ate, duke përmendur fjalë të mira dhe duke vepruar vepra të mira.

Në lutjen e kunutit qëndron:

"Nuk nënçmohet ai që të miqëson Ty dhe nuk është krenar ai që të armiqëson Ty".

8- Ia mbyll hyrjet e shejtanit në zemrën e vet.

Sepse ai hyn nga dera e shikimit më shpejt se sa ajri në vendin bosh, ia zbukuron fotografinë e shikuar, ia bën idhull të cilit i përkulet, pastaj i jep shpresa dhe i premtton, duke ngjallur zjarrin e epshit, duke hedhur drunjtë e mëkatit, në të cilat nuk do të arrinte po nuk ishin ato fotografi. Zemra e tij i bëhet e tëra në flakë, kjo i shkakton ato rënkime dhe ofkëllime, sepse zemra i është rrethekuar nga të gjitha anët me zjarr, ajo gjindet në mes sikur dashi në mes të furës. Andaj denimi i njerëzve të dhënë pas epsheve dhe fotografive të ndaluara është fura e zjarrit, në të cilën do të denohen në berzah deri në ringjallje, siç i ka parë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke u denuar në ëndrrën e tij, në hadithin që e transmeton Buhariu dhe Muslimi.

9- E boshatis zemrën nga çdo preokupim për të menduar për interesin e tij dhe për tu preokupuar me to.

Shikimi i pakontrolluar e dekoncentron

dhe ia shkapërderdh punët, e pason epshin dhe shkujdeset nga përmendja e Zotit të vet. All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë:

"... dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar". (El-Kehf: 28).

Shikimi i pakontrolluar i shkakton këto tre gjëra.

10- Mes zemrës dhe syrit ka kanal, saqë me çka angazhohet njëri angazhohet edhe tjetri, me çka rregullohet njëri, rregullohet edhe tjetri, me çka prishet njëri, prishet edhe tjetri, ashtu që nëse prishet shikimi prishet edhe zemra, poashtu edhe në aspekt të përmirësimit.

Nëse i prishet dhe çoroditet syri, i prishet dhe çoroditet edhe zemra, i bëhet sikur vend i mbeturinave, ku grumbullohen ndytë-sirat dhe mbeturinat. Kjo zemër nuk është më e përshtatshme për të banuar në te njohja e All-llahut, dashuria ndaj Tij, pendimi te Ai, gëzimi me Te dhe me afërsinë e Tij, por në të banojnë gjërat e kundërta. (shiko: "Shërimi dhe Ilaçi", Ibn Kajimi).

E lusim All-llahun të na shtojë dijen e dobishme dhe veprat e mira!

E lusim All-llahun të na dhurojë dashurinë e Tij, dashurinë e veprave që na shpiejnë te dashuria e Tij, dashurinë e njerëzve që e dojnë Ate!

E lusim All-llahun të udhëzon rininë tonë, djemt dhe vajzat tona!

E lusim All-llahun që të na mbrojë nga të nxehtit e dynjasë dhe zjarrit të xhehenemit!

E lusim All-llahun që të na mbrojë nga sprovat që i dimë dhe që nuk i dimë!

E lusim All-llahun të na shtojë imanin, devotshmërinë, pasurinë hallall, fëmijët e mirë dhe veprat e pranuar!

Amin!

Bekir Halimi,
23.7.2004

Sipas veprës edhe shpërblimi (mbi zinanë)

All-llahu, subhanehu ve teal, ka treguar se rruga e zinasë është rruga më e keqe, andaj edhe ka thënë:

"Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë), sepse vërtet ajo është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe". (El-Isra: 32).

Vendbanimi i tyre në xhehenem është vendbanimi më i keq, vendqëndrimi i shpirtit të tyre në berzah është në furë, ku flaka u vjen nga poshtë, e kur t'ju vjen flaka ata bërtasin dhe ngjiten lartë, e pastaj kthehen ku kanë qenë. Ata kështu do të veprojnë deri në ditën e Kijametit, siç i ka parë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në ëndrrën e tij.

Mjafton si argument se zinaja është një vepër shumë e shëmtuar denimi të cilit e ka caktuar All-llahu, edhe pse Ai është i Mëshirshëm, e ajo është vrasja me gurëzim dhe ka urdhëruar që këtë dënim ta dëshmojnë edhe besimtarët.

Aq i keq është ky mëkat saqë All-llahu, subhanehu ve teal, e ka vënduar edhe në natyrën e kafshëve që ti shmangen këtij imoralitetit edhe pse nuk kanë mend që të logjikojnë.

Transmeton Imam Buhariu nga Amr ibn Mejmun el-Eudiu, i cili thotë: në xhahilijet kam parë një majmun duke patur marëdhënie intime me një majmuneshë. Majmunët tjerë u grumbulluan dhe i gurëzuan deri në vdekje, isha edhe unë në mesin e atyre që i gurëzuan.

Ibn Kajjimi, rahimehull-llah, duke folur rreth dënimit të zinaqarit dhe gjurmëve të zinasë thotë:

- Zinaqarit (lapërdharit) i vjen era, këtë erë e nuhat secili njeri me zemër të shëndoshë. Kjo erë del edhe nga goja edhe nga trupi i tij. Po mos të merrnin pjesë njerëzit në këtë erë, do të përhapej nga ai njeri dhe do të thëritke.

- I ngushtohet gjoksi, sepse me zinaqarët sillen njerëzit me të kundërtën e asaj që e

synon. Ai që kërkon kënaqësinë e jetesës me gjëra që ia ka ndaluar All-llahu, dënohet me gjëra që janë në kundërshtim me synimin e tij. Po ta dinte mëkatari se çka ka në nderë, çfarë kënaqësie, gëzimi, zemërgjërësie dhe jetë të këndshme, do të kuptonte se kënaqësia që i ka kaluar është shumë ma shumë se ajo që e ka arritur. Duke patur parasysh edhe fitimin në fund dhe shpërblimin e nderimin e All-llahut.

- Zinaqari e privon veten nga kënaqësia me hyriat e xhennetit, në vendbanimet e këndshme në xhennetit Adën. Nëse All-llahu e dënon njeriun që vesh mëndafsh në këtë botë duke e privuar nga veshja e tij në ahiret, ate që konsumon alkool në këtë botë duke e privuar nga përdorimi i tij në ahiret, poashtu edhe ai që kënaqet me fotografi të ndaluara në këtë botë, madje çdo gjë që fiton robë në dynja, edhe nëse zgjerohet në gjërat hallall, atij do ti ngushtohet hiseja e tij prej tyre në ahiret, kurse nëse ato i ka arritur në mënyrë të paligjshme, ashtu edhe do të dënohet. (shiko: "Reudetul-Muhibin", fq. 365-368).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Kur njeriu ban zina, del prej tij besimi, e i qëndron mbi kokë si re, e kur të largohet nga zinaja, i kthehet prap". (sahih, Ebu Davudi).

Gjithashtu thotë:

"Tre personave nuk u flet All-llahu në ditën e Kijametit, nuk i pastron, nuk i shikon dhe do të kenë dënim të dhembshëm: plaku zinaqar (lapërdhar), mbreti gënjeshtar dhe i varfëri mendjemadh". (Muslimi).

Ibn Kajjimi, rahimehull-llah, thotë:

"Dije se sipas veprës është edhe shpërblimi. Zemra e lidhur për haram çdo herë që synon që të largohet dhe të ndahet prej tij, i

kthehet sërish. Andaj dënimi i tij në berzah është i tillë. Në hadithin që transmeton Semure ibn Xhundub, që gjindet në sahihun e Imam Buhariut, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Mbrëmë pash dy njerëz që më erdhën e më morën. Shkova me ta. Pash një ndërtesë si furë, në majë ishte e ngushtë, kurse në bazë ishte e gjërë. Nga poshtë ndezej zjarri. Në te kishte burra dhe gra të çveshur. Kur ndezej zjarri, ata ngjiteshin lart derisa përpak të dilnin, e kur fikje zjarri, ata ktheheshin prap. Thashë: kush janë këta? Thanë: zinaqarët".

Analizo përputhjen e këtij denimi me gjendjen e zemrave të tyre në dynja. Ata çdo herë që vendosin të pendohen dhe largohen nga ky mëkat, e të dalin nga fura e epshit drejt gjërësisë së pendimit, ata kthehen prap, pasi që për pak do të dilnin.

Pasi që kafirat janë në burgun dhe ngushticën e kufrit dhe shirkut, ata çdo herë që vendosnin të dalin prej tij në gjërësinë e besimit, ktheheshin në te. Edhe dënimi i tyre në ahiret është i njëjtë.

All-llahu, subhanehu ve teal, thotë:

"...Sa herë që të tentojnë të dalin nga ai, kthehen në të ...". (Es-Sexhde: 20).

"Sa herë që përpiqen të dalin prej tij nga vuajtjet e padurueshme, kthehen me dhunë në të përsëri (u thuhet): "Vuajeni dënimin me djegiel". (El-Haxh: 22).

Kufri, mëkatet dhe fisku, të gjitha janë vuajtje, e çdo herë që synon njeriu të del prej saj, e refuzon këtë nefsi, shejtani dhe e zakonshmeja e tij. Ai do të mbetet në këtë vuajtje deri në vdekje. Nëse nuk del nga kjo vuajtje në dynja, mbetet në këtë vuajtje edhe në berzah edhe në ahiret. Nëse del nga kjo vuajtje dhe ngushticë në dynja del edhe atje, në ahiret. Ajo që e pengon njeriun nga All-llahu në këtë dynja e pengon edhe pas vdekjes në ahiret. Për shkak të saj dënohet

atje, ashtu sikurse i dënohej zemra me te në dynja. Andaj ashikët (të dhënë pas dashurisë dhe qejfeve), mëkatarët dhe zullumqarët nuk kënaqen në këtë botë, por ata dënohen në te, në berzah dhe në ahiret, mirëpo dehja e epshit dhe vdekja e zemrës është pengesë për ta kuptuar këtë dhimbje, e kur të eliminohet kjo pengesë, e përjeton shpirti i tyre këtë dhimbje të madhe. Aq sa vepron krimbi duke ia ngrënë mishin trupit të tij, aq i shkaktajnë dhimbje shpirtit të tij këto gjëra, mirëpo shpirti nuk harxhohet. (shiko: "Reudatul-Muhibin", fq. 440- 441).

Ibn Haxheri, rahimehull-llah, gjatë komentit të hadithit të Semure ibn Xhundubit, radijall-llahu anhu, thotë:

Ata dalin të çveshur në ahiret, sepse meritojnë të turpërohen, pasi që zakonisht ata fshihen dhe e bëjnë këtë mëkat në fshehtësi. Kurse zjarri u vjen nga posht, sepse ata këtë krim e kanë bërë me gjymtyrët e poshtme të trupit. (shiko: "Fet'hul-Bari", 12/ 465).

Gjithashtu Ibn Haxheri, rahimehull-llah, gjatë komentit të këtij hadithi thotë:

Kermani, rahimehull-llah, thotë:

"Dënimet e përmendura janë për krimet e dukshme, përpos zinaqarëve, sepse ata krimin e bëjnë fshehurazi, andaj lakuriqësia është turpërim, sikur zinaja. Zinaqari zakonisht kërkon vend të boshatisur, andaj i përshtatet fura, pastaj ai është i frikësuar gjatë kësaj gjendje, sikur të jetë nën zjarr. (shiko: "Fet'hul-Bari", 12/ 466). Sipas veprës është shpërblimi.

Edhe fura përputhet me ndezjen dhe flakën e epshit.

Munaviu, rahimehull-llah, thotë:

"Një pjesë e dënimet të zinaqarit doemos do ti vijë në dynja, e ajo është se dikush nga gratë e familjes së tij do të bin në zina, detyrimisht. Pasi që zinaja shkakton shkyrjen e nderit. Edhe pse zinaja ka sanksionim në dynja dhe dënim në ahiret, ajo është e keqe,

kurse si pasojë e të keqes është e keqeja e barabartë me te, andaj kjo shkakton që zinaqarit ti bëhet zina me ndonjë të afërm të familjes së tij. Pasiqë All-llahu është Krenar dhe Hakmarës. Nëse zinaqari nuk ka të afërm të familjes që të bëhet me to zina, atëherë denohet në forma tjera.

Nga kjo që thamë u bë e ditur se edhe zinaqarit i shkyhet nderi. Kjo është e barabartë sikur për burrin ashtu edhe për gruan, nëse ajo ban zina, denohet duke bërë zina burri i saj, shtohet xhelozia e tij ndaj saj, bien në zina edhe prindërit e sajë". (shiko: "Fejdul-Kadir", 6/184- 185).

Abdull-llah ibn Omeri, radijall-llahu anhu, ka thënë: Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"O ju muhaxhir, nëse sprovoheni me pesë gjëra, kurse unë kërkohet strehim te All-llahu që ti arrini:

- Nëse përhapet imoraliteti në një popull,

përhapet mortaja dhe sëmundjet që s'kanë qenë në popujt e mëhershëm;

- Nëse vjedhin në peshojë dhe metër, u vjen thatësia dhe vështirësia e jetesës dhe zullumi i pushtetmbajtësit;

- Nëse nuk japin zekatin e pasurisë së tyre, u ndalet shiu nga qielli, e pos të ishin kafshët nuk do të binte shi;

- Nëse thejnë marëveshjen me All-llahun dhe Pejgamberin, All-llahu u lëshon mbi kokë një armik të huaj, e ua merrë atë që e kanë në dorë;

- Nëse prijësit e tyre nuk sundojnë me Librin e Zotit dhe zgjedhin nga ajo që ka shpallur Zoti, atëherë All-llahu fut zënka mes tyre". (sahih, Bejhakui).

Ky është veprim ndaj tyre në kundërshtim me synimin e tyre. Ai që dëshiron të kënaqet në haram, denohet me sëmundje dhe dhimbje, shpërblim meritot.

Marrë nga libri: "El-Xhezau min Xhinsil-Ameli", 2/211- 216.

Autor: Sejid Husejn Afani

Përshtati: Bekir Halimi

30.7.2004

Kur të humbë amaneti, prite kijametin

Amaneti në perceptimin e muslimanëve të hershëm nuk ka qenë vetëm në përmbysjen e premtimeve dhe kujdesin ndaj pasurisë së lënë si amanet, por kaplonte edhe lindjen edhe perendimin.

Amaneti ishte pema e frytshme e tevhidit, fryti i besimit, hija e kësaj pemës dhe nozulli i udhëtarit.

Është margaritar i çmueshëm, elmaz i pastër, xehe origjinale në dorë të mjeshtrit, mu ashtu si ka thënë Berireja për nënën e besimtarëve, Aishen, radijall-llahu anha, e

cila ishte rritur në prehërin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

"Subhanall-llah, prej saj di vetëm atë që di mjeshtri për arin e kuq".

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Njerëzit janë sikur xehet".

Gjithashtu ka thënë:

"Amaneti ka zbritur në rrënjët e zemrës së burrave, pastaj mësuan Kur'anin dhe më pastaj mësuan sunnetin".

Gjithashtu ka thënë:

"A për xehen e arabëve po më pyetni? Të zgjedhurit e tyre në xhahilijet, janë të zgjedhurit në Islam nëse e kuptojnë fenë".

"Njerëzit janë sikur njëqind devet, në mesin e të cilave nuk mund të gjesh asnjë bartëse".

Amanet është implementimi i ligjeve të sheriatit në jetën private dhe jetën e njerëzve.

"(Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në tokë, e falin namazin, japin zeqatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes. All-llahut i takon përfundimi i çështjeve". (El-Haxh: 41).

- Namazi është amanet, nëse një njeri e humb namazin, tjerat edhe më lehtë i humbë.

Andaj Enes ibn Maliku, kur pa humbjen e namazit në kohën e Haxhaxhit qau, siç tregon Imam Buhariu në "librin mbi kohët e namazeve" në kapitullin "Humbja e namazit nga koha e vet". Transmeton Zuhriu, i cili thotë:

"Hyra te Enes ibn Maliku në Damask, e e gjeta duke qajtur. I thashë: pse po qan? Tha: nuk njoh gjë nga ajo që ka takuar në kohën e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, përveç këtij namazi, mirëpo edhe ky namaz është humbur".

- Zekati është amanet, andaj Siddiku, Ebu Bekri, radjall-llahu anhu, i luftoi ata që refuzuan ta japin dhe u dha përshkrimin e renegatëve.

- Agjërimi është amanet, andaj:

"Nëse ndokush është duke agjëruar le te mos flet fjalë të ndyta dhe le të mos bërtet, nëse e shan dikush ose e lufton le të thotë: unë jam agjërueshëm".

- Haxhi është amanet, andaj:

"Haxhi është në muajt e caktuar e kush bën (ia fillon të zbatojë) haxhin në këta muaj, nuk duhet afruar gruas, nuk bën të merr nëpër këmbë dispozitat e sheriatit, as nuk duhet shkaktuar grindje...". (El-Bekare: 197).

- Thirrja në rrugë të All-llahut është amanet, sikurse ka thënë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

"Vëzhguesi nuk e gënjen popullin e vet".

- Amanet është edhe përqendrimi në dhikër, besnikëria ndaj Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, vazhdimi në fe deri në fund të jetës.

Ebu Sufjanin e pyeti Herakli për shokët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: a kthehet ndokush prej tyre nga feja e tij, në shenjë hidhërimi? Tha: jo. Herakli tha: kështu është puna e besimit, kur përzihet me pastërtinë e zemrës.

Ata, sahabet, kanë thënë:

Ne i kemi dhënë besën Muhammedit

Për xhihad sado që të jemi gjallë.

Kurse djaloshi i ka thënë mbretit:

"Ti nuk ke mundësi të më mbytitsh derisa nuk thua: në emër të Zotit të këtij djaloshit. Ai ashtu edhe vepro. Kurse mbarë njerëzit thanë: i besuam Zotit të djaloshit".

Pastaj gropuan hendeqe të mëdha, të cilat i mbushën me zjar, edhe kush nuk kthente nga besimi i tij, e hedhnin në te:

"E nuk patën pse t'i urrejnë, përveç që e besuan All-llahun, ngadhënjyesin, të lavdëruarin, ...". (El-Buruxh: 8).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Në kohën e kaluar, e sjellnin njeriun dhe e prenin me sharrë, ia ndanin mishin nga eshtrat, e tërë kjo nuk e ndante nga feja e tij".

Nga ëmbëlsia e besimit është edhe:

"Të urrejë të kthehet në kufër, ashtu si urren të hedhet në zjarr".

Kurse njeriu që besoi tha:

"Dhe, o populli im, ç'është që unë ju thërras në shpëtim, e ju më thirrni për në zjarr? Më thirrni ta mohoj All-llahun dhe adhuroj atë që nuk di asgjë për të, ndërsa unë ju thërras për te i gjithfuqishmi, mëkatfalësi!". (Gafir: 41- 42).

All-llahu i mëshiroftë ata magjistar të cilët u çliruan nga prangat e kësaj bote edhe i

shkaktuan dështim Faraonit duke thënë:

"... e ti bëje atë që mendon ta bësh, dhe mund ta zbatosh vetëm atë që i takon jetës së kësaj bote!". (Taha: 72).

- Amanet është edhe fuqia për të ruajtur të drejtat e tjerëve, siç iu përgjigj Jusufi, alej-hisselam, mbretit, kur ai i tha:

"..."Tash ti ke te na pozitë dhe je i besueshëm". Ai (Jusufi) tha: "Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, unë jam besnik i dijshtëm". (Jusuf: 54- 55).

Kurse bija e Shuajbit, aljhis-selam, tha:

"Njëra prej atyre dyjave tha: "O babai im, merre këtë në shërbim me pagë, pse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi e besniku!". (El-Kasas: 26).

- Amanet është bamirësia ndaj prindërve, kujdesi për pasurinë e muslimanëve, ruajtja e nderit dhe fesë.

Andaj, ata tre persona që i mbylli shkëmbi në shpellë, i shpëtoi vërtetësia e amanetit të tyre. I pari ishte besnik ndaj prindërve të vet, i cili qëndroi tërë natën me gotën e qumështit në dorë, kurse fëmijët e tij qanin nga uria. I dyti ishte besnik ndaj pasurisë së vëllaut të tij, pasuri të cilën e kultivoi dhe u kujdes për te, në mungesë të tij. Kurse i treti ishte besnik ndaj nderit të gruas së huaj dhe ruajtës i kufinjve të Zotit:

"Vërtet, ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga djalli, ata përkujtojnë (All-llahun), dhe atëherë shohin (të vërtetën)". (El-A'raf: 201).

- Amanet është kontrollimi i dëgjimit, llogaria e shikimit dhe përcjellja e zemrës:

"Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi". (El-Isra: 36).

- Mbyllja e gojës nga gjërat shkatërruese është prej amanetit.

"Vallë pse hudhen njerëzit me hundë në

zjarr të xhehenemit përpos se si korrje e asaj që ka mbjellur goja e tij".

"Në atë ditë kur dëshmojnë kundër tyre gjuhët e tyre, duart dhe këmbët e tyre për atë që ata kanë punuar". (En-Nur: 24).

- Nëse ndalemi dhe analizojmë ata tre persona që me to do të ndezet zjarri i xhehenemit, do të shohim se ata e kanë humbur amanetin.

Lexuesi i Kur'anit e ka bërë atë vepër, për ti thënë lexuesi i dalluar, kurse ai që ka dhënë sadaka, këtë vepër e ka bërë për ti thënë sadakadhënës, e ai që ka luftuar, e ka bërë këtë vepër për ti thënë trim, edhe ashtu u kanë thënë.

Njeriu që i ban veprat për syfaqe, ai nuk shpreson shpërblim te All-llahu:

"E mos u bëni si ata që e harruan All-llahun, e All-llahu bëri që ata ta harrojnë vetveten! Të tillët janë ata të prishurit". (El-Hashr: 19).

- Për këtë edhe tradhtia është shenjë e dyftyresisë:

"Kur të flet gënjen, kur premtion nuk e realizon premtimin, kur i lihet ndonjë gjë në amanet, e tradhton amanetin dhe kur ban marëveshje e then marëveshjen".

- Amanet është ruajtja e dijes dhe kujdesi i tij, ashtu siç kanë thënë dijetarët:

"Kjo dije është fe, andaj shikoni se nga cili e merni fenë tuaj".

Kur erdhën jemenasit te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i thanë: na dërgo një njeri të na mësojë sunnetin dhe islamin, e kapi për dore Ebu Ubejden e tha: "ky është besniku i këtij ummeti". Në transmetimin tjetër qëndron se banorët e Nexhranit i thanë Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: na dërgo një njeri besnik. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, u tha: do tu dërgoj një njeri që me të vërtetë është besnik".

E mëshiroftë All-llahu Hatib Bagdadiun, i cili i ka thënë nxënësit të dijes:

"Mësimin përmendsh të hadithit bëne kujtesë kujdesi e jo kujtesë transmetimi, sepse transmetuesit janë shumë, kurse kujdestarët e tyre janë pak. Ndodh që ndokush që është i pranishëm është duke munguar, ose ndonjë dijetar është sikur ndonjë injorantë, ndoshta ndonjë bartës i hadithit nuk ka prej tij asgjë me vehte, sepse ai që e hedh për shkak të vendimit të tij është sikur ai që nuk e njih dhe nuk e mëson".

Abdul-Aziz Xhurxhaniu thotë:

Poqëse dijetarët kujdeseshin për dijen, do të ruhej

Po ta madhëroni do të bëhej edhe më madhështore

Mirëpo ata e nënçmuan, e u bë i pavlerë

E njëllösën me lakmi saqë u bë e huaj për ta.

- Amanet është të kryhen detyrat që i kemi ndaj muslimanëve, t'ua kryejmë nevojat e të ngratëve, tu shërbejmë atyre që kanë nevojë, këto janë cilësitë e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

"Asesi All-llahu nuk do të poshtërojë asnjëherë, sepse ti kujdesesh për farefisën, bartë barën e tjerëve, u jep të ngratëve dhe u ndihmon në vështirësitë e të vërtetës".

Aisheja, radijall-llahu anha, thotë:

"Morali i tij ishte Kur'ani".

"Secili prej jush është çoban dhe është përgjegjës për tufën e tij...".

"Muslimanët qëndrojnë në kushtet e tyre".

- Amanet është zbatimi i detyrave të Kur'anit Fisnik dhe Sunnetit të Ndershëm, aplikimi i urdhërave dhe qëndrimi te kufinj të tyre.

Është tradhti ndaj All-llahut dhe Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, që të shahen sahabet e Pejgamberit, alejhisselam, ose të anatemosen dy pleqt e ndershëm,

Ebu Bekri dhe Omeri, kurse ajetet e Kur'anit flasin se All-llahu është i kënaqur me ta, kurse Resulull-llahi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Mos i shani shokët e mi".

E mëshiroftë All-llahu nënë tonë, Aishen, radijall-llahu anha, e cila i ka thënë Urves, siç transmeton Muslimi:

"Biri i motrës sime, janë urdhëruar të kërkojnë falje për shokët e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kurse ata i shajnë".

Sa dëshmi e madhe është dëshmia e Husejn Museviut, i cili në librin e tij të çmueshëm: "Për All-llahun e pastaj për historinë", thotë:

"Nëse i pyet çifutët: kush janë njerëzit më të mirë në fenë tuaj? Ata do të thonë: shokët e Musait. Nëse i pyesim të krishterët: kush janë njerëzit më të mirë në fenë tuaj? Ata do të thonë: shokët e Isaut. E nëse i pyesim shiitët: kush janë njerëzit më të këqinjë sipas jush dhe besimit tuaj? Ata do të thonë: shokët e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem".

- Amaneti është paanshmëri dhe sinqeritet, ti zbresim njerëzit në pozitat e tyre dhe mos ti nënvlerësojmë, siç thotë All-llahu, subhanehu ve teala:

"O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini dro All-llahun se All-llahu di hollësisht për atë që vepron". (El-Maide: 8).

- Amanet është gjithashtu që mos ta ngri sim të poshtrin, mos ta lavdërojmë të paaftrin, mos t'ia dorëzojmë gjërat atij që se meriton, mos ti madhërojmë injorantët dhe mos ti arbitrojmë në fenë dhe dynjanë tonë.

Nëse e bëjmë të kundërtën e kësaj kemi bërë tradhti, e cila na e eliminon stabilitetin e dynjasë, jetën e këndshme dhe bazën e ci-

vilizimit. Sa bukur e ka titulluar Imam Buha-riu në "Librin mbi Telashet", "Kapitulli: kur të mbeten mbeturina e njerëzve", ku përmendi gjendjen e kohës së fundit. Në këtë kohë "njeriut që ska as një grimcë në hardallit iman në zemër, i thuhet sa i mençur dhe sa i kujdesshëm".

- Amanet është dëshmia për All-llahun, këshillimi i muslimanëve, sqarimi i të vërtetës.

Kur e kanë pyetur Hafidh Ali ibn Medinin mbi babën e tij, Abdullah ibn Xhaferin, ka thënë: babi im është i dobët (në transmetimin e haditheve). Kurse Shube ibn Haxhaxhi ka folur për djalin e tij ka thënë: "e kam emërtuar djalin tim Sad, mirëpo ai as që u bë i lumtur e as që shpëtoi". Kurse Imam Dhehebiu duke folur për biografinë e Ebu Ali El-Ehvaziu, në librin e tij "El-Mizan", tha: Po të kisha folur për hatër do të kisha folur për Ebu Alinë, sepse nga ai kam marur senedin e lartë në Kur'an".

- Amanet është lërja e pretendimit të rrejshëm.

Sepse "ai që mburret me atë që nuk e ka është sikur ai që vesh rroba të gënjeshtres".

Imam Dhehebiu ka përmendur në "Sijer" dhe Ibn Kethiri në "El-Bidaje ven-Nihaje" se Ebu Abdullah Hakim en-Nejsaburi, ua lexonte njerëzve përmirësimet që ia kishte bërë Hafidh Abdul-Gani ibn Seid, në librin e tij "El-Med'hal". Nuk u mjaftua me këtë por i dërgoi letër ku e falënderonte për këshillën. Atëherë Ibn Seidi tha: "kuptova se ishte njeri i mençur".

Ky është amaneti, mbi të cilin është ngritur qielli dhe toka: ta kontrollosh vetveten në çdo gjë, qoftë e vogël ose e madhe, t'ua dimë vlerën atyre që kanë vlerë.

Imam Sehaviiu përmend në librin e tij "El-Xhevahir ved-Durer" se hoxha i tij Ibn Haxheri, abstenoj nga dhënia mësimi në Sahihun e Imam Muslimit derisa nuk vdiq Zerkeshiu, sepse senedi i tij ishte më i lartë në këtë libër.

All-llahu e mëshiroftë Imam Sujutiun, sa bukur ka folur në librin "El-Fariku bejne Nakili ves-Sariki", si koment i fjalës së Muzeniut në fillimin e "Muhtesarit" të tij: "Libri mbi Pastërtinë". Ka thënë Imam Shafiu: All-llahu ka thënë: Kemi zbritur nga qielli ujë të pastër". A nuk e ka parë këtë ajet Muzeniun në Mus'haf e ta tregon pa ia adresuar Imamit të tij?!

Dijetarët kanë thënë: ai ka vepruar kështu sepse hapja me këtë ajet ka qenë vepër e Imam Shafiut, e jo e tija. Pastaj tha: tërë këtë e ka bërë nga kujdesi për amanetin dhe ikja nga tradhtia, sepse shoqërues shumë i keq është tradhtia, pastaj duke e zbatuar hadithin dhe duke i pasuar imamët në të kaluarën dhe në të tashmen, duke u ruajtur nga rrena dhe mburrja për gjëra që si posedon, nga pasimi i argumenteve me sa fuqi që ka, nga dëshira për të arritur deri te dobia dhe bereqeti, për ta ngritur veprën e tyre në gradën më të lartë nga shkalla më e ultë, për ta falënderuar dijen dhe dijetarët dhe për t'ia dhënë të drejtën të parit për shkak të vlerës që ka".

Dr. Muhamed Omer Devle
Përshtati: Bekir Halimi
Marrë nga: meshkat.net
13.8.2004

Komponentet e personalitetit islam

Pedagogjia islame synon nxjerjen e individit musliman, kurse individi musliman është ai që i vepron punët e mira (pozitive), pasi që vepra e mirë është qëllimi i krijimit dhe shpikjes, është lënda e sprovës dhe testimi në arenën e jetës së kësaj bote dhe është kriteri i suksesit në ahiret:

"Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t'ju provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është ngadhënjyesi, mëkatfalësi". (El-Mulk: 2).

Vepra përbëhet nga tre unaza:

- vepra e vullnetit (dëshirës);
- vepra e mendimit (idesë);
- vepra e gjymtyrëve.

Njeriu asnjëherë nuk ndalet nga veprimi, mirëpo dallon pjekja e unazave të veprës që e realizon. Disa vepra ndalen në unazën e parë, në unazën e vullnetit (dëshirës) e bëhet shpresë, e disa ndalen në unazën e dytë, unazën e mendimit (idesë) e bëhet ajo vepër vetëm ide, e ndonjëra vazhdon deri në përfudnim, unaza e zbatimit konkret të atij vullneti dhe ideje, dhe të konsiderohet vepër.

Ajo që e vendos rolin e secilës unazë të veprës është shkalla e aftësisë, ose urtësia, sipas fjalorit Kur'anor, të cilën e arrinë secila unazë. Kjo shkallë e aftësisë është fryt i edukimit që kujdeset për zhvillimin dhe përkujdesin e këtyre unazave.

Suksesi në unazën e vullnetit është "sinqeriteti" në vepër, kurse sukcesi në unazën e idesë (mendimit) është "saktësia" e asaj vepre dhe sukcesi në unazën e fundit është përkryerja e veprës.

Ajo që e përcakton ecurinë e veprës drejt mirësisë ose keqësisë është unaza e parë: unaza e vullnetit (dëshirës). Nëse vullneti është pozitiv dhe i mirë, kjo shtrihet edhe në unazën e dytë dhe në atë të tretën, e nëse vullneti është negativ dhe i keq, atëherë kjo shtrihet edhe në unazën e idesë dhe aplikimit me gjymtyrë.

Për këtë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, unazën e parë e ka emërtuar me termin nijet, në hadithin që e transmeton Buhariu në sahihun e tij:

"Veprat vlerësohen sipas nijetit...".

Duke u nisur nga kjo që prezentuam, pedagogjia islame mirret me edukimin e stacioneve të këtyre tre unazave të veprës: shpirtit, mendjes dhe trupit.

Vepra, e cila buron nga këto tre unazat degëzohet dhe shtrihet që të kaplon të gjitha mejdanet e jetës dhe fenomenet e saja: fenomenin fetar, shoqëror dhe kosmologjik.

Nëse i përsosim synimet, mjetet dhe veglat e veprës atëherë kjo vepër bëhet e mirë dhe përmirësuese (pozitive dhe reformuese).

Fatkeqësisht domethënia e "veprës së mirë" nuk ka mbetur në origjinalitetin dhe gjithpërfshirshmërinë e vet, por në kohët e fanatizmit medhhebor, ngurtësisë intelektuale, njëmendësisë politike, çrregullimit ideologjik, është copëzuar, i është ngushtësuar domethënia dhe është shëmtuar përmbajtja, saqë përdorimet aktuale nënkuptojnë ritualet fetare, këshillat fetare, morali individual, e me këtë shëmtim është shëmtuar edhe personaliteti musliman ose fotografia e njeriut të mirë (pozitiv).

Domethënia e veprës së mirë

Shprehja vepër në Kur'an është përmendur në mëse 359 vende, kuse sa herë është përmendur në hadithet e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është vështirë të saktësohet, sepse është një numër shumë i madh.

Në të gjitha rastet kur përmendet shprehja vepër, i shoqërohet edhe epiteti, e mirë ose e keqe.

"Vepra e mirë" është përkthim praktik ose aplikim i plotë i raporteve që i ka përcaktuar pedagogjia islame mes njeriut të formuluar nga kjo pedagogji dhe Krijuesit, gjithësisë, njeriut, jetës dhe ahiretit.

Kur'ani sjell shembuj të veprës, prej tyre do të përmendim:

- Vepër shkencore kulturore:

"...All-llahu i lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. All-llahu është i njohur mirë me atë që punoni". (El-Muxhadele: 11).

- Politikat e padrejta:

"Ata që mohojnë argumentet e All-llahut, mbysin pejgamberët pa farë të drejte, mbysin edhe njerëz që këshillojnë për të drejtën, ti ata lajmëroi për një ndëshkim të dhëmbshëm e pikëllues. Ata veprat e tyre i asgjësuan në këtë botë dhe në botën tjetër, ata nuk kanë ndonjë mbrojtës". (Ali Imran: 21- 22).

- Vepër fetare:

"Beni israilët i kaluam përtej detit, e ata u takuan me një popull që adhuronte do statuja të tyre, dhe thanë: "O Musa, na e bën edhe neve një zot (statujë) si zotët që i kanë ata (ai popull)". Ai (Musai) tha: "Ju jeni popull që nuk di". Vërtet, ai popull (që po adhuron idhuj) është i shkatërruar në atë (adhurim) dhe ajo që vepruan është e asgjësuar (s'ka dobi)". (A'raf: 138- 139).

- Veprimtarinë e përgjithshme politike:

Ajetet e fundit të sures Enfal flasin për politikën e ummetit islam, ate të brendshmen,

ate të jashtmen dhe e ka cilësuar si vepër, të cilën e sheh All-llahu, edhe ate që duket edhe ate që fshehet.

"Është e vërtetë se ata që besuan, u shpërngulën dhe luftuan me pasurinë e shpirtin e tyre në rrugën e All-llahut, dhe ata që strehuan (të shpërngulurit) dhe u ndihmuan, të tillët janë miq të njëri-tjetrit (në ndihmë dhe në trashëgim). Ata që besuan por nuk u shpërngulën, ju nuk keni përkujdes as ndihmë për ta derisa të shpërngulen edhe ata. E nëse ata kërkojnë ndihmë prej jush për çështjen e fesë, atëherë jeni të obliguar t'u ndihmoni, përveç nëse është puna kundër një populli që me të keni marrëveshje (nuk mund t'u ndihmoni në luftë kundër atij populli). All-llahu mbikëqyr atë që veproni". (El-Enfal: 72).

- Veprimtarinë bujqësore:

"Ashtu që ata të hanë nga ata fruta dhe nga çka prodhojnë vetë duart e tyre. A i gëzojnë këto dhe nuk falënderojnë?". (Jasin: 35).

- Veprimtaria zanatore:

"Sa i përket anijes, ajo ishte pronë e do të varfërve që veprojnë në det, ...". (El-Kehf: 79).

- Veprimtaria industriale:

"(I thamë) Puno këmisha të plota (nga hekuri) dhe thurri me precizitet ato. Dhe bëni vepra të mira (o familje e Davudit), se Unë vëzhgoj atë që ju punoni". (Es-Sebe: 11).

- Veprimtari administrative:

"All-llahu caktoi obligim që lëmosha (zeqati etj.) t'ju takojnë vetëm: të varfërve (nevojtarëve), të ngratëve (që s'kanë fare), punonjësve (që e tubojnë),...". (Et-Teube: 60).

- Veprimtari ideologjike dhe pedagogjike:

"E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e All-llahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: "Unë jam prej muslimanëve?". (Fussilet: 33).

- Veprimtaria ekonomike:

"All-llahu e zhduk kamatën dhe e shton lëmoshën, All-llahu nuk e do asnjë besëprerë

dhe mëkatar. S'ka dyshim se ata që besuan dhe bënë vepra të mira, e falën namazin dhe e dhanë zekatin, ata i pret shpërblim i madh te Zoti i tyre, ata nuk do të kenë kurrfarë frike as brengosje". (El-Bekare: 276- 277).

- Veprimtari gjyqësore:

"...Mos e fshehni dëshminë, sepse ai që e fsheh atë, ai është mëkatar me zemrën e vet, All-llahu di atë që veproni". (El-Bekare: 283).

- Veprimtari në çdo aspekt, edhe në rrafshin individual edhe në ate shoqëror:

"Ai është që ju vë në gjumë natën dhe e di çka vepruat ditën, pastaj ju ngjall-zgjon në të (ditën) deri në afatin e caktuar (vdekje). Pastaj do të ktheheni e do t'ju njoftojë me atë që keni pas vepruar". (El-Enam: 60).

"Pastaj juve ju bëmë zëvendësues pas tyre në Tokë për t'ju parë si do të veproni". (Junus: 14).

Sipas kësaj që përmendëm del në shesh se këto vepra i kaplojnë tre aspektet e veprimtarisë: veprën fetare, shoqërore dhe kosmologjike.

Pasiqë e definuam veprën në këtë formë, domosdo e kemi të flasim për pesë principe që kanë të bëjnë me vet veprën:

1) Tre kategoritë e veprës e plotësojnë njëra tjetrën dhe nuk kanë rol nëse janë të ndara nga njëra tjetra.

Vepra fetare ngërthen synimet dhe qëllimet e jetës, kurse vepra shoqërore dhe kosmologjike ngërthen mjetet e përshtatshme për realizimin e këtyre qëllimeve dhe synimeve. Andaj në mungesë të synimeve, nuk ka dobi nga mjetet, kurse në mungesë të mjeteve synimet janë sterile, të pafrytshme.

2) Vepra e mirë nuk mjaftohet vetëm me sjelljen e dobisë, pro i kalon këto kufinjë dhe nisjet në sulm kundër të keqes dhe të dëmshmes.

Vepra e mirë sipas gjurmëve ndahet në dy grupe:

Vepër që synon arritjet e dobisë për njeriun dhe kënaqjen e All-llahut.

Vepër që synon largimin e të keqes për njeriun dhe që e hihdëron All-llahun.

Njeriu që i zbaton dy llojet e veprimeve quhet: i mirë dhe përmirësues.

Nuk mjafton zbatimi i vetëm njëres pjesë të veprave të mira, sepse nëse e para e kultivon të mirën dhe e zhvillon ate, e dyta e pengon shkakun e prishjes, dekadencës dhe dështimit.

Këtë lloj të njeriut synon ta formon pedagogjia islame.

Andaj në Kur'an tregohet se shkatërrimi nuk e kaplon një popull që përbëhet nga njerëz të mirë dhe përmirësues (pozitiv dhe reformator):

"E Zoti yt nuk është që të shkatërrojë mizorisht vendet, nëse banorët e tyre janë punëmire". (Hud: 117).

"Ne i shpërndajmë ata në grupe nëpër tokë; prej tyre ka të mirë, por edhe jo të tillë. Ne i provuam me të mira e me të këqija, në mënyrë që të tërhiqen nga e keqja". (El-A'raf: 168).

3) Vepra e mirë sipas epitetit ndahet në vepër morale dhe të suksesshme.

Bashkimi i këtyre dy epitetëve është i domosdoshëm në pedagogjinë islame, sepse një vepër nëse është e moralshme e nuk është e sukseshme, nuk sjell dobi e as që largon dëmin, kurse poqe e sukseshme, mirëpo e pamoralshme, ajo nuk sjell lumturi e as siguri. 4) Principi i pragmatizmit.

Pedagogjia islame nuk e mohon principin e pragmatizmit asnjëherë. Parimi të jesh i dobishëm për vehte dhe rrethin është princip që përmendet shumë herë në Kur'an dhe në hadithet e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Andaj ata që bëjnë dallim mes veprës dhe dobisë janë ose njerëz fanatik për idealen, të cilën shumë vështirë që ka mundësi që ta arrijë njeriu, ose njerëz që kanë rënë nën ndikimin e filozofive dhe feve tjera që thërrasin në vetdenim dhe vuajtje.

Ky pragmatizëm për të cilën jemi duke folur ndërlihdet ngusht me natyrën e njeriut, i përmbush kërkesat materiale, shpirtërore dhe shoqërore të njeriut.

Ky pragmatizëm dallon nga pragmatizmi amerikan i cili i sjell njeriut dobi në disa mejdane dhe i nxjerr dëmet në shesh në mejdane tjera të jetës së njeriut, ose ndoshta sjell deri te suksesi, mirëpo nuk e sjell edhe lumturinë.

Andaj pragmatizmi të cilin e kultivon pedagogjia islame nuk përkufizohet vetëm në një person ose një grup dhe nuk ka të bëjë vetëm me një fazë të jetës ose disa stacione të saja, por i kaplon edhe etapën e jetës edhe përfundimit.

Kur'ani i sjell dobitë e veprës së mirë, prej tyre do të përmendim:

Sigurinë, mëkëmbësinë në tokë, jetën e këndshme, bollëkun e të mirave dhe bereqetit, shkallët e larta, shpërblimin e mirë, kënaqjen me dhuntitë e All-llahut, shëndeti psikofizik, qetësia shoqërore, bindja, hyrja në xhennet.

Kurse në anën tjetër i përmend dëmet e veprës së keqe, prej tyre do ti përmendim:

Jeta e vështirë, dëbimi nga vëndbanimi, përçarja e shoqërive dhe popujve, rënia e pozitës, rënia ekonomike, shkatërrimi shoqëror, rënia civilizuese, çrregullimi shpirtëror dhe ideologjik, vuajtje dhe diferencime, sëmundje psikofizike, hyrje në xhehenem, etj.

"Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre". (En-Nahl: 97).

"A menduan ata, të cilët vepruan në të këqija, se në jetën e tyre dhe në vdekjen e tyre do t'i bëjmë të barabartë me ata që besuan dhe bënë vepra të mira? Sa i shëmtuar është gjykimi i tyre?". (El-Xhathije: 21).

5) Domosdoshmëria e përgaditjes, edukimit dhe stërvitjes për "vepra të mira", dhe sigurimi i ambientit, institucioneve, metoda-

ve, mjeteve dhe përvojave.

Është e paparafytyruar që të lihet vepra e mirë rezultat i individit ose i tentimeve stihike dhe përvojave sipërfaqësore, ose institucioneve klasike, organizatave patriarkale, rendeve të ndryshme dervishore ose teqeve.

Jo rastësisht "vepra e mirë" në Kur'an dhe Sunnet përmendet krahas besimit, dijjes, urtësisë, mundit konstant, bashkëpunimit shoqëror në bamirësi dhe devotshmëri, mosbashkëpunimit në mëkat dhe armiqësi, kurse vepra e keqe përmendet krahas injorancës dhe dembelisë, që nxjerrin në shesh mosbesimin, dyftyrësinë dhe luksozin.

Komponentet e njeriut të mirë që lindin "veprën e mirë"

Për të kuptuar këtë më mirë duhet të njohim definicionin e Kur'anit për veprën.

Sipas Kur'anit vepër është çdo lëvizje e qëllimtare që sjell të mirën dhe largon të keqen, kurse lëvizjet e paqëllimta, sipas Kur'anit emërtohen lëvizje, e jo vepër, siç është lëvizja e diellit, e hënës, erërave, etj.

Pra, vepër qenka lëvizje dhe qëllim, kurse lëvizjen drejt një qëllimi Kur'ani e quan vullnet (dëshirë), kurse vullneti cilësohet me vendosmëri dhe sinqeritet, nëse lëviz deri në atë shkallë që e realizon qëllimin, kurse ky qëllim cilësohet si i saktë nëse është në përputhje me ligjet e All-llahut në gjithësi dhe shoqëri.

Forca është fryt i vullnetit, kurse vizioni fryt i mundësisë (aftësisë).

Andaj vepra përbëhet nga: mundësia dhe vullneti.

Çka është mundësia?

Çka është vullneti?

Mundësia është dy lloje:

- Mundësia në kuptimin e energjisë, dhe në këtë participojnë edhe njerëzit, edhe kafshët, edhe natyra e ngurtë.

- Mundësia e shfrytëzimit dhe nënshtrimit.

Kjo është aftësi për të shfrytëzuar energjinë e krijesave në gjithësi, sipas ligjeve që e organizojnë jetesën e tyre në gjithësi dhe në përputhje me nevojat e njeriut për të mbetur dhe për tu zhvilluar.

Pedagogjia islame i jep rëndësi të madhe këtij elementi, sepse përsosja e kësaj mundësie i përgadit njeriut musliman mundësinë për tu bindur në Fuqinë e All-llahut dhe ti sheh fenomenet e krijesave dhe dhuntive të Tij, kurse kjo ia përforcon pozitën si mëkëmbës në tokë.

Mundësia për shfytëzim dhe nënshtrim është fryt i bashkëdyzimit mes mundësive logjike të pjekura dhe përvojave edukuese fetare, shoqërore dhe kosmologjike. Domethënë mundësia e shfytëzimit lind nëpërmjet shikimit logjik të shëndosh në historinë e zhvillimit të mendimeve, personave, ndodhive dhe gjërave.

Vullneti është orientimi i dëshirave të një individi drejt një synimi të caktuar. Ky vullnet është i shëndosh nëse orientohet drejt nevojave të tija esenciale dhe madhore, në sasi dhe mënyrë që i sigurojnë sa ma shumë dobi dhe i largojnë sa ma shumë dëm, në jetën dhe pas përfundimit të jetës së tij.

Sipas pedagogjisë islame, duke u mbështetur në Kur'an dhe Sunnet, nevojat që i sjellin njeriut gjërat e dobishme dhe ia largojnë ato të dëmshmet quhen: "Shembulli suprem"

Pra, vullneti qenka bashkëdyzimi mes mundësive logjike dhe shembullit suprem.

Nga kjo që thamë del në shesh se "vepra e mirë" që është veçori e individit të mirë (pozitiv) është fryt i disa proceseve pedagogjike. Mund ta thjeshtojmë me këto formulime:

Vepra e mirë = mundësia e shfrytëzimit + vullneti i vendosur

Vullneti i vendosur = mundësitë e pjekura logjike + shembulli suprem

Mundësitë e shfrytëzimit = mundësitë logjike të pjekura + përvoja edukuese fetare, shoqërore dhe kosmologjike.

Edukimi i komponenteve të veprës së mirë

Edukimi i mundësive logjike (detyra e logjikës)

Mundësitë logjike dalin në shesh vetvetiu për nga aftësia e njeriut për të organizuar jetën e individëve dhe shoqërive.

a) Njeriu që ka aftësi për të sjellur gjërat e dobishme dhe të sakta dhe për të larguar të dëmshmet dhe të gabuarat, është i mençur dhe i urtë.

b) Njeriu që nuk ka aftësi për të sjellur gjërat e dobishme dhe të sakta e as për ti larguar gjërat e dëmshme dhe të gabuara është mendjelehtë dhe budalla.

c) Njeriu që ka më shumë aftësi për të sjellur gjëra të dëmshme dhe të këqija dhe pengim i asaj që është e dobishme dhe e saktë, e ky është dhëlpërak, dinak dhe i keq.

Pedagogjia islame synon kultivimin e llojit të parë dhe pastrimin e individëve dhe shoqërive nga lloji i dytë dhe i tretë.

Njeriu lind me mundësi logjike, mirëpo ka nevojë për zhvillimin e tyre dhe stërvitje për përkujdesin e mirë të tyre.

Zhvillimi, aktiviteti, shëndeti dhe sëmundja e tyre varen nga lloji i edukimit që mer njeriu dhe vetëdija dhe përvoja e atyre që kanë marrë përsipër edukimin e këtyre mundësive.

Këto mundësi duhet ti shfrytëzojmë sipas një metodologjie të caktuar që ne e quajmë "metodologji të të logjikuarit", e cila ndërthen në vehte tre sektore kryesore:

- hapat e të logjikuarit;
- mënyrat e të logjikuarit;
- llojet e të logjikuarit.

Pedagogjia islame kur vepron në edukimin dhe kultivimin e mundësive logjike përqëndrohet në katër gjëra kryesore:

Një: klasifikimi i mundësive logjike.

Dy: prezentimi i metodologjisë së logjikimit të shëndoshë.

Tre: mënyra e zhvillimit të mundësive logjike

dhe metodologjisë së logjikimit të shëndoshë.

Katër: sigurimi i ambientit të nevojshëm për zhvillimin e mundësive logjike.

Klasifikimi i mundësive logjike sipas Kur'anit

Kur'ani nuk i ka klasifikuar dhe renditur sipas gradës dhe raporteve, mirëpo duke i ndërlidhur me argumentet shtesë, e kuptojmë qartë qëllimin e secilës mundësi.

Mundësia e mendjes, sipas argumenteve shtesë kuptojmë se është mundësi e depozimit të informatave, rikthimit dhe punësimit të tyre sipas nevojës.

Mundësia e komentimit, kjo sipas Kur'anit është mundësia e perceptimit të praktikimeve konkrete të konkluzave teorike ose e kundërta. Siç ndodhi me Jusufin, alejhisselam, në komentimin e ëndërrave dhe me Hidrin në komentimin dhe sqarimin e veprimeve të veta.

Mundësia e meditimit, kjo sipas Kur'anit domethënë ndërlidhja mes shkaqeve dhe rezultateve dhe zbulimin e shkaqeve që kanë sjellur deri në këto rezultate.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "A nuk meditojnë (lexojnë me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej All-llahut, do të gjenin në te shumë kundërtënie". (En-Nisa: 82).

"A pritët prej jush (hipokritëve) që nëse merrni sundimin (ose zbrapseni prej fesë islame) të bëni trazira në tokë dhe të ndërpreni lidhjet e akraballëkut? Të tillët janë që All-llahu i mallkoi, i bëri të shurdhët dhe ua verboi të parit e tyre. A nuk e studiojnë me vëmendje Kur'anin? Por jo, ata janë zemra që kanë drynat e vet!". (Muhammed: 22- 24).

Mundësia e logjikimit, është shfrytëzimi i aftësive logjike për të arritur deri te e vërteta.

Mundësia e përkujtimit, domethënë mundësia për të rikthyer përvojën dhe për ta parë aspektin e saktë në te.

Shikimi është mundësi logjike dhe së bashku me dëgjimin janë mjete për të zbulu-

ar të panjohurën. Shikimi mund të jetë i qëlluar dhe mund të jetë i gabuar. All-llahu, subhanehu ve teala, e thirrë njeriun që të shikon gjithësinë, detajete e gjithësisë, krijimin e njeriut, zhvillimin dhe përfundimin e tij.

Dëshmia është mundësi logjike, me të participojnë edhe fuqitë materiale, mirëpo dallon nga mundësia e shikimit, sepse çdo herë është e saktë.

Vizioni është mundësi logjike depërtuese, ndihmon për të poseduar kuptim preciz dhe thellësim në analizën e fenomenit dhe zbulimin e thellësirave të tija.

Urtësia është mundësi logjike që ndihmon për të kuptuar marrëdhëniet teorike dhe aftësi psikofizike për të shndërruar raportet e përmendura në praktikë konkrete, saktësimi dhe kujdesi për to.

Metodologjia e logjikimit të shëndoshë

Më herët thamë se metodologjia e logjikimit të shëndoshë përmban tre komponente kryesore:

Hapat e logjikimit, mënyrat e logjikimit dhe llojet e logjikimit.

a) Hapat e logjikimit.

Hapat e logjikimit të shëndoshë fillojnë me:

- ndjenjat për fenomenin, pastaj kalojnë në hapin e

- vetëdijes mbi këtë fenomen dhe përkufizimin e kornizave dhe medjanit të tij, që më vonë të kalon në hapin e

- njohjes detale të këtij fenomeni, duke i grumbulluar informatat që kanë të bëjnë me te, që më pastaj të kalojmë në hapin e

- analizës së këtyre informatave, meditimit rreth tyre, klasifikimit dhe zbulimit të raporteve mes tyre, që më në fund të kalojmë në hapin e

- zbulimit të urtësisë që gjindet pas këtij fenomeni.

Kur'ani këto hapa të logjikimit i konsideron cilësi esenciale të një besimtarit, ndalon

kundërshtimin e tyre dhe kërcënohet me marrje në përgjegjësi:

"Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi". (El-Isra: 36).

Madje Kur'ani e qorton me të madhe atë i cili që nga dëgjimi i parë i problemit kërcen për të dhënë vendime dhe zgjidhje, duke mos lejuar që ky problem të depërton deri në brendësi të njeriut që të marrin pjesë të gjitha mundësitë logjike në analizimin e tij.

Kur'ani kërcënohet me denim hyjnor për këta njerëz, pasi që ky reagim shkakton gabim në gjykim dhe akuzë kundër të pafajshmive:

"Kur ju atë (shpifjen) e përcollët me gjuhën tuaj dhe për atë që nuk kishin kurrfarë dije folëshit duke menduar se ajo ishte imtësi e parëndësishme, ndërsa te All-llahu ajo është e madhe. E përse, kur e dëgjuat atë, nuk thatë: "Ne nuk na takon të flasim për këtë. I lartë je Ti, kjo është shpifje e madhe!" All-llahu ju këshillon që një gjë e tillë të mos përsëritet kurrë, nëse jeni besimtarë të denjë". (En-Nur: 15- 17).

Kur të komplikohet gjendja dhe qëndrimi, sidomos ato që kanë të bëjnë me luftën dhe paqën, ose çeshtjet e rezikshme, dhe ka nevojë për shkallë të lartë të mundësive logjike, pervojave të thella dhe metodologjisë së urtë, Kur'ani i qorton ata që i pranojnë me biseda të kota dhe thashethëme (dezinformata) dhe kërkon që të themelohet institucioni i specializuar për të analizuar qëndrimet dhe problemin, njohjen e shkaqeve dhe dhënien e zgjidhejeve të përshtatshme:

"Madje kur u vjen atyre (munafikëve) ndonjë lajm qetësues (kur fitojnë myslimanët) ose shqetësues (kur dështojnë), ata e përhapin atë, e sikur t'ia linin atë (përhapien lajmit) Pejgamberit dhe përgjegjësve të tyre, ata do dinin të nxjerrin përfundime (se si do të duhej shpallur). Por sikur të mos ishte dhuntia e All-llahut ndaj jush dhe mëshira e

Tij, atëherë ju, pos një pakice, do të ndiqnit rrugën e djallit". (En-Nisa: 83).

Format e logjikimit

Format e logjikimit përfshijn siqë vijon:

a) Stërvitja e nxënësit në vetkritikë në vend të logjikimit arsyetues.

Kemi për qëllim mënyrën e logjikimit që tërë përgjegjësin e bartë vet personi në të gjitha gjërat dhe problemet që i ndodhin ose dështimin që e përjeton.

Logjikim i arsyetimit është ai logjikim i cili e paraqet njeriun e plotë, e nëse gabon e amneston nga përgjegjësia dhe i hulumton shkaqet jashtë, kurse gabimin, mangësinë dhe dështimin ia adreson tjetërkujt.

Kur'ani në të gjitha udhëzimet e tija vetkritikën e paraqet si rregull kryesor në të gjitha mangësitë dhe gabimet individuale dhe kolektive.

Prej udhëzimeve në këtë kontekst është ajeti Kur'anor:

"Çfarëdo e keqe që mund t'ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai u falë". (Esh-Shura: 30).

Në tregimin mbi Ademin, alejhisselam, dhe shejtanin kemi udhëzime të qarta për vetkritikë dhe akuzim i logjikës së arsyetimit dhe lënja e përgjegjesisë tjerëve. Edhe pse roli i shejtanit nuk mohohet në gabimin e Ademit dhe gruas së tij, mirëpo sërish All-llahu, subhanehu ve teala, ua len përgjegjësinë e gabimit të tyre atyre vet. Ky pa dyshim se është udhëzim për pasardhësit e Ademit, alejhisselam, që vetkritikën ta kenë metodologji në përmirësimin e pasojave negative që vinë nga veprimet e gabuara:

"...Zoti i tyre i thirri (duke u thënë): "A nuk ua ndalova ju dyve atë pemë dhe a nuk ju thashë ju dyve se shejtani është armik i hapët për ju?!" Ata të dy thanë: "Zoti ynë, ne i bëmë të padrejtë(i dëmtuam) vetvetes sonë, në qoftë se nuk na falë dhe nuk na më-

shiron, ne me siguri do të jemi prej të shkatërruarve!". (El-Araf: 22- 23).

Ky tregim poashtu na tregon se metodologjia e logjikimit arsyetues dhe adresimi i gabimeve te të tjerët është metodologji e logjikimit iblisor.

Në realitet, nëse i analizojmë mirë gabimet që ndodhin ose fatkeqësitë që binë mbi njerëzit, sqarojnë se këto gabime dhe fatkeqësi janë përgjegjësi e atij që bien mbi te, sepse fatkeqësia lind nga bashkëdyzimi i forcës me dobësinë, andaj asnjëherë nuk mund të lindë fatkeqësia nga takimi i fuqisë me fuqinë.

Fatkeqësitë ndodhin për shkak të dobësisë së atij që i ka rënë kjo fatkeqësi dhe fuqisë së atij që e ka shkaktuar këtë fatkeqësi. Poqëse ky, mbi të cilin ka rënë fatkeqësia do të ishte i fuqishëm, fuqia e tij nuk do ta lente të bjer mbi te. Andaj All-llahu i llogarit edhe të shtypurit dhe të dobtit, ashtu sikur i llogarit të fuqishmit dhe të dhunshmit, dhe secilin prej tyre e quan zullumqar: i pari është zullumqar i vetvetes, pse nuk është armatosur me fuqi, pse nuk e ka përdorur energjinë dhe mundëistë e tija për të rezistuar sulmin, kurse tjetri është zullumqar i njerëzve, sepse e përdor fuqinë e tij për armiqësi dhe përkrahje të të kotës, në vend se ta përdorë për ta ndihmuar të vërtetën:

"Engjëjt që ua morën shpirtin e atyre që ishin mizorë të vetvetës ju thanë: "Në çka ishit ju? - Ata thanë: "Ne ishim të paaftë në atë tokë!" (engjëjt) ju thanë: "A nuk ishte e gjërë toka e All-llahut e të migronit në të?" (e të praktikonit lirisht fenë e Zotit). Vendi i tyre është xhehennemi dhe sa vend i keq është ai!". (En- Nisa: 97).

Në anën tjetër All-llahu i lavdëron ata të fuqishëm që kur u bjer ndonjë zullum ose padrejtësi, e rezistojnë me fuqi:

"...edhe ata që kur i godet e padrejta, i kundërvihen". (esh-Shura: 39).

b) Stërvitja e nxënësit në logjikim global në vend të logjikimit parcial.

Kur'ani kur flet për dijen i përmend tre shprehje:

Dije sipërfaqësore (dhahirul-ilmi), ngërthim i dijes (ihatetu bil-ilmi) dhe thellësim në dije (er-Rusuh fil-ilmi).

Dija sipërfaqësore ndalet vetëm në studimin e aspektit që duket dhe pa dyshim se është fryt i logjikimit parcial.

Kurse ngërthimi i dijes, domethënë dije për temat e tashme të dijes, komponentet e tija kryesore dhe detajet e imta në të cilën ka arritur dija.

Kurse thellësimi në dije domethënë dija për të kaluarën e dijes, komponentet kryesore dhe detajet e temave të dijes, raportet mes këtyre detajeve gjatë historisë, aftësia për ti kombinuar të gjitha.

Ngërthimi dhe thellimi në dije është fryt i logjikimit global.

Ngërthimi i dijes e sjell njeriun deri te besimi, mirëpo nuk e sjell deri te bindja, kurse mosngërthimi me dije, detyrimisht shpjen në përgënjeshttrim dhe divergjenca:

"Por ja, ata përgënjeshtroan atë (Kur'anin) pa e kuptuar dhe pa ju ardhur shpjegimi i tij. Po kështu, gënjenin edhe ata që ishin më përpara. Shiko si ishte përfundimi i zullumqarëve". (Junus: 39).

Kurse thellësimi në dije shpjen në besim, siç na tregon All-llahu, subhanehu ve teala:

"...Dijetarët e pajisur me dituri thonë: "Ne u kemi besuar atij (atyre që janë të paqarta), të gjitha janë nga Zoti ynë!". (Ali Imran: 7).

Zakonisht logjikimi global ndodhë në kohën e përpjekjeve dhe progresit shkencor, atëherë ka thellime në hulumtime, durim dhe studime thelbësore. Në këtë kohë shkenctarët kanë gjakftohtësi dhe durim gjatë studimeve, e kjo u ndihmon të arrijnë në shkallën e thellësimit dhe inovacionit.

Kurse logjikimi parcial zakonisht ndërli-dhet me kohërat e ngurtësisë dhe imitimit (taklidit), dobësisë së fuqive intelektuale dhe animit kah epshi.

Rreziku i logjikimit parcial qëndron në faktin se është logjikim selektiv dhe se përfundon me vendime të gabuara dhe devijuese, e përçan unitetin e tëmës, e pjesëzon mejdanin e njohjes dhe fenomeneve shkencore, e kjo reflektohet në pjesëzimin e fenomeneve shoqërore dhe përçan unitetin e kolektiviteteve. Në këtë aludon Kur'ani kur thotë:

"Vërtet ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhammed) nuk ke kurrfarë përgjegjësie. Çështja e tyre është vetëm te All-llahu, Ai do t'i njohë me atë që punuan". (El-Enam: 159).

Kur'ani tregon se parcializimi i logjikimit dhe kuptimit, sidomos në fe, shpien në shirk, sepse logjikimi dhe kuptimi parcial lënë zbrazëtira që e mbushin iluzionet dhe mendimet e gabuara:

"...e mos u bëni nga idhujtarët. Të cilët e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ku secili grup i gëzohet idesë së vet". (Er-Rum: 31- 32).

"...(I porositem) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të...". (Esh-Shura: 13).

c) Stërvitja e nxënësit në logjikim inovator e jo në logjikim imitues (klasik)

E reja në Kur'an është logjikimi i liru nga elementet patriarkale, zakonet, imitimi. Shikon një herë në mendimet e reja dhe një herë në realitet, e pastaj krahason mendimin me realitetin dhe hulumton përputhshmërinë dhe saktësinë. Andaj Kur'ani ka ndërlidhur mes shikimit në ajetet e Kur'anit që për atëherë ishin mendime të reja, dhe shikimit në argumentet e horizontit dhe njeriut, ku është realiteti dhe ndodhitë, e e udhëzoi logjikimin njerëzor për të zbuluar rezultatet e kësaj ndërlidhjeje, të cilat i vërtetojnë argumentet e Kur'anit.

Kurse logjikimi imitues, klasik është mos-përdorim i mundësive logjike dhe mbështetja në muhabete boshe, imitim i prindërve dhe të mjaftuarit me të zakonshmet. Nuk ka dallim nëse imitimi sillet rreth stereotipeve shumë të vjetra ose të tjerave shumë të reja, që të dy llojet janë asgjësim i forcave logjike:

"...Ne i gjetëm të parët tanë në këtë fe dhe ne jemi të orientuar gjurmëve të tyre". (EZ-Zuhruf: 23).

Kur'ani ua mohon ngurtësinë e imituesve dhe u brohorit që të lirohen nga iluzioni i imitimit:

"E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): "Pranonni atë që All-llahu e shpalli"! Ata thonë: "Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë"! Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t'i pasonin)?". (El-Bekare: 170).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ia tërhjek vërejtjen njeriut që mos të jetë pa ide dhe pa vullnet duke thënë:

"Mos të jetë dikush prej jush imitues e thotë: nëse njerëzit bajnë mirë, baj edhe unë mirë, e nëse ata bajnë keq, edhe unë baj keq...". (Daif, Tirmidhiu).

d) Stërvitja e nxënësit në logjikim shkencor në vend të paragjyqimeve dhe epsheve

Kur'ani ka përplot udhëzime që stimulojnë studimet shkencore dhe stërvitjen në te. Thërret që mos të nxitojmë në dhënien e konkluzave para se ti grumbullojmë informatat e nevojshme dhe para se ta njohim realitetin plotësisht:

"O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë". (El-Huxhurat: 6).

Na stimulon që të kërkojmë argument për secilin besim.

"Këta, populli ynë ka besuar zota të tjerë pos Atij, pse pra nuk sjellin ndonjë argument

të qartë për ata? A ka më mizor se ai që shpif gënjeshtër ndaj All-llahut?". (El-Kehf: 15).

Na thërret që të sigurohemi në çdo gjë para se të gjykojmë për praninë ose refuzimin dhe na ndalon që të shkapërderdhim forcën dëgjimore, shikuese dhe logjike në çështje për të cilat nuk ka mjaft argumente shkencore:

"Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi". (El-Isra: 36).

Kur'ani na ndalon pasimin e paragjykitimit dhe iu kërcënohet atyre që pasojnë paragjykimin:

"...Po ata (idhujtarët), nuk ndjekin tjetër vetëm se paragjykitime dhe çka duan vetë, megjithatë prej Zotit të tyre u pat ardhur udhëzimi". (En-Nexhm: 23).

"Ata nuk dinë asgjë për atë (emërtim), ata nuk ndjekin tjetër vetëm paragjykitime, e paragjykitimi nuk është asgjë ndaj së vërtetës". (En-Nexhm: 28).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka thënë:

"Kujdes nga paragjykitimet, sepse paragjykitimet janë gënjeshtër". (Buhariu).

Logjikimi shkencor nuk është i kufizuar vetëm në vendet e mësimit dhe laboratoritë e hulumtimit, por duhet të jetë cilësi e njeriut në jetën e tij të përditshme, raportet personale dhe të përgjithshme, qëndrimet miqësore dhe armiqësore. Kjo edhe i dallon shoqëritë e zhvilluara nga ato të pazhvilluarat.

e) Stërvitja e nxënësit në logjikim kolektiv e jo në logjikim individual.

Kur'ani dhe Sunneti janë përplot me udhëzime dhe praktikime të njëpasnjëshme me qëllim që ta stërvit njeriun në logjikim kolektiv, i cili e ndërlikon përfundimin e individit me xhematin dhe përfundimin e xhematit me individin dhe përkujdesin reciprok e ban cilësi të domosdoshme të një civilizimi të lartë.

Udhëzimet në këtë drejtim janë të shumta, prej tyre:

"Ruajuni nga e keqja (nga dënimi) që nuk i godet vetëm ata që bënë mizori prej jush, (por edhe të mirët), dhe ta dini se All-llahu është ndëshkues i rreptë". (El-Enfal: 25).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na mëson duke na thënë:

"Secili prej jush është bari dhe do të jap përgjegjësi për tufën e tij". (Buhariu).

"Shembulli i muslimanëve në dashurinë, mëshriën dhe solidaritetin mes tyre është sikur shembulli i trupit, nëse i ankohet një gjymtyrë, i tërë trupi ankohet nga pagjumësia dhe temperatura". (Muslimi).

Këtë edhe më shumë e shpikat principi i konsultimit që ekziston në Islam (shura).

f) Stërvitja e nxënësit në logjikimin sipas ligjeve të Zotit e jo sipas bestytnive ose mrekullive.

Logjikimi sipas ligjeve hyjnore domethënë logjikim i cili konsideron se gjithësia dhe shoqëria njerëzore zhvillohet sipas ligjeve të caktuara hyjnore dhe se bashkjetesa mes komponenteve të gjithësisë dhe suksesi në jetën shoqërore të njerëzimit mvaret nga përputhja e lëvizjeve në mejdanet e ndryshme të jetës me këto ligje.

Aq sa ma shumë arrinë njeriu ti zbulon këto ligje dhe aq sa ma mirë i shfrytëzon aq ma mirë mund ta shfrytëzon gjithësinë dhe shoqërinë njerëzore për realizimin e dy qëllimeve finale të pedagogjisë islame: mbetja e llojit njerëzor dhe ngritja e tij gjatë fazave të fillimit, jetës dhe përfundimit.

Kurse logjikimi bestytnor është fazë femënore e njerëzimit, ku dominonin forca iluzioniste dhe shpirta të shpikur që botëkuptimi i atëhershëm i personifikoi në statuja, idhuj dhe simbole të ndryshme.

Gjithashtu Kur'ani ua tërheq vërejtjen njerëzve nga logjikimi mrekullues, i cili e lan njeriun nga çdo përgjegjësi në ndryshim dhe vepër dhe pret të ndodhin mrekulli hyjnore për tu realizuar nevojat dhe për tu zgjidhur problemet e tija.

Llojet e mendimit (logjikimit)

1- Logjikimi analitik

Studion domethënien e simboleve dhe vepron sipas disa rregullave dhe teorive të caktuara.

2- Logjikimi eksperimental

Mirret me studimin e të vërtetave që kanë të bëjnë me komponente të gjithësisë së krijuar, siç është logjikimi fizik, kimik, etj.

3- Logjikimi moral

Mirret me vendimet që bëjnë dallime mes qëndrimeve dhe veprave dhe përparimit të tyre. I vleron veprat, janë të mira ose të këqija, në prizmë të besimit dhe principeve të caktuara.

4- Logjikimi artistik

Mirret me vendimet që bëjnë dallime mes qëndrimeve dhe veprave dhe përparimit të tyre. I vleron veprat, janë të bukura ose të shëmtuara, në prizmë të disa kriteve të caktuara të bukurisë.

Kriza e pedagogjisë bashkëkohore qëndron në ndamjen mes llojeve të përmendura të logjikimit dhe moskompletimi mes tyre, e kjo pa dyshim reflektohet në rezultatet e llojeve të logjikimit dhe në qëndrimet e ndryshme në jetë.

Ata që kanë logjikim analitik, janë të saktë në analizat matematikore, filozofi dhe jurisprudencë, mirëpo gabojnë shumë kur futen në mejdanin e shijes, raporteve të larta ndërnyerëzore dhe morale.

Gjithashtu edhe ithtarët e logjikimit eksperimental dhe artistik, janë të saktë në mejdanin e shkencës, sistemit dhe planifikimit, mirëpo gabojnë shumë në mejdanin e besimit dhe moralit.

Kurse në botën islame, për momentin dominon logjikimi moral, i cili është më i miri, mirëpo në mungesë të tre llojeve tjera, shkakton dekadencë në zhvillimin e shoqërisë muslimane.

Zhvillimi i mundësive logjike dhe metodologjia e logjikimit të shëndoshë

Boshti kryesor është bashkëdyzimi me komponentet e gjithësisë dhe ndodhive që ndodhin në te.

Mundësitë logjike zhvillohen dhe pjecken me studimin e gjithësisë dhe komponenteve të shkapërderdhura në ruzullin tokësor.

Andaj mësimet Kur'anor thërrasin që të ecim në ruzullin tokësor dhe të shohim elementet e ekzistencës dhe zhvillimit të tij.

Bashkëveprimi me ndodhitë duhet ti ketë dy dimensione: atë hapsinor dhe atë kohor, atë historik dhe atë gjeografik.

Dimenzioni gjeografik del në shesh me thirrjen Kur'anore për të vizituar vendet e popujve para nesh dhe të shohim përfundimin e tyre.

Kurse dimenzioni historik del në shesh me thirrjen Kur'anore për tu zhytur në thellësitrat e historisë që të shohim tregimet e shumta për popuj të ndryshëm dhe zhvillimin dhe përfundimin e tyre.

Zhvillimi i mundësive logjike kërkon që të kemi parasysh disa çështje:

a) Mundësitë logjike linden me vet njeriun.

b) Mundësitë logjike nuk kanë fund, por janë të llojllojshme.

c) Tërësia e veprimtarisë logjike dhe mendore që e ban njeriu gjatë ballafaqimit me ndonjë situatë të caktuar është sikur procesi i tretjes së ushqimit, pijes ose gjumit.

d) Dështimi në edukimin e mundësive logjike dhe metodologjinë e logjikimit të shëndoshë shkakton rezultate të rezikshme për jetën e individit dhe shoqërisë. Mëdyshja dhe injoranca e shpjen njeriun që të merr njërin prej dy qëndrimeve:

- reagon pamatur;

- ose i nënshtrohet situatës, e kjo e shpjen në shkatërrim.

e) Metodologjia që i zbulon mundësitë logjike dhe kujdeset për zhvillimin e tyre duhet të jetë metodologji shkencore, laborator i saj është mejdani i horizontit, vet njeriu, llojet e ndryshme të jetës shoqërore dhe vet ndikimi i mundësive logjike në realitet dhe gjithësi.

f) Përsosja e metodologjisë së logjikimit,

formave dhe stërvitja në ato shkathtësi dhe zhvillimi i mundësive logjike janë dy kushtet kryesore për kuptim dhe sjellje.

Sigurimi i ambientit të nevojshëm për zhvillimin e mundësive logjike

Ambijenti i cili duhet të sigurohet për zhvillimin e mundësive logjike duhet ti posedojë dy veçori:

- Lirinë
- Zhvillimi dhe stërvitja në mendim të lirë.

Vetëm tevhidi (monoteizmi islam) e siguron lirinë e njeriut, sepse liri na qenka zgjedhja e shndërritur, e njohësit, të vetëdijësuarit, domethënë vepër që i ka të qarta pikënisjen dhe synimin, buron nga personi dhe nga forcat e tij intelektuale dhe shpirtërore të pjekura dhe të plota, ku asgjësohet ndikimi i nevojës, shprehisë, përsëritja e thënieve, ndikimeve dhe inspirimeve të të tjerëve, nëpërmjet dispozitave esenciale për të mirën dhe të keqen.

Sipas këtij definicioni me besim, sipas parimeve të besimit islam, njeriu mund ta arrijë lirinë, sepse me te lirohet njeriu nga statuzimi me të gjitha format e veta. Andaj masa e gjërë, injorantët, imitatorët e medhhebeve dhe fanatikët nuk mund të jenë të lirë, sepse ata nuk janë të aftë të kultivojnë lirinë.

Kjo liri dallon nga liria e perendimit, sepse ajo ka domethënine e përgjigjes së nevojave, ideve dhe epsheve të tija stihike, duke mos poseduar pastrim shpirtëror ose edukim logjik.

Liria sipas domethënies perendimore është tre lloje:

- liria e të menduarit;
- liria e zgjedhjes;
- liria e punës.

Kurse sipas domethënies islame ka edhe një element, e ajo është:

- liria e prezentimit të shembullit suprem.

Tre elementet nuk kanë aspak vlerë në mungesë të elementit të katërt, sepse ato

janë korniza, kurse elementi i katërt është përmbajtja.

Me elementin e katërt e di njeriu për çka mendon, për çka zgjedh dhe për çka punon. Përgjigjeja e kësaj: për çka, është në shembullin suprem, ose shembullin ideal për jetë, atë që e quan Kur'ani sherijat dhe minhaxh.

Kjo është pikënisja dhe fillimi i mendimit, zgjedhjes dhe punës.

Për të qenë liria e plotë, pedagogjia islame, synon pastrimin e ambientit nga të gjitha shtypjet dhe përkufizimet që e pengojnë këtë liri. E pastron nga statuzimi dhe bestytynja që e pengojnë lirinë e të logjikuarit, nga padrejtësia dhe tirania që e pengojnë nga liria e zgjedhjes, nga frika dhe ngurtësia që e pengojnë nga liria e veprimit dhe nga padrejtësia e cila pengon prezentimin e shembullit suprem.

Edukimi i individit në dashurimin në shembullin suprem

Shembulli suprem është shembulli i jetës shpirtërore dhe material të cilën duhet ta jetojë njeriu musliman.

Shembulli suprem është skica ose maketa të cilën e bënë inzhinieri dhe ua jep të tjerëve që ta bëjnë realitet.

All-llahu është Ai që ka caktuar shembullin suprem dhe Atij i takon ky shembull:

"Dhe Ai është që e shpik jetën dhe pastaj e përsërit atë, e ajo (përsëritja) është edhe më e lehtë për Te (sipas mendimit tuaj). Shëmbëlltyra më e lartë është vetëm e Tij në qiej e në tokë dhe Ai është mbizotëruesi, i urti". (Er-Rum: 27).

"Shembulli i keq u takon atyre që nuk besojnë botën tjetër, ndërsa All-llahut i takon shembulli më i lartë. Ai është fuqiptoti, i urti". (En-Nahl: 60).

Pse ndodh dallimi mes dy shembujve:

"Kjo është kështu, ngase ata që nuk besu-

an ndoqën të pavërtetën, e ata që besuan ndoqën të vërtetën që u erdhi prej Zotit të tyre. Kështu All-llahu ua sjell njerëzve shembujt e tyre". (Muhammed: 3).

Llojet e shembujve suprem

a) Shembulli suprem i vërtetë dhe zbatimi i vërtetë.

Koha e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

b) Shembulli suprem i vërtetë dhe injorancë në zbatim.

Bota islame pas hilafetit të drejtë, në kohën e hilafetit dinastial dhe në kohën e hilafetit tiran, e deri më sot.

c) Shembull suprem i kotë dhe zbatim i mirë.

Disa fraksione batinije, të kota që kanë arritur sukses në themelimin e shteteve të tyre.

d) Shembull suprem i kotë dhe zbatim i kotë.

Siç janë disa shkolla medhhebore të ngushta, disa rende të dervishëve, fanatizmi rajonal ose fisnor, etj.

Problemi i edukimit të individit sipas synimeve të pedagogjisë moderne

a) Përkufizimi i domethënies së "veprës së mirë" në rezultate materiale.

Sipas pedagogjisë islame "vepra e mirë" personifikohet me "individin e mirë- përmirësues", kurse sipas botëkuptimit modern, me veprën të mirë synohet në rezultatet materiale dhe formimin e "individit prodhues- konsumator".

Institucionet edukative moderne, siç është shkolla, instituti dhe universiteti, mundin e tyre e koncentrojnë në formimin e individit "prodhues", kurse institucionet paralele, siç është media, ajo e shtypur dhe elektronike, e përgadisnin si "konsumator".

Pedagogjia islame synon të spikatë "kulturën e vlerave", kurse pedagogjia moderne kontribuon në spikatjen e "kulturës së punës dhe konsumatorit".

Kjo kulturë në shoqëritë moderne i shfaq dy fenomene, një pozitiv dhe një negativ.

Fenomeni pozitiv personifikohet në përcaktimin e pozitës së çdo individit në sajë të produkteve të tija, e kjo shkaktoi përparimin e industrisë dhe prodhimit.

Fenomeni negativ personifikohet në faktin se pozita e individit përcaktohet në sajë të konsumimit në mejdanin e jetës materiale.

Kjo shkaktoi garimin mes njerëzve dhe shoqërive, përhapjen e kriterëve materialiste, në vend të kriterëve morale dhe shkencore, u ndërpre kujdesi për njëri tjetrin, u shkatërrua shoqëria, kurse raportet e ndërsjellta i përcakton interesi material.

Ky ndikimi negativ e shkatërroi tërësisht aspektin human dhe moral në personalitetin bashkëkohor, sepse këto sisteme bënë ndarjen mes shkencave ekzakte dhe atyre humane dhe fetare, pastaj këto shkencë të dyta dhe të treta i përkufizuan në specializime të izoluar nga realiteti i jetës.

Kjo shkaktoi dështimin në barazpeshën e shoqërive dhe daljen në shesh të dy shtresave:
- shtresa më e vogël, e cila e vjel frytin e këtyre njohurive, praktikimeve teknologjike dhe përcakton fatin.

- Shtresa më e gjërë, e cila i prodhon këto praktikime teknologjike dhe vjel më pak se sa është çmimi i lëndëve që stimulohen për konsumim.

Në këtë mënyrë rikthehet "statuizmi" në ndërgjegjën e individit bashkëkohor, saqë është ngulitur në shpirtin e tyre se vëllau i tij njeri, ka mundësi ta furnizon ose ta privon, tia jep jetën ose tia mer, e në këtë mënyrë është rikthyer skllavëria moderne. b) Rënia e nivelit të shembullit suprem në nivel të përgjigjes së nevojave fizike të njeriut.

Shembulli suprem në këtë fazë ka rënë në nivelin më të ulët: përgjigjeja e nevojave fizike dhe përgaditja e tyre për të arritur në

gjërat që janë në interes për te.

Normalisht se ka divergjenca të mëdha sa i përket asaj se çka është interes.

Sipas të gjitha studimeve të pedagogëve perendimore që flasin mbi lidhjen mes përgjigjes së nevojave fizike dhe vlerave morale, del në shesh se institucionet e pedagogjisë moderne fomulojnë njeri i cili nuk cilësohet me asnjë rregull moral ose kritere shoqërore. Ai sipas gjendjes më të mirë është njeri i padefinuar moralisht, as nuk është në kra-hun e moralit, e as kundër moralit, por vep-ron sipas asaj që ia dikton epshi dhe interesi, andaj duke u nisur nga kjo pikënisje, ai mundet me qenë me moralin në një rast të cak-tuar e të jetë kundër moralit në raste tjera.

c) Përkufizimi i vullnetit në gradën e dë-shirave dhe epsheve.

Pedagogjia moderne përkufizohet në kul-tivimin e:

- vullnetit të njeriut për ushqim, me të cilën garantohet vazhdimësia e trupit të njeriut.
- vullnetit të njeriut për martesë, e kjo është garancë për vazhdimësinë e llojit nje-rëzor.

Normalisht se nga këto dy vullnete lindin edhe shumë vullnete sekondare.

Pasiqë në pedagogjinë moderne nuk gjin-det niveli më i lartë:

- kultivimi i vullnetit të njeriut për besim dhe vlera, atëherë nuk kultivohen as edhe vullnetet sekondare.

d) Përkufizimi i përvojave në kosmologjike dhe shoqërore, duke i anashkaluar ato fetare dhe morale.

Është e vërtetë se pedagogjia bashkëko-

hore ka shkëlqyer në mejdanin e përvojave kozmologjike dhe zhvillimi gjigant në sferën e shkencave fizike dhe praksave teknologjike. Ata gjithashtu janë duke përparuar edhe në sferën e shkencave shoqërore, e kjo reflektohet në shkencat administrative, politike, psikologji, e shumë shkencë shoqërore.

Mirëpo përkufizimi në mejdanin kosmolo-gjik dhe shoqëror i ka prishur frytet dhe i ka shndërruar në vegla të vuajtjes te shumë njerëz. Ky përkufizim ka shkaktuar ndërper-jen e raporteve mes synimeve dhe mjeteve, të cilat synime i ofron përvoja fetare dhe morale.

e) Përkufizimi i mundësive logjike dhe fizike duke i anashkaluar ato morale.

Pedagogjia moderne ka përparuar mjaft në mejdanin e studimit të mundësive logjike, klasifikimin e tyre, studimet që kanë të bëjnë me trurin, sistemin nervor, hapësirat ku mund të shfrytëzohen këto mundësi.

Mirëpo kriza e madhe është vrasëse në mejdanin e mundësive morale. Janë mundësi morale, sepse fara e tyre gjindet në njeriun, por kanë nevojë për kultivim dhe zhvillim.

Do të sqarohen në ndonjë shkrim tjetër:

- Zhvillimi i përvojave fetare, shoqërore dhe kosmologjike te individi
- Edukimi i vullnetit te indivdi
- Përsosja e zhvillimit të mundësisë për shfrytëzim dhe nënshtrim
- Barazpesha mes vullnetit të vendosur dhe mundësive shfrytëzuese te individi).

(Transkript i plotë i materialit të prezantuar në tribunën shkencore të mbajtur më 3, korrik, 2004 në Vushtri-Pallati i kulturës).

Bekir Halimi,
23.7.2004

Kur'ani fisnik, sfidë dhe mrekuilli

Në shumë ajete kur'anore lexuesi përballët me një sfidë, me të cilën i kërkohet atij që të krijojë një sure të ngjashme. Me sa duket, misionarët e krishterë, të cilët e quajnë absurde këtë sfidë, si dhe një kriter krejtësisht subjektiv, nuk janë aspak në dijeni të krahasimit të poezisë dhe prozës arabe me Kur'anin. Ky artikull ka për qëllim të trajtojë një aspekt të sfidës kur'anore për të krijuar një sure të ngjashme. Çfarë nënkuptohet me "një sure të ngjashme" në lidhje me poezinë dhe prozën arabe?

Ajetet kur'anore që kanë të bëjnë me këtë sfidë janë paraqitur më poshtë (Përkthim i Hilâlî dhe Muhsin Khan):

Thuj: "Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund ta bënin si ky sado që ta ndihmonin njëri-tjetrin." [Kur'an 17:88]

Edhe nëqoftëse ju (arabët paganë, të krishterët dhe hebretë) jeni në dyshim në lidhje me atë që Ne ia shpallëm gradualisht robët tonë, atëherë sillni ju një kapitull të ngjashëm me atë (Kur'anin) dhe thirrni në ndihmë dëshmitarët tuaj (zotërat) pos Allahut, nëse jeni të sigurtë në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit. [Kur'an 2:23]

Nuk është e logjikshme të mendohet se ky Kur'an është i trilluar prej dikujt pos Allahut, por është vërtetues i asaj (shpalljes) që ishte më parë (d.m.th. Tevruti dhe Ungjilit) dhe sqarues e komentues i librit. Nuk ka fare dyshim se është i zbritur prej Zotit të botëve.

E përsëri, ata (idhujtarët) thotë se atë e trilloi ai (Muhammedi). Ti thuj: "Sillni pra ju një kapitull të ngjashëm me këtë, madje thirrni në ndihmë kë të doni, përveç Allahut

nëse jeni të drejtë në atë që thonit!" [Kur'an 10:37-38]

Apo pse ata thonë: "Ai (Muhammedi) e trilloi Kur'anin" Thuj: "Krijoni pra dhjetë kapituj si Kur'ani, ashtu të trilluara siç thoni dhe thirrni në ndihmë kë të mundeni, përveç Allahut, nëse jeni të drejtë! [Kur'an 11:13]

A mos ata thonë: "Ai (Muhammedi) e trilloi?" Jo, por ata nuk besojnë! Pra, nëse ata janë të drejtë le të sjellin një krijim si ai. [Kur'an 52:33-34]

cAbdur Rahîm Green vë në dukje që:

Këta janë të gjashtëmbëdhjetë el-Bihâr (që në përkthimin e fjalëpërfjalshëm do të thotë "Detërat", të quajtur kështu për nga mënyra se si shtjellohet poema (sipas parametrave ritmikë):at-Ta'îl, al-Bassit, al-Wâfir, al-Kamîl, ar-Rajs, al-Khafîf, al-Hazaj, al-Mutakarib, al-Munsarih, al-Muktatab, al-Muktadarak, al-Madîd, al-Mujtath, al-Ramel, al-Khabab dhe as-Saria'. Pra, sfida në fjalë ka të bëjë me krijimin në gjuhën arabe të tre vargjeve që nuk bëjnë pjesë në këto gjashtëmbëdhjetë Bihâr, pra një prozë pa rimë, që të mos ngjasojë me të folurën e fallxhorëve, që të ketë kuptim dhe të jetë në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme. Dhe, për këtë, mendoj që të paktën "Shpirti i shenjtë" i të krishterëve që na bën që të flasim në gjuhë të ndryshme dhe që është pjesë e "Trinisë" së Zotit, duhet të jetë në gjendje të na frymëzojë për ta arritur një gjë të tillë!

Së pari, gjuha dhe ligjëratat arabe ndahen në dy degë. Njëra prej tyre është poezia me rimë. Kjo është një ligjëratë me rimë dhe metrikë, që do të thotë se çdo varg i saj përfundon me një shkronjë të caktuar, që quhet "rimë". Nga ana tjetër, kjo poezi e rimuar ndahet në sisteme metrike që quhen

al-Bihâr, që do të thotë 'Detërat'. Quhen kështu për nga mënyra e rrjedhës së vargjeve sipas parametrave të rimës. Gjithsej janë gjashtëmbëdhjetë al-Bihâr; at-Tawîl, al-Bassit, al-Wâfir, al-Kamîl, ar-Rajs, al-Khaff, al-Hazaj, al-Muttakarib, al-Munsarih, al-Muktab, al-Muktadarak, al-Madîd, al-Mujtath, al-Ramel, al-Khabab dhe as-Saria'. Secili nga këta ka një rimë të caktuar, të ndryshme nga tjetri. Për hollësi të mëtejshme mbi metrikën e poezisë arabe shih librin e Lyall Translations Of Ancient Arabian Poetry, Chiefly Pre-Islamic.[1] Në këtë libër, Lyall bën një përshkrim të shkurtër të sistemeve metrike al-Kamîl, al-Wafir, al-Hajaz, at-Tawil, al-Bassit, al-Khaff and al-Madîd.[2]

Dega tjetër e ligjërates arabe është proza, domethënë ligjërata jo-metrike. Proza mund të jetë edhe prozë me rimë. Proza me rimë përbëhet nga rreshta në paragrafë që përfundojnë me të njëjtën rimë, ose nga fjali që rimojnë dy e nga dy dhe quhet "prozë me rimë" ose sajc. Proza mund të jetë edhe prozë e thjeshtë (mursal). Në prozën e thjeshtë, ligjërata vazhdon e pandërprerë dhe nuk ka rimë. Proza përdoret në ligjërata fetare dhe lutje, si dhe në ligjërata që kanë për qëllim të ngjallin besim apo që të frikësojnë masat.[3] Një nga ligjëratat më të mirënjohura që përmban prozë të tipit sajc është ajo e Hajjâj bin Yûsuf në misionin e tij të parë në Irak, në periudhën pas Islamit, si dhe ajo e Quss bin Sa'idah në periudhën para-islamike.

Pra, sfida, siç thotë Abdur Rahîm Green, ka të bëjë me një ftesë për të krijuar në arabisht tre vargje që të mos bëjnë pjesë në këto gjashtëmbëdhjetë al-Bihâr, që të mos jenë prozë me rimë dhe të mos ngjasojnë as me të folurën e fallxhorëve e as me të folurën e zakonshme, si dhe të jenë në një gjuhë të qartë dhe të kenë kuptim.

Dhe vërtet

Kur'ani nuk është vargje, por ritëm. Ritmi i disa vargjeve ngjason me rregullsinë e sajc, dhe të dyja kanë rimë, ndërkohë që disa vargje kanë ngjashmëri me Rajaz për nga gjallëria dhe shpejtësia. Por, kritikët kureshë kanë pranuar se këto vargje nuk i përkasin asnjërës nga kategoritë e lartpërmendura. [4]

Është interesant fakti se të gjitha poezitë pre dhe post-islamike, që ka grumbulluar Louis Cheikho bëjnë pjesë në gjashtëmbëdhjetë sistemet metrike al-Bihâr.[5] Vërtet, paganët e Mekës e kanë akuzuar vazhdimisht Profetin Muhammed, paqja qoftë mbi të, si mashtrues, magjistat, etj. Megjithëse në periudhën e shpalljes kur'anore, poezia dhe proza arabe ishin në kulmin e tyre, asnjë poet arab nuk ka qenë në gjendje të krijojë qoftë edhe një varg të ngjashëm me një sure të Kur'anit. Forma poetike e Kur'anit nuk ngjasonte me asnjë nga kategoritë e lartpërmendura. Dhe ishte pikërisht ky fakt që e bëri Kur'anin të paimitueshëm, duke u hequr paganëve çdo armë për ta luftuar atë, siç e vërteton edhe Alqama bin Abd al-Manaf, i cili u drejtohet udhëheqësve të tyre, kurjesheve:

O kureshshë, një fatkeqësi e re ka rënë mbi ju. Muhammedi ishte një djalosh shumë i dashur mes jush, shumë i besueshëm në fjalë dhe i virtytshëm, dhe, kur patë thinjat në tëmthat e tij, e kur ai ju solli mesazhin e tij, ju u hodhët dhe e quajtët magjistat, por ai nuk është i tillë, sepse ne i kemi parë njerëzit e tillë duke pështyrë dhe duke fryrë nyja; pastaj e quajtët poet, por ne i njohim njerëzit e tillë dhe i kemi dëgjuar të gjitha llojet e vargjeve që ata thurin; pastaj e quajtët fallxhor, por ne i njohim njerëzit e tillë dhe gjërat që ata thonë; pastaj thatë që është i mbizotëruar nga djalli, por nuk është, sepse

ne kemi parë njerëz të tillë dhe ai nuk shfaq asnjë shenjë të pasthirmave, pëshpëritjeve dhe delirit të tyre. O kurejshë, shihni punën tuaj, sepse, për Allah, me ju ka ndodhur diçka e rëndë.

Është i mirënjohur fakti se Shpallja kur'anore ka zbritur në shtatë ahraf (ose shtatë forma) për t'ua lehtësuar të kuptuarit e tij arabëve, të cilët flisnin në shtatë dialekte të ndryshëm. Një arsye tjetër është edhe për t'i sfiduar ata në terrenin e vet që të krijonin një sure të ngjashme me ato që gjenden në Kur'an. Vështirësia e kësaj sfide u bë edhe më e dukshme kur asnjë nga shtatë fiset më të mëdha nuk qe në gjendje ta imitonte atë madje as në dialektin e vet, meqenëse asnjëri nuk mund të justifikohet me faktin se ishte e vështirë të imitohet stili kur'anor për shkak se nuk ishte në dialektin e tij.. [6]

Çfarë thonë orientalistët mbi paimitueshmërinë e Kur'anit?

Që në vitin 1880, E. H. Palmer, pranoi stilin unik të Kur'anit. Megjithëse ai shprehet i lëkundur në mëdyshjet e tij. Në Hyrjen e përkthimit që i ka bërë Kur'anit, ai shkruan:

Nuk është çudi që as shkrimtarët dhe poetët më të mirë arabë nuk kanë arritur të krijojnë diçka të ngjashme me Kur'anin për nga vlera artistike. Së pari, ata kanë qenë paraprakisht të një mendimi se imitimi i tij është i pamundur dhe e kanë quajtur stilin e tij si standardin e përkryer, domethënë, çdo mënjanim nga një stil i tillë konsiderohet mangësi. Por, për ta, ky stil nuk është i natyrshëm siç ishte për Muhammedin dhe bashkëkohësit e tij dhe në gojën e tyre tingëllon aq i panatyrshëm sikur anglezët të vazhdonin të ndiqnin Chaucer si model, pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar gjuha e tyre. Për Profetin ky stil ishte i natyrshëm dhe fjalët ishin ato të përdorimit të përditshëm, ndërkohë që në veprat e auto-

rëve të mëvonshëm arabë ky stil tingëllon i kopjuar dhe fjalët arkaike në këto vepra përdoren për zbulim dhe, për pasojë, përpjekjet e tyre ngjajnë të përpunuara dhe artificiale në një elokuencë të sforcuar dhe të sajuar [7]

Arabologu i famshëm pranë Universtitetit të Oksfordit, Hamilton Gibb shprehet hapur mbi stilin e Kur'anit. Ai thotë:

...megjithatë, mekasit kërkonin prej tij një mrekulli dhe me një guxim të admirueshëm dhe me vetëbesim, Muhammedi iu drejtua vetë Kur'anit si dëshmi supreme e misionit të tij. Si të gjithë arabët, edhe mekasit ishin njohës së gjuhës dhe oratorisë. Prandaj, nëse Kur'ani do të ishte shkruar nga Muhammedi, atëherë edhe të tjerët do të kishin patur mundësi të krijonin diçka të ngjashme. Le të provojnë të krijojnë dhjetë vargje të tillë. E nëse nuk mund ta bëjnë këtë (dhe është e qartë që nuk mundën, atëherë le ta pranojnë Kur'anin si një mrekulli e jashtëzakonshme. [8]

Dhe, duke folur për Profetin, paqja qoftë mbi të dhe Kur'anin, ai pohon:

Megjithatë, për të qenë të sigurtë, çështja e vlerave letrare nuk duhet gjykuar a priori, por në lidhje me mrekullinë e gjuhës arabe; dhe, në njëmijë e pesëqind vjet, asnjëri nuk e ka përdorur këtë gjuhë me aq fuqi, me aq guxim dhe me aq efekte emocionale siç ka bërë Muhammedi. [9]

Prandaj, si monument letrar, Kur'ani mbetet një vepër unike në letërsinë arabe, që nuk ka rival përsa i përket stilit të tij. Muslimanët e të gjitha kohërave janë të një mendimi përsa i përket paimitueshmërisë, jo vetëm të përmbajtjes, por edhe të stilit të tij...dhe, duke përdorur gjuhën e lartë arabe për të shprehur nivele të reja mendimi, Kur'ani zhvillon një prozë të guximshme dhe shumë mbresëlënëse, në të cilën janë shfry-

tëzuar lirisht dhe me një natyrshmëri të mahnitshme të gjitha ngjyrimet e sintaksës [10]

Në lidhje me ndikimin e Kur'anit në letërsinë arabe, Gibb thotë:

Ndikimi i Kur'anit në zhvillimin e letërsisë arabe ka qenë i pallogaritshëm në shumë drejtime. I detë, gjuha dhe rima e tij përkujton në shkallë të ndryshme të gjithë veprat e mëvonshme letrare. Tiparet e tij të veçanta gjuhësore nuk u imituan as në prozën zyrtare të shekullit pasues dhe as në shkrimet e mëvonshme prozaike. Por, pjesërisht falë elasticitetit që Kur'ani i ka transmetuar gjuhës arabe, proza zyrtare dhe shkrimet e mëvonshme u zhvilluan me shpejtësi, duke iu përshtatur nevojave të reja të qeverisë perandorake dhe një shoqërie në zhvillim. [11]

Siç thuhet edhe në Kur'an:

Edhe nëqoftëse ju (arabët paganë, të krishterët dhe hebretë) jeni në dyshim në lidhje me atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillni ju një kapitull të ngjashëm me atë (Kur'anin) dhe thirrni në ndihmë dëshmitarët tuaj (zotërat) pos Allahut, nëse jeni të sigurtë në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit. Por nëse nuk mundeni – e as që do ta bëni kurrë – atëherë ruajuni nga zjarri, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për jobesimtarët. (Kur'an 2:23-24)

Së fundi, stili i mrekullueshëm i Kur'anit është admiruar edhe nga arabët e krishterë:

Kur'ani është një nga veprat klasike botërore që nuk mund të përkthehet pa i humbur një pjesë të madhe të vlerave. Ai ka një rimë me bukuri të rrallë dhe një ritëm që magjeps atë që e dëgjon. Shumë të krishterë arabë flasin për stilin e tij me një admirim ngazëllyes dhe pjesa më e madhe e arabologëve e pranojnë përsosmërinë e tij. Kur

Kur'ani lexohet apo këndohet me zë të lartë, ai ka një efekt thujse hipnotizues që e bën dëgjuesin indiferent ndaj sintaksës nganjëherë të çuditshme dhe përmbajtjes (për ne) rrëqethëse. Dhe është pikërisht kjo veti e Kur'anit për t'i mbyllur gojën kritikave me muzikën e ëmbël të gjuhës së tij që ka krijuar bindjen për paimitueshmërinë e tij. Dhe vërtet, mund të pohohet pa frikë se në letërsinë e gjerë dhe pjellore të arabëve, si në prozë, ashtu edhe në poezi, nuk gjendet asgjë që mund të krahasohet me Kur'anin. [12]

Fjalët nuk kanë nevojë për koment. Si përfundim: Në letërsinë arabe, qoftë poezi apo prozë, nuk ekziston asnjë vepër që mund të krahasohet me Kur'anin. Dhe muslimanët kanë qenë gjithmonë të një mendimi në lidhje me paimitueshmërinë e tij.

Një tjetër akuzë e misionarëve të krishterë është çështja e "gabimeve" gramatikore në Kur'an. Si kundërpërgjigje, do të përmendim faktin që bashkëkohësit e Muhamedit, paqja e Zotit qoftë mbi të, kanë qenë shumë të ditur dhe njohës të thellë të veçantive të gramatikës arabe, prandaj, po të kishin gjetur ata ndonjë gabim gramatikor në Kur'an, do ta kishin bërë të ditur këtë fakt kur Muhammedi i ftoi që ta bënin një gjë të tillë. Prandaj, meqenëse ata nuk e morën përsipër sfidën në lidhje me këtë çështje, mund të jemi të sigurtë që në Kur'an nuk ekzistojnë këto "gabime" gramatikore.

Gabimet gramatikore për të cilat flasin misionarët e krishterë janë diskutuar dhe hedhur poshtë tashmë.[13] Me sa duket, mungesa e informimit të misionarëve të krishterë mbi strukturat e ndërlikuara të arabishtes klasike është dhe shpjegimi i vetëm i akuzave në lidhje me të ashtuquajturat "gabime" gramatikore.

I'jaz al-Kur'ân (ose paimitueshmëria e Kur'anit) dhe vërtetimi i saj

I'jaz do të thotë "çfuqizim, paaftësim" dhe është një koncept që ka të bëjë me natyrën e mrekullueshme të Kur'anit. Kjo mrekulli ka qenë për shekuj me radhë objekt studimi i dijetarëve muslimanë. Në fillim të shekullit të nëntë të erës sonë, fjala i'jaz mori kuptimin e një cilësie të veçantë që ka Kur'ani dhe pikërisht pamundësinë e imitimit të këtij libri, apo të cilësdo pjesë të tij, në formë dhe përmbajtje. Në pjesën e dytë të po këtij shekulli, kjo fjalë u kthye në një term teknik dhe, përkufizimet e shumta që ajo mori pas shekullit të dhjetë nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha nga koncepti bazë i paimitueshmërisë së Kur'anit dhe pamundësisë së qenieve njerëzore për ta imituar atë edhe pas shumë përpjekjesh (tahiddi).[14]

Pra, doktrina islame e i'jaz al-Kur'ân ka të bëjë me besimin se Kur'ani është një mrekulli (mu'jizah) që i është zbritur Muhammedit, paqja e Zotit qoftë mbi të. Të dyja fjalët, i'jaz dhe mu'jizah rrjedhin nga e njëjta rrënjë, a'jaza.[15]

Diskutimet e hershme teologjike mbi i'jaz-in kanë çuar në lindjen e hipotezës së sarfah ("largimi") dhe, sipas këtyre diskutimeve, mrekullia qëndron në atë që Zoti i largon të aftët nga përpjekjet për të imituar Kur'anin. Kuptimi i sarfah është që, po të mos ishte kjo mrekulli, Kur'ani mund të imitohej. Megjithatë, cAbd al-Jabbâr (vd. 1025 e.s.), teologu mu'tazilit, e ka hedhur poshtë hipotezën e sarfah për shkak të dobësisë së saj.

cAbd al-Jabbâr nuk e pranon doktrinën e sarfah për dy arsye madhore. Së pari, sepse ajo bie në kundërshtim me ajetin kur'anor, sipas të cilit as xhindët e as njerëzit nuk mund të krijojnë diçka që të krahasohet me Kur'anin dhe, së dyti, për arsye se kjo hipotezë quan mrekulli diçka jashtë Kur'anit, d.m.th. sarfah, ndalimin nga imitimi dhe jo vetë

Kur'anin. Përveç kësaj, sipas 'Abd al-Jabbar, doktrina e sarfah paraqet katër të meta:

1. Lë në harresë faktin e mirënjohur që arabët në kohën e Muhammedit e kanë pranuar madhësitinë dhe të veçantën e gjuhës së Kur'anit;

2. Bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kuptimin e ajeteve që flasin për Sfidën;

3. Ajo nënkupton që Kur'ani nuk është një mrekulli; dhe

4. Pohon që arabët nuk ishin në rregull nga mendtë. (khuruj 'an al-'aql).

Në fakt, kjo doktrinë nënkupton që disa njerëz e kanë patur mundësinë që të krijojnë diçka të ngjashme me Kur'anin, por, thjesht, kanë vendosur të mos e bëjnë. Kjo, në të vërtetë, vë në diskutim ose qëllimet ose shëndetin e tyre mendor. Prandaj, sipas cAbd al-Jabbâr, interpretimi i saktë i sarfah është se qëllimet për të krijuar diçka të ngjashme me Kur'anin u shuan (insarafah) për arsye të pranimit të pamundësisë për ta bërë këtë. [16]

cAbd al-Jabbâr ngul këmbë në cilësinë e paimitueshme të elokuencës së jashtëzakonshme të Kur'anit dhe përsosmërinë e papërsëritshme të stilit të tij. Në veprën e tij al-Mughni (Libri i Vetëmjaftueshëm), ai argumenton se elokuenca (fasâhah) e Kur'anit vjen nga cilësia e jashtëzakonshme, si e kuptimit, ashtu edhe e stilit dhe ai shpjegon që kjo cilësi ka disa shkallë, në varësi të mënyrës në të cilën janë zgjedhur dhe sistemuar fjalët në çfarëdo teksti letrar dhe, përta i përket kësaj cilësie Kur'ani qëndron më lart nga të gjithë.[17]

Al-Baqillanî (vd. 1013 e.s.), në studimin e tij sistematik dhe të kuptueshëm me titull I'jaz al-Qur'ân vlerëson stilin e mahnitshëm dhe të jashtëzakonshëm të Kur'anit, por nuk mendon që ky është një argument domosdoshmërisht në favor të pakrahasueshmëri-

së së Kur'anit, duke u përqendruar kryesisht tek përmbajtja e shpalljes.

Zgjedhja dhe sistemimi i fjalëve që përkruhet me fjalën nazm ka qenë në qendër të diskutimeve të al-Jahîz, al-Sijistanî (vd. 928 e.s.), al-Bakhî (vd. 933 e.s.) dhe Ibn al-Lkshid (vd. 937 e.s.). Al-Rummanî dhe bashkëkohësi i tij al-Khattabî (vd. 998 e.s.) kanë trajtuar efektin psikologjik të nazm të Kur'anit në veprat e tyre, përkatësisht al-Nukat fi l'jaz al-Qur'ân dhe Bayan l'jaz al-Qur'ân..

Autori që ka bërë studimin më të mirë dhe më të qartë të teorisë së nazm në analizën që ai i ka bërë i'jaz-it, është cAbd al-Qahir al-Jurjanî (vd. 1078 e.s.) në veprën e tij Dalâ'il al-l'jaz. Materiali i tij është përpunuar më tej nga Fakhr ad-Din al-Razî (vd. 1209) në veprën e tij Nihâyat al-l'jaz fi Dirâyat al-l'jaz dhe është përdorur për qëllime praktike nga al-Zamakhsharî (vd. 1144 e.s) në komentimin e tij të Kur'anit me titull al-Kashasâf, që është një analizë e pasur retorike e stilit të Kur'anit.[18]

Autorët e mëvonshëm nuk kanë shtuar asgjë të re.

A është Bibla e paimitueshme?

Kushdo që ka lexuar historinë e Biblës si tekst dhe standardet vazhdimisht të ndryshueshme për fatin e keq të udhëheqësve të Kishës, si dhe rreth 300 mijë versione të Dhjatesë së Re tregojnë në vetvete se asnjë libër në histori nuk ka patur një reputacion të tillë. Procesi i redaktimit serioz të cilit i është nënshtuar Bibla e krishterë është unik në historinë e saj 2000 vjeçare. Kjo, në vetvete e bën Biblën një libër të paimitueshëm.

Përsa i përket gjuhës dhe përsosmërisë stilistike, Bibla nuk ka pretendime të tilla. Prandaj, në të nuk përmendet ndonjë sfidë që i drejtohet njerëzimit për të krijuar disa vargje apo kapituj të ngjashëm me të. Për më tepër, edhe vetë të krishterët pretendoj-

në se Bibla përmban gabime ortografike dhe gjuhësore. Gjuha në të cilën është shkruar Dhjata e Re greke është greqishtja demotike, gjuhë që i kushton pak ose aspak rëndësi zbatimit të rregullave gramatikore të greqishtes klasike. Duke krahasuar përsosmërinë stilistike të Kur'anit me papërsosmërinë stilistike të Biblës, von Grunebaum shkruan:

Në ndryshimin mes përsosmërisë stilistike të Kur'anit dhe papërsosmërisë stilistike të shkrimeve të vjetra, teologu musliman, pa u kuptuar, e gjen veten të një mendimi me shumicën e mendimtarëve të krishterë, opinioni i të cilëve në lidhje me tekstin biblik mund të përmbledhet më së miri me thënien e nxituar të Nietzsche, sipas të cilit Shpirti i Shenjtë nuk dinte ta shkruante mirë greqishten.[19]

Më tej, ai shqyrton qëndrimin e teologëve perëndimorë në lidhje me standardizimin e procesit dhe hartimit dhe Biblës:

Pohimi i teologëve perëndimor që librat biblikë janë redaktuar nga autorë të ndryshëm dhe se, në të shumtën e rasteve këto libra ata mund t'i lexonin vetëm të përkthyer, lehtësoi lejimin e papërsosmërive në Shkrimin e Shenjtë, duke eliminuar pretendimet për përsosmërinë e tij stilistike. Mësimet e krishtera, duke e lënë autorin e frymëzuar nën udhëzimin e Shpirtit të Shenjtë, dhe pa brerje ndërgjegje për sa i përket stilit, nuk ka dhënë asnjë motivacion për të kërkuar një lidhje të saktë mes tekstit të shpallur nga njëra anë dhe gramatikës e retorikës nga ana tjetër. Në këtë mënyrë, kjo e ka çliruar teologun dhe kritikun nga sikleti i kërkimit të një harmonie mes dy botëve stilistike që, e shumta, do t'i hapte rrugën një koncepti historik të përsosmërisë letrare dhe do të parandalonte çdo kritikë tekstuale dhe kontekstuale të Shpalljes...

Përveç kësaj, në Krishtërim, justifikimi për stilin "e papërsosur" të gjuhës biblike është

thjesht problem arsimor – problemi qëndron në erudicionin sekularist brenda Krishtërit; ndërsa në Islam, pozicioni qendror i Kur'anit, si epiqendër e studimeve gramatikore dhe letrare nuk është vënë kurrë në diskutim, të paktën teorikisht, nga bashkësia e besimta-

rëve.[20]

Dhe, sa u tha më sipër përshkruan më së miri Biblën, përsosmërinë e saj stilistikore (ose mungesën e saj!), si dhe qëndrimin e teologëve perëndimorë.

Dhe Allahu e di me mirë!

Referenca

- [1] C J Lyall, *Translations Of Ancient Arabian Poetry, Chiefly Pre-Islamic*, Williams & Norgate Ltd., London, 1930.
 [2] *Ibid.*, fq. xlv-llii.
 [3] Ibn Khaldun, *The Muqaddimah*, Franz Rosenthal (Translator), Vvllimi III, Routledge & Kegan Paul, London, 1958, fq. 368.
 [4] A F L Beeston, T M Johnstone, R B Serjeant and G R Smith (Editors), *Arabic Literature To The End Of The Ummayyad Period*, 1983, Cambridge University Press, fq. 34.
 [5] Louis Cheikho, *Shucara 'al-Nasraniyah, 1890-1891*, Beirut.
 [6] Abu Ameenah Bilal Philips, *Tafseer Soorah al-Hujuraat*, 1988, Tawheed Publications, Riyadh (Saudi Arabia), fq. 28.
 [7] E H Palmer (Tr.), *The Qur'an, 1900*, Pjesa I, Oxford at Clarendon Press, fq. lv.
 [8] H A R Gibb, *Islam - A Historical Survey*, 1980, Oxford University Press, fq. 28.
 [9] *Ibid.*, fq. 25.
 [10] H A R Gibb, *Arabic Literature - An Introduction*, 1963, Oxford at Clarendon Press, fq. 36.
 [11] *Ibid.*, fq. 37.
 [12] Alfred Guillaume, *Islam*, 1990 (Reprinted), Penguin Books, fq. 73-74.
 [13] M A S Abdel Haleem, *Grammatical Shift For The Rhetorical Purposes: Itifat & Related Features In The Qur'an*, Bulletin of School of Oriental and African Studies, Vvllimi LV, Pjesa 3, 1992. (Tani edhe online)
 [14] Mircea Eliade (Editor in Chief), *The Encyclopedia Of Religion*, Vvllimi 7, Macmillan Publishing Company, New York, fq. 87, Tek fjala l'jaz nga Issa J Boullata.
 [15] Yûsuf Rahmân, *The Miraculous Nature Of Muslim Scripture: A Study Of 'Abd al-Jabbar's l'jaz al-Qur'an*, Islamic Studies, Vvllimi 35, Numer 4, 1996, fq. 409.
 [16] *Ibid.*, fq. 415-416.
 [17] *The Encyclopedia Of Religion*, Op.Cit, fq. 88.
 [18] *Ibid.*
 [19] B Lewis, V L Menage, Ch. Pellat & J Schacht (Editors), *Encyclopedia Of Islam (New Edition)*, 1971, Vvllimi III, E J Brill (Leiden) & Luzac & Co. (London), fq. 1020 (Under l'djaz).
 [20] *Ibid.*
 (Tekstet janë të sjellura në shqip nga shoqata "Erasmus")

M S M Saifullah, Abd ar-Rahmân, Robert Squires dhe Muhammad Ghoniem,
30.7.2004

Istiadhe dhe istigathe

Istiadheja është ibadet me të cilin All-llahu, subhanehu ve teala, i ka obliguar robërit e Tij. Thotë All-llahu, subhanehu ve teala: "E nëse ty të ngacmon ndonjë ngacmim prej djallit, ti kërko mbrojtje prej All-llahut, se vërtetë Ai është Dëgjuesi i Dijshmi" (FUSSI-LET 36). Poashtu All-llahu, subhanehu ve

teala, na porosit me këtë edhe në shumë ajete tjera. Në mësimet e kaluara mësuam se çdo gjë që është ibadet nëse i drejtohet dikujt tjetër pos All-llahut, subhanehu ve teala, është shirk.

Mirëpo, injorantët nuk i ndëgjjuan fjalët e All-llahut, subhanehu ve teala, ku ndalon në

kërkimin e mbrojtjes prej tjetërkujt pos All-llahut, subhanehu ve teala, kështu që bënë shirk. Thotë All-llahu, subhanehu ve teala: "Ka pasur prej njerëzve burra që kanë kërkuar ndihmë prej xhinëve, ashtu që atyre edhe më tepër u shtoheshte frika" (XHIN 6). Në këtë ajet All-llahu, subhanehu ve teala, na lajmëron se ka pasur njerëz të cilët kur janë frikësuar kanë kërkuar ndihmë prej xhinëve (1) që t'i mbrojnë ata nga rreziqet që u kanoseshin. Xhinët atëherë bëheshin mendjemdhën timer dhe dëshironin që më tepër t'i frikojnë njerëzit, dhe e arrinin këtë. E kjo gjë ndodh edhe sot.

Këta njerëz kur shkonin në ndonjë vend thonin: "kërkojmë mbrojtje nga i madhi i këtij vendi" kanë për qëllim të madhin e xhiëve. Nuk lejohet të kërkohet ndihmë prej dikujt tjetër pos All-llahut, subhanehu ve teala, qoftë ndonjë njeri i mirë, xhin, melek apo pejgamber, ngase e pamë se kjo është prej shirkut. Ja si na ka mësuar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të kërkojmë mbrojtje. Transmetohet nga Havleh bintu Hakim se e ka dëgjuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke e thënë këtë dua (lutje): EUDHU BI KELIMATIL-LAHI TAMMATI MIN SHERRI MA HALEK-Kërkoj mbrojtje me fjalët e plota të All-llahut nga e keqja që ka krijuar. (Muslim)

T'ia ndërlihim këtij mësimi edhe një mësim tjetër të shkurtër që ka lidhje me të. Ajo është Istigatheja.

Istigathe d.m.th. kërkimi i ndihmës. Ky kërkim kur i është drejtuar All-llahut, subhanehu ve teala, është ibadet. Mirëpo, nëse i

është drejtuar ndonjë njeriut, kërkim të cilin nuk mund ta kryejë ai njeri atëherë bie në shirk. Sikurse bëjnë disa injorantë, i lusin varrezat (të varrosurit në to sh.r.), kërkojnë ndihmë prej tyre dhe gjithë atë që kanë nevojë, duke i sjellur atyre dhurata, po bile therrin kurbanë në emër të tyre. Mendojnë se me këtë vepër do të shërohet i sëmuri i tyre apo do t'u falen mëkatet (kjo vepër më së tepërmi bëhet nëpër tyrbe e teqe). Në këtë vepër s'ka tjetër vetëm se largim nga tevhibi i vërtetë.

Nëse kjo kërkesë i është drejtuar poashtu ndonjë njeriut, e ky njeri ka mundësi ta kryejë atë, kjo kërkesë është e lejuar bile e preferuar p.sh. kryerjen e ndonjë pune, bartje të diçkahit etj.

Dikush mund të thotë: "Poqese kam nevojë të madhe për diçka pse të mos kërkoj ndihmë prej Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem?"

Ne treguam se kërkimi i ndihmës prej të vdekurve është shirk, e ti duhet t'ia drejtosh lutjen vetëm All-llahut, subhanehu ve teala. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "A nuk është Ai që i përgjigjet nevojtarit kur ai i lutet, duke ia larguar të keqen, e juve ju bën mbizotëruer të tokës? A ka zot tjetër pos All-llahut ? Jo, por ju shumë pak mendoni" (EN-NEML 62).

All-llahu, subhanehu ve teala, e largon të keqen kur besimtari e lutë Atë me sinqeritet. Prej këtyre duave janë: ALLLLAHUMME EKSHIF ANNAL BELA- O All-llah na e largo këtë të keqe" apo "ALLLLAHUMME NEXHXHINA MINEL A'DA"- O All-llah, na shpëto prej armiqve.

Shënime:

(1) Xhinët janë krijesa të All-llahut, subhanehu ue teala, të krijuara prej zjarri. Njeriu nuk mund ti sheh në formën e tyre të vërtetë.

(2) Përzgjedhje nga libri "Mësime në tevhib" Omer Berisha

Omer Berisha,
6.8.2004

Kur një vlla kujton për motrën!

Po afrohet dita e vlerësimit të vlerave islame. Një shkëndi shpresëdhënëse kjo, për nënat, motrat, bijat fisnike e të devotshme muslimane! Gruaja muslimane po del në dritë nga burgu i traditës së shëmtuar, po i rikthehet asaj jeta, buzëqeshja, dinjiteti! Vëllezërit musliman po i japin krahun e rigjallërimit asaj, si 14 shekuj me parë! Ajo sot qëmoti po zëron, ajo po hapron denjësisht, me përulësi (jo më para burit e vllaut) por para ALLAHUT të madhëruar, e devotshme ashtu si i ka hije!

Vllau musliman, me respekt po e kujton, po e ndihmon, po e shoqëron, kjo është dritë e ALLAHUT, dritë e shpëtimit, dritë e shpërblimit! Kjo është nisma. Shtegu është i gjatë, por i hapur mirë dhe kthim prapa s'ka! Kjo është mëshirë nga i Gjithmëshirshmi, Mëshirëploti, ky është rizgjimi Islam, ky është shpëtim i njerëzimit!

Çdo mendim, çdo veprim çdo kujtim për hir e me emër t'ALLAHUT, është D R I TË dhe vetëm D R I TË!

ALLAHU im, ndrit zemrat tona me NURIN TËND, drejtona rrugës së shpëtimit, mbrona nga lajthitjet e mundshme, mëshira Yte qoftë mbi të dashurin Tënd, Resulullahun, shokët e tij dhe familjen e tij! Ja RAB mëshirën Tënde për robët e tu gabimtarë, ndihma Yte qoftë mbi të përvuajturit, jetimët, të shtypurit, të nepërkëmburit, nepërkëmburat!

Ja RAB! Ndhimo robt e Tu të devotshëm në lartësimin e fjalës Tënde...Allahume amin!

L.Kullashi,
23.7.2004

Edukoni ate që edukon djepin!

All-llahun e falenderojmë për dhuntit që na ka dhënë, që të absorbojmë dije të dobishme dhe të na lehtësohen rrugët për në vendet për tu këshilluar. Po...si është halli i atyre motrave që kanë nevojë për një gjë të tillë (këshillë dhe nasihat) e nuk kanë mundësi. Mendoj që edhe atyre ju takon ndihmë dhe përpjekje për ti ndihmuar sepse edhe ato janë pjesë e shoqërisë dhe luajn rol të madh për përmirësimin e saj, nëse edukohen në atë mënyrë. Andaj edhe duhet të bëhet çmos për ti përkrahur dhe ndihmuar e jo të hezitohet në këtë gjë, kjo sepse nuk është e vogël dhe e thjeshtë thënia "po arsimove një femër ke arsimuar një popull, po arsimove një mashkull ke arsimuar një individ". Duhet të kihet parasysh te çdo i ditur, te çdo njeri që bartë mbi supet çështjen e edukimit që femra është ajo që e tund djepin edukues të botës, përmes saj flet pasardhësi gjuhën e edukimit të potencuar në disa hutbe me plote nur, andaj kërkojmë nga ju... që mos të hudhëni këtë sygjermë tonin po të iniconi dhe të ngjallëni ambicjet për një përkrahje të tillë mbrenda kornizave të islamit.

All-llahun e lusim që t'ua shtojë dijen dhe t'ua shtojë devotshmërinë si dhe t'ua lehtëson çdo vështirësi...

E.Ermali,
30.7.2004

Shmangie nga bisedat e kota

Allahu, subhanehu ve teala, ka thënë: "Është e sigurtë se kanë shpëtuar besimtarët: ata të cilët janë të përvullur dhe të kujdesshëm gjatë faljes së namazit, dhe ata të cilët i shmangën të kotës (fjalë a punë)" [Muminun: 1-3] dhe "(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (rastësisht) kalojnë pranë së keqes (legv=përkthyer si "biseda të kota"), kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet". [Furkan: 72] dhe "Dhe kur e dëgjojnë ndonjë llomtitje marrëzie, i kthejnë shpinën dhe thonë: "Ne kemi vepra tona e ju tuajat, qofshit larg nesh, ne nuk na duhen injorantët!" [Kasas: 55]

"Biseda të kota" është të folurit i cili është i pavlefshëm dhe i padobishëm dhe nuk ka lidhje me asnjë qëllim të vërtetë. Nuk i sjell dobi askujt i cili e përdorë atë dhe bile mund t'i sjelli atij fatkeqësi në vend të kësaj.

Aliu, radijallahu anhu, ka transmetuar që i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "prej Islamit të bukur të njeriut është që ta lë atë që nuk i përket (që nuk i bën dobi)". [Tirmidhi, Ibën Maxhe]

DhenNuN ka thënë: "Kush e don Allahun jeton me të vërtetë dhe kush priret ndaj ndonjë gjëje tjetër vetëm se shkatërron mendjen e tij. I marri vjen dhe shkon duke mos ia vënë veshin se çfarë ai bën ndërsa njeriu i mençur heton thellësisht mendimet e tija".

Imam el-Bejhaki

Marrë nga: Shuabul-Iman (Seventy-seven branches of faith)

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

6.8.2004

Të drejtat politike të grave

Përkundër asaj se termi të drejta politike është i ri, ne do ta gjejmë këtë nëse hedhim një shikim në tekste Islame dhe nëse kthehemi mbrapa në eksperiencën e shoqërive të hershme muslimane, për të parë sesi Islami i ka zbatuar disa të drejta të grave që mund të emërohen ndryshe edhe si të drejta politike.

1. E drejta për këshillim

Ka shumë ajete në Kur'anin fisnik që vendosin për menaxhimin e punëve të muslimanëve në përgjithësi, të bazuar në këshillim të përbashkët. Është detyrë e muslimanëve për të këmbyer opinione dhe për tu konsultuar

me njëri-tjetrin për këto çështje.

Allahu i Lartësuar thotë: "...e konsultohu me ta në (të gjitha) çështjet..." (Ali Imran-158)

Allahu i Lartësuar gjithashtu thotë: "Dhe punët e tyre janë konsultime të përbashkëta".

Këto tekste të përgjithshme e që përfshijnë si burrat ashtu edhe gratë.

Ne shohim që i dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të, i këshillonte dhe këshillohej me gratë e tij në çështje të përgjithshme. Për shembull, ai u këshillua me Ummi Seleme-n në rastin kur ai i kishte urdhëruar sahabet (shokët e tij) që të rruanin kokat dhe të dilnin

nga gjendja e tyre e haxhit në Hudejbije. Ata vepruan kështu sepse urryen kthimin nga Me-ka pa bërë haxh. Ajo (Ummi Seleme, Zoti qoftë e kënaqur prej saj) e këshilloi Pejgamberin paqja qoftë mbi të, që ta rruan kokën e tij më para se të bënte kubanin, dhe ai kështu veprroi. Me pas të gjithë të tjerët e ndoqën në këtë veprim. Ai pastaj e lavdëroi gruan e tij dhe e vlerësoi atë për arsyen e saj të shëndoshë...

Kjo është çfarë ne gjejmë në veprat historike. E cila na tregon madje qartë, që edhe gratë të cilat ishin të mbylluar në shtëpitë e tyre, u konsultuan mbi çështjen e zgjedhjes së liderit Uthman.

2. Emigrimi dhe dhënia e bejës (betimit)

Gratë muslimane emigruan në Abisini (Etiopia e sotme) dhe në Medina. Ky emigrim ishte i barabartë me ate çfarë ne i referohemi në ditët tona si "kërkim azili politik".

Kjo ishte një kohë kur muslimanët ishin të shtypur në Mekë dhe ishin të ndaluar të shprehnin mendimet e tyre dhe të thirrnin në besimin e tyre. Ata emigruan duke kërkuar një vend ku ata do të kishin mundësinë të praktikonin ritet e tyre dhe të shprehnin besimin e tyre. Vendi i parë që muslimanët zgjedhën për të shkuar ishte Abisinia, sepse në atë kohë ishte e qeverisur nga një mbret i cili nuk shtypte askënd në vendin e tij.

Gratë muslimane emigruan gjatë kësaj kohe, disa herë të pashoqëruara si Umm Kulthumi vajza e Ukbe bin Abu Muit dhe Ummi Selame, Zoti qoftë i kënaqur me ato. Kjo është e përmendur dhe në Kur'anin famlartë:

"O ju që besuat, nëse gratë besimtare vijnë tek ju si emigruese, pranoni ato".

Përsa i përket betimit (bejës) kjo është

një pakt politiko-fetar midis muslimanëve dhe të Dërguarit të Allahut, paqja qoftë mbi të. Është një shprehje e besimit të tyre tek i Dërguari dhe aktivizimi i tyre politik në çështjen e tij. Ajeti i mëposhtëm flet rreth betimit të aleancës (bejës) të dhënë nga gratë:

"O pejgamber, nëse gratë besimtare vijnë tek ti për të të dhënë betimin e tyre që ato nuk do të shoqërojnë askënd në adhurim me Allahun, as të vjedhin, as të bëjnë prostitucion, as të vrasin fëmijët e tyre, as të shpifin, as të bëjnë dëshmi fallse, as të mos të bëhen të pabindura ndaj teje në mirësi, atëherë pranoje betimin e tyre dhe kërko nga Allahu për t'i falur ato. Me të vërtetë, Allahu është Shumëfalës, i Gjithëmëshirshëm"

Kjo listë përfshin një fjali me rëndësi politike: "as të mos të bëhen të pabindura ndaj teje në mirësi".

3. Urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja

Kur'ani ka vendosur rolin e grave besimtare për të urdhëruar në të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja.

Allahu i Lartësuar thotë: "Besimtarët, burra dhe gra, janë mbrojtës të njëri-tjetrit, ata urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqja".

Përsa i përket luftimeve ushtarake, Islami nuk e ka bërë ate të detyrueshme për gruan, por është e lejueshme për atë të marrë pjesë në përpjekjet e luftës. Për shembull: Të pajisurit me ujë e luftëtarëve, mjekimin e të plagosurve etj. Megjithate në disa luftëra, gratë kanë marrë pjesë edhe në luftime. Umm Sulejm el-Ensarije e mbrojti Pejgamberin, paqja qoftë mbi të, gjatë luftës së Uhudit, ku ishte plagosur rreth dhjetë herë.

Marrë nga: The Women in Islam
IslamToday.Net
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
13.8.2004

Imam Kurtubi

Imam Kurtubi është një nga dijetarët më të rëndësishëm jo vetëm nga regjioni i Andaluzisë, por edhe të tërë botës islame. Është dalluar në shumë diciplina shkencore e posaqërisht në tefsir, fikh, hadith, akide dhe gjuhë arabe. Tefsiri i tij është një nga tefsiret më të mira të fikhut, sidomos të tefsirit të medhhebit malikij, të cilit i ka takuar. Ka qenë jashtëzakonisht modest dhe i devotshëm, i njohur me sjelljet e tij të mira ndaj dijetarëve tjerë, bile edhe atëherë kur nuk pajtohej në mendime. I pranonte qëndrimet me dëshmi më të forta, pa marrë parasysh medh-hebeve të cilat i kanë takuar.

Emri i tij i plotë është: Muhamed ibën Ahmed ibën Ebi Bekr ibën Ferh el-Ensari el-Hazrehi el-Endelusi Ebu Abdullah el-Kurtubi. Ka lindur në Kordoba të Spanjës, viti nuk është i njohur. Ka mësuar prej dijetarëve të dalluar të kohës, kështu që edhe vet u bë i tillë. Në kohën e tij ka lulëzuar kultura dhe qytetërimi islam, kështu që në atë kohë kushtet kanë qenë të volitshme për dijetarët si dhe për mësimin e diciplinave të ndryshme shkencore. Themeluesi i dinastisë së muvehidunëve, Muhamed ibën Tumert, sikurse kanë qenë edhe halifet tjerë të kësaj dinastie (514-668. hixhrij) ka qenë dijetar i dalluar i kohës së tij si dhe përkrahës i shkencës dhe studimit të saj. Kordoba ka qenë në zë, sepse në krahasim me qytetet e tjera të Spanjës në Kordobë ka pasur më së shumti libra dhe dijetarë të njohur. Kurtubiu është rritur në rreth të tillë, duke u arsimuar në

shkenca të ndryshme, për shembull: Kur'an dhe shkencat kuranore, tefsir, fikh, hadith, akaid, gjuhë arabe me të gjitha diciplinat e saj, poezi etj.

Më vonë shkoi në Egjiptin e epërmë, më saktësisht në Minja – në veri të Asjutës – ku jetoi deri në vdekje 671/1273. Biografët e tij theksojnë se ka qenë shumë modest dhe i devotshëm, dhe se e ka dashur thjeshtësinë dhe ka ikur nga jonatyrshmëria dhe rrejshmëria. Është përpjekur maksimalisht që veprat e tij t'i harmonizoj me parimet islame dhe me dijen të cilën e ka poseduar. Ka tentuar që kohën t'a shfrytëzoj maksimalisht, ose i është dhënë pas adhurimi ose ka shkruar vepra (libra). Shumë mirë i ka njohur shumë diciplina islame, posaqërisht tefsirin, për shkak të së cilës sot edhe e numërojnë në rradhën e kolosëve të tefsirit.

Kurtubiu si dijetar

Është e qartë se kushtet e volitshme në të cilat ka jetuar dhe punuar Kurtubiu, kanë ndikuar në formimin e personalitetit të tij dhe në atë se është zhvilluar në dijetar të dalluar. Në një rreth të tillë ai ka pasur rast të jetë në kontakt dhe të mësojë nga dijetarët më të dalluar dhe më meritore të kohës. Biografët i theksojnë emrat e shumë dijetarëve të tij, nga të cilët më të shquarit janë:

- Ebu Muhammed Abdulvehhab ibën Revaxh el-Iskenderani el-Maliki (648), muhadith i njohur.

- Behaiddin ebul-Hasan Ali ibn Hibetullah ibën Selame el-Misri esh-shafi', i njohur si: Ibnul-Xhumejzi (649), ekspert në hadith, fikh dhe në kiraete.

- Ebul-Abbas Ahmed ibën Umer ibën Ibrahim el-Maliki el-Kurtubi (656), komentator i Sahihut të Muslimit.

- El-Hasan ibën Muhamed ibën Amruk et-Timi en-Nejsaburi ebu Ali Sadruddin eEl-Bekri (656).

Përveç mësuesve të drejtëpërdrejt, nga të cilët ka qenë në kontakt të drejtëpërdrejtë, në veprat e Kurtubiut mund të shihet se ka përdorur ose se te ai ndikim të madh kanë pasur këta dijetarë:

- Muhamed ibën Xherir et-Taberi (310), dijetar i njohur në shumë fusha, i njohur në tefsir, fikh dhe histori.

- Ali Ibën Muhamed el-Maverdi (450), dijetar i njohur në shumë fusha, shumë kohë ka punuar si kadi.

- Ebu Bekr ibnul-Arebi (543), dijetari i njohur i Endelusit, autor i tefsirit të njohur të fikhut.

- Abdul-Hakk ibën Atijje el-Endelusi (542), i njohur me tefsirin e tij, edhe ky dijetar i cila ka jetuar në territorin e Spanjës së sotme.

- Ebu Xha'fer en-Nehhas.

Për diturinë e tij dëshmojnë edhe dijetarë të shumtë të kohës pas tij, të cilët i kanë lavdëruar veprat e tij, në rradh të parë tefsirin e tij. Për këtë arsye nuk çudit fakti nëse hasim në të dhënat se një numër jo i vogël i komentatorëve të Kuranit kanë përdorur veprat e tij dhe deri diku e kanë marrur si model. Është rasti për shembull me Ebu Hajjan el-Endelusijem (754), një mufesir i njohur spanjoll, pastaj me Ismail ibën Kethirin (774), autorin e njërit nga tefsirit më të pranuar të shkruar ndonjëherë, dhe me Muhammed ibën Ali Shevkanin (1255), dijetarin e njohur dhe autorin e tefsirit të mirënjohur.

Kurtubi ka qenë dijetar i frytshëm i cili ka shkruar shumë vepra, nga të cilat edhe sot e kësaj dite botohen dhe përdoren shumë nga to. Më të njohurat janë:

1. El-xhami'u li ahkamil-Kur'an, tefsiri i tij.

2. Kam'ul-hirsi biz-zuhdi vel-kana'ah.

3. El-Esna fi sherhi esmaillahil-husna.

4. Et-Tidhkar fi efdalil-edhkar.

5. Et-Tedhkire bi ahvalil-mevta ve ahvalil-ahireh.

6. Et-Takrib li kitabit-temhid.

7. Sherhut-tekassi.

8. El-i'lam bima fi dinin-nesara minel-mefasidi vel-evham ve idhharu mehasini dinil-islam.

9. Risale fi elkabil-hadith.

10. Kitabul-akdiqeh.

11. El-Misbah fil-xhem'i bejnel-ef'ali ves-sihah.

12. El-Muktebes fi sherhi Muvetta' Malik ibn Enes.

Tefsiri i Kurtubiut

Tefsiri i tij El-xhami'u li ahkamil-Kur'an është shumë i çmuar, sepse ai i ka vërejtur disa mangësi të mufesirëve të mëhershëm, andaj edhe në veprën e tij është përpjekur t'iu shmanget. Kështu për shembull, ai përmend shkakun e zbritjes, kiraetet, analizën gramatikore të ajeteve, i shpjegon shprehjet e vështira kuranore, shpesh mbështetet në rregulla gjuhësore dhe kuptimet e caktuar i dëshmon përmes poezisë, i rrëzon qëndrimet e mu'tezilinjve, kaderinjve, shiitëve, filozofëve dhe sufinjëve ekstrem. Nuk përmend tregime dhe legjenda të shumta, të cilat kanë qenë shumë të pranishme në tefsiret e mëparshme, vetëm se nganjëherë i përmend israilijate të caktuara. Për këto dhe cilësi tjera, Ibën Ferhuni i njohur për tefsirin e tij thotë: 'Ky është njëri ndër tefsiret më të vlefshëm dhe më të dobishëm. Autori nuk i

përmend tregimet dhe rrëfimet e pavërtetuar por tregon rregullat e kuranit dhe dëshmitë e shariatit. Përveç kësaj, ai i cek kiratet, analizën gjuhësore dhe ajetet e deroguar.

Në parathënien e tefsirit të tij thotë: 'Meqenëse Libri i Allahut është burim i të gjitha shencave të shariatit, që e vetma ajo e përmbanë farzin dhe sunetin dhe që i besueshmi i Qiellit (Xhibrili alejhi selam) ia ka dorëzuar të besueshmit të Tokës (Muhamedit salAllahu alejhi ue selem), kam vendosur që tërë jetën dhe forcën time t'ia kushtoj atij, në mënyrë që do të shkruaj komentim të përmbledhur, i cili do të përmbajë komentimin, analizën gjuhësore, kiratetet, përgjigjet të gjithë atyre të cilët kanë devijuar e humbur, shumë hadithe të cilët i mbështesin rregullat të cilat do t'i paraqesim si dhe shkaqet e shpalljes së ajeteve, duke e ndërlikuar kuptimin e tyre dhe duke i shpjeguar ato që janë më të vështira me fjalët e dijetarëve të hershëm e të mëvonshëm. Kjo vepër do të jetë përkujtues në këtë botë, rezervë në momentin e vdekjes dhe vepër e mirë në ahiret. Allahu thotë: 'Atë ditë njeriu do të informohet për atë çka ka përgaditur dhe çka ka lëshuar pa e vepruar.' I Lartësuar gjithashtu ka thënë: 'Çdokush do të marr vesh atë çka përgaditur dhe atë çka e ka lëshuar.' Ndërsa Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: 'Kur njeriu vdes, i ndërpriten të gjitha veprat e mira, përveç në tri raste: nga sadakaja rrjedhëse, vepër nga e cila njerëzit kanë dobi dhe fëmiu i hajrit i cili bënë dua për prindin e tij.'

Një nga parimet në këtë vepër është që qëndrimet do t'ua atribuoj atyre të cilët i kanë shqiptuar ato si dhe hadithet atyre të cilët i kanë shënuar ato, ngase ekziston një thënie: 'Një nga mirësitë e shkencës është edhe që fjaltë e thëna t'ia atribuojmë (mve-

shim) atij që i ka thënë ato. E shpesh ndodh që në veprat e fikhut dhe tefsirit nuk theksohen burimet e haditheve, kështu që vetëm ata që kanë dije për hadith dinjë për hadithin e cekur, e për këtë arsye ai që nuk e di këtë mbetet i pavendosur, ngase nuk e di se ai hadith është i vërtetë apo jo. Për njohjen e gjërave të tilla nevojitet dije e madhe. (...) Në tefsirin tim nuk do të ceku shumë tregime e rrëfime të mufesirëve dhe dijetarë të mëhershëm, vetëm atëherë kur të jetë e domosdoshme për shpjegimin e ajeteve. Vëmendje të posaqme do t'ia kushtoj ajeteve të cilat flasin për dispozita, duke i përpunuar temat të cilat ato i përbajnë e me të cilat zbulohet kuptimi i tyre dhe me të cilat kërkuesit të diturisë i tregohet në atë çka ato udhëzojnë. Pranë çdo ajeti i cili në vete përfshin një ose më tepër dispozita do të theksoj tërësi të posaqme në të cilat do të shpjegoj atë që është e lidhur me atë ajet: shkakun e shpalljes, shpjegimin e fjalëve më pak të njohura dhe dispozitat e shariatit. E kur të has në ndonjë ajet në të cilin nuk ka dispozita, atëherë do të cek vetëm komentimin e tij. Kështu do të veprojmë gjatë tërë komentimit të Kuranit...'

Pas kësaj pason hyrje më gjërë, rreth 100 faqe, në të cilën autori përpunon shumicën e temave në lidhje me shkencat kuranore, si dhe tema të caktuara nga fusha e shkencave të tefsirit. Përveç tjerash, në hyrje i shtjelloj këto tema:

- Vlera e Kur'anit dhe vlera e atij që studion dhe e atij që punon me të.
- Si të lexohet Kurani dhe çka është urrejtur e çka është e ndaluar gjatë kësaj.
- Paralajmërimin njohësve të Kur'anit dhe të shkencave islame ndaj dyfytërisë.
- Çfarë duhet të jetë ai i cili e lexon dhe i cili e studion Kuranin.
- Vlera e komentimit të Kuranit.

- Si të tregohet respekt dhe të madhërohet Kur'ani.
- Transmetimet rreth kërcënimeve ndaj atyre të cilët Kuranin e shpjegojnë sipas mendimit të tij, nivelet e mufesirëve dhe llojet e tefsirëve.
- Komentimi i Kur'anit me sunet.
- Si të studiohet dhe kuptohet Kur'ani dhe suneti.
- Shpallja e Kuranit në shtatë harfe.
- Kodifikimi i Kur'anit dhe përshkrimi i tij në kohën e Othmanit.
- Përgjigje hulumtuese dhe rafidinjëve në lidhje me besimet e tyre rreth Kur'anit.
- Renditja e sureve dhe ajeteve kuranore, si dhe numri i harfeve fjalëve dhe ajeteve në Kuran.
- A ekzistojnë në Kur'an fjalë joarabe?
- Karakteri mbinatyrallor i Kuranit.
- Hadithet për vlerën e sureve të caktuara kuranore.
- Komentimi i Istiadhes.
- Komentimi i Bismiles.

Në kapitullin ' Çfarë duhet të jetë ai i cili e lexon dhe i cili e studion Kuranin ', Kurtubiu jap këshilla të shumta dhe përmend shumë rregulla të cilave duhet t'iu përmbahet ai i cili e respekton Kuranin. Përveç tjerash ai përmend edhe këtë: 'Abdullah ibën Amr thotë: 'Hafizi i Kur'anit nuk duhet të jetë bashkëpjesëmarrës i atyre të cilët flasin gjithçka e as nuk duhet të jetë prej të paditurëve, por duhet të jetë i mëshirshëm dhe të fal për hir të Kur'anit, fjalës së Allahut, të cilën e mbanë në gjoksat e tij.' Ai duhet të ruhet nga çdo gjë e dyshimtë, të shmanget nga të qeshurit dhe të folurit e padobishëm atje ku lexohet Kurani sikurse edhe në vende tjera, të sillt arsyeshëm dhe me dinjitet. Ai duhet të jetë i butë ndaj të varfërve dhe t'i largohet mendajmadhësisë dhe hamendjeve, të largohet nga dunjallëku dhe njerëzit kur ka

frikë nga trazirat ndaj tij, t'i shmanget mos-pajtimeve dhe grindjeve si dhe të jetë i butë dhe i sjellshëm. Duhet të jetë prej atyre nga dëmi dhe e keqja e të cilit janë të sigurt të tjerët dhe nga i cili shpresohet vetëm e mira, nuk guxon të ndëgjohet që në praninë e tij shpifet, porse duhet që të shoqërohet me ata të cilët do t'a ndihmojnë në të mirë dhe do t'a nxisin në sinqeritet dhe sjellje të mirë, dhe do të kontribuojnë që të jetë pozitiv e jo negativ. Duhet t'i studioj dispozitat kuranore që t'a kuptoj se çka kërkon Allahu nga ai e çka ia ka bërë obligim atij, të ketë dobi nga ajo që e mëson nga Kurani dhe të punoj sipas asaj. Sa është keq që ai e di Kuranin përmendësh, i mëson urdhërat e tij a nuk kupton atë çka po e thotë! E si do të punoj me atë që nuk e kupton? Sa është keq që të pyetet për kuptimin e asaj çka e lexon e ai nuk e din atë! Shembulli i njeriut të tillë është shembulli i gomarit që bart libra!

Kurtubiu në tefsirin e tij i komenton të gjitha ajetet sipas renditjes në Mushaf, mirëpo vëmendje të posaqme ua përqendron ajete që kanë të bëjnë me dispozitat e fikhut, duke i parashtruar qëndrimet e ndryshme të dijetarëve dhe medh-hebeve në lidhje me dispozitat e ndryshme. Për këtë arsye tefsiri i tij numërohet në rradhët e tefsireve të fikhut, d.m.th, komenteve të Kuranit të cilët theks të veçant u japin komentimit të ajeteve në të cilat përmenden dispozitat e sheriatit. Pas ndonjë ajeti të caktuar, Kurtubiu tregon sa tema për të cilat është çështje përmbanë ajeti në fjalë, pastaj i shtjellon ato çështje, një nga një. Këtë e bënë mjaft detajisht, kështu që tefsiri i tij bënë pjesë ndër tefsirët e gjatë dhe zakonisht është i botuar në 20 pjesë (vëllime). Se sa është i hollësishëm dhe sa gjërësisht e komenton Kuranin shihet, për shembull, nga shpjegimi i istiadhes ku shtjellon 20 çështje, gjatë komentimit të Bis-

miles shtjellon 27 çështje, ndërsa Fatihën e komenton në 45 faqe.

Sikurse edhe dijetarët tjerë të Endelusit, Kurtubiu i ka takuar medh-hebit malikij. Mirëpo, për të është karakteristikë që nuk e ka pasuar medh-hebin e tij symbyllurazi, porse nganjëherë ka ditur edhe të shmanget nga ai, kur posedonte argument i cili i shkonte në dobi medh-hebit tjetër. Ky është virtyti i lavdëruar të cilën e kanë vërejtur edhe e kanë lavdëruar shumë dijetarë të mëvonshëm. Kështu për shembull, dr. Muhamed Husejn Dhehebiu për këtë karakteristikë të Kurtubiut thotë: 'Virtyti më i lartë i këtij njeriu është se nuk anon kah medh-hebi i tij malikij, por pason argumentin e sheriatit derisa të mos arrij të zgjedhja e cila konsiderohet si e saktë, pa marrë parasysh se kush e ka sjellur atë.' Kështu psh, duke e komentuar ajetin 43 të sures El-Bekare: 'Kryeni namazin dhe jepni zekatin...', ai përmend se kush përfaqëson mendimin se fëmiu i mitur nuk mund të prij xhematin në namaz, nga të cilët është edhe Maliku, pastaj kush ka mendim të kundërtë, e pastaj në bazë të hadithit të saktë nga Sahihu i Buhariut, sjell gjykimin e vet që mundet, ani pse me këtë është shmangur nga mendimi i bartësit të medh-hebit të tij.

Gjithashtu, duke komentuar ajetin 187 të sures El-Bekare, në të cilin flitet për agjërimin: 'dhe hani e pini derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim, e pastaj agjërimin plotësojeni deri në mbrëmje....', ai përmend qëndrimin e Malikut që agjëruesi, nëse gjatë agjërimit nga harresa hanë apo pinë, do t'a prish agjërimin dhe se duhet t'a kompensoj atë. Pastaj thotë se qëndrimi i shumicës së dijetarëve se në këtë rast nuk prishet agjërimi, dhe se i përmbahet këtij mendimi, me fjalët: 'Ky qëndrim është i drejtë dhe atë e përfaqësojnë shumica e dijeta-

rëve, dmth, se ai i cili hanë ose pinë nga harresa, atëherë agjërimi i tij është në rregull dhe se rrjedhimisht nuk ka nevojë që ta kompensoj atë ditë. Kjo shihet edhe nga hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejre në të cilin thuhet se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: 'nëse agjëruesi hanë ose pinë diçka nga harresa, ajo është mirësi të cilën ia ka dhuruar Allahu, andaj nuk ka nevojë që ta kompensoj atë ditë.' — ndërsa në verzionin tjetër thuhet: '...le t'a vazhdoj agjërimin, ngase Allahu e ka ushqyer dhe i ka dhënë të pij ujë!' Hadithin e shënon Darekutniu dhe thotë se zingjiri i transmetuesve është i vërtetë, dhe se të gjithë transmetuesit janë të besueshëm...'.

Një virtyt tjetër i lartë i Kurtubiut është se ai i respekton ithtarët e mendimit tjetër, me paanshmëri i përmend qëndrimet e tyre, nuk përdor fjalë të këqija për ta, edhe kur nuk e përkrahin qëndrimin dhe drejtimin e tij. Kjo nuk ka qenë kështu te paraardhësit e tij të tefsirit malikij Ibnul-Arebiut, e as te Xhesasiun e El-Kija el-Herrasiun, të cilët kanë qenë ithtarë të medh-hebit hanefij përkatësisht shafij. Ata në mënyrë të vrazhdë kanë ditur të dënojnë përkrahësitë e mendimeve dhe medh-hebeve të tjera, duke parashtruar nganjëherë edhe fjalë të liga e të vrazhda kundër tyre. Mirëpo, Kurtubiu në lidhje me këtë, ka qenë krejt ndryshe. Në mënyrë të paanshme paraqet qëndrimet e dijetarëve të të gjitha medh-hebeve, e pastaj e përkrah qëndrimin të cilin e konsideron më të saktin, pa marrë parasysh cilit medh-heb i takon. Nganjëherë e qorton edhe vet Ibnul-Arebiun, në rastet kur e tepron në vlerësimin dhe karakteristikat e përkrahësve të qëndrimeve dhe medh-hebeve të ndryshëm.

Në përgjithësi, nga kjo është e qartë se tefsiri i Kurtubiut ka vlerë të veçantë, kështu që nuk është çudi që edhe sot e kësaj dite

ai përjeton botime të reja. Posaqërisht është i rëndësishëm për studiuesit e ajeteve në lidhje me dispozitat, kështu që për të mund të thuhet se është tefsir i pashmangshëm. Për të dr. Dhehebiu, në mes tjerash thotë: 'Me pak fjalë, Kurtubiu, Allahu e mëshiroftë, është studiues i pavarur i tefsirit. Kritikon dhe hyn në diskutim dhe dialog në mënyrë

të hiejshme. Ka dije nga të gjitha diciplinat e tefsirit, mirëpo është edhe njohës i mirë i të gjitha diciplinave tjera në të cilat thellohet dhe për të cilat flet.' Dhe në fund, duhet treguar se tefsiri i tij një kohë të gjatë ka qenë dorëshkrim, dhe se është botuar tek në gjysmën e dytë të shekullit të 20.

Përktheu nga boshnjakishtja:
Ebu Eljesa
30.7.2004

Imam El-Lejthi

Imami, fekihi, muhadithi, dijetari i Egjiptit dhe krenaria e tij pa konkurrencë. Ishte i respektuar. Gjykatësit dhe sundimtarët e Egjiptit këshilloheshin më të. Halifeja Mensur deshi ta vendos në postin e sunduesit por ai refuzoi. Quhet Ebul Harith El Fehmi El Lejth ibën Sa'd ibën Abdur Rahman, është me prejardhje persiane, prej Asbehanit (Isfahan) në tokat e Persisë.

Është lindur në fshatin Karkashende në afërsi të Kairosë në vitin 94 H. Me punë të palodhshme tuboi dije me të cilën e arriti gradën e Imam Malikut, rahimehull-llah.

Nga mesi i mësuesve të tij do t'i përmendim imamët: Ata ibën Ebi Rebah, Ibën Ebi Mulejke, Nafi'un, Ibën Shihab, Jezid ibën Ebi Habib, Hisham ibën Urve, Ebu Zinad, Katade dhe shumë tjerë.

Nga ky det i dijes përfituan shumë imamë që jetonin në atë kohë të lavdëruar nga i Dërguari, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, siç janë: Ibën Lehi'ate, Ibën Vehb, Ibën El Mubarek, Ademi ibën Ebi Ijas, Jahja ibën Bukejr, Jahja ibën Ebi Jahja Et Temimi, Ahmed ibën

Junus etj.

Imam Shafi'iu thoshte: Lejthi është më i ditur se Imam Maliku por nxënësit e tij nuk e përhapën dijen e tij ashtu si duhej.

Jahja ibën Bukejr: Lejthi ishte më i ditur se Maliku por fati ishte në anën e Imam Malikut, All-llahu i mëshiroftë të gjithë.

Thoshte: sytë e mi nuk kanë parë njeri si El Lejthi.

Ibën Vehb: Kur Maliku në librat e tij thotë: Më ka lajmëruar njëri prej dijetarëve me të cilin jam i kënaqur, e ka për qëllim El Lejth ibën Sa'd-in.

Thoshte: Po të mos ishin Maliku dhe Lejthi njerëzit do të devijonin.

Uthman ibën Salih thoshte: Me hadithet që mbi vlerën e Uthmanit, radijall-llahu anhu, i transmetoi El Lejthi tek banorët e Egjiptit u kthye respekti ndaj Uthmanit, radijall-llahu anhu.

Imam Ahmed thoshte: El Lejthi ka shumë dije dhe hadithet i ka të sakta.

Kutejbe: gjithë namazet i falte në xhami dhe çdo ditë ushqente nga treqind të varfur.

El Ala ibën Kethir: Lejthi është i zgjedhuri prej neve, imami dhe dijetari jonë.

Ishte prej dijetarëve të pasur dhe pasurinë e tij nuk e kursente për shpenzimin në rrugën e All-llahut posaqërisht kur në pyetje ishin kërkuesit e dijës. Thoshte: Po të mos ishte kjo, me çallmat tona do zbukuroheshin pasanikët (me dijën tonë do të krenoheshin pasanikët që na kanë ndihmuar).

Thoshte: Asnjëherë nuk më është bërë obligim zekati. (Tërë pasurinë që kishte e harxhonte brenda vitit)

Asnjëherë nuk e shtronte sofrën e tij pa mysafir. Kur e vizitoi Mensur ibën Ammari e ndihmoi me një mijë dinarë të arrit. Kur Ibën Lehi'a-së iu dogjë shtëpia e ndihmoi ate me një mijë dinarë.

Kur e vizitoi Medinën, Maliku ia dërgoi një enë me hurma të cilën ai ia ktheu me një mijë dinarë në të.

Jeta e tij në këtë botë përfundoi me 15 Sha'ban të vitit 175 H.

Halid ibën Abdus Selam Es Sadefi kështu e përshkruante xhenazën e tij: Isha i pranishëm në varrimin e El Lejthit dhe nuk kam parë xhenaze në të cilën morrën pjesë aq shumë njerëz. Të gjithë ishin të pikëlluar sikur kur bëhet fjalë për ndonjë të afërt. E pyeta babën: Sikur gjithë të pranishmit janë familja e të vdekurit e ai m'u përgjigj: Biri im, nuk do të shosh njeri si ky merhum...

All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë.

Përgatiti: Talha Kurtishi

Për më gjëresisht shiko: Sijer El A'lam En Nubela, vëll. 8, fq. 136-163
6.8.2004

El Hafidh el-Iraki

El Hafidh Zejnud-din el-Iraki. Imami, autoriteti, al-lameja, hafidhi i dalluar me precizitetin dhe intelektin unik, njeriu që dinte mënyrat e leximit të Kur'anit (kira'at) dhe ishte ekspert në lëminë e hadithit dhe shkencat e tij. Me aftësitë e tija ai ia kaloi mocanikëve të tij dhe dijetarëve të kohës. Nga pena e tij u shkruan shumë libra të dobishme prej të cilave njerëzit përfitojnë edhe në këto kohëra. Kush është ky njeri?

Quket Abdur Rahim ibën Husejn ibën Abdur Rahman ibën Ebu Bekr ibën Ibrahim El Kurdi Er Razijani El Misri Esh Shafi'ij. Është me prejardhje kurde nga fshati Rezejan në afërsi të Irbilit, Iraku verior. Pak para

lindjes së tij i ati i tij shpërngulet për jetesë në qytetin e Kairosë ku edhe lind hafidh El Iraku. Më 21 Xhumadel Ula të vitit 725 H.

Pasiqë mësoi shkrim leximin ai iu përkushtua Kur'anit të cilin e mësoi përmendsh që në moshën tetëvjeçare. Në fillim të kërkimit të diturisë mirrej me mësimin e mënyrave të leximit të Kur'anit (kira'at) derisa nuk u takua me Imam Izzuddin ibën Xhema'a i cili e këshilloi të fillon të studion hadithin. Pas kësaj këshille El Iraku iu përkushtua tërësisht shkencës së hadithit. Përfitoi nga dijetarët e Egjiptit, disa herë udhëtoi në qytetet e Sirisë si dhe në Mekke dhe Medine. Gjatë këtij udhëtimit vizitoi shumicën e qyteteve në të cil-

ët kishte transmetues të hadithit. Kishte dëshirë të viziton Bagdadin gjë kjo të cilën e la përshkak të rrezikut gjatë udhëtimit dhe për shkak të dijetarëve të pakët që ishin në Bagdad.

Nga mësuesit e tij prej të cilëve përfitoi do t'i përmendim:

Esh Shihab Ahmed ibën El Baba.

Alauddin ibën El Turkumani El Hanefi, para të cilit lexoi Sahihun e Imam Buhariut.

Ibën Shahid El Xhejsh, para të cilit gjithashtu lexonte Sahihun e Imam Buhariut.

Ali ibën Abdul Hadi, para të cilit lexoi Sahihun e Muslimit.

Ali Ebul Fet'h El Mejdumi, para të cilit lexoi më tepër se një libër.

Një kohë të gjatë kaloi në praninë e El Al-lai-ut në Mekke nga i cili përfitoi shumë.

Imaduddin Muhammed ibën Is'hak El Belbisi, para të cilit mësonte librat e fikhut.

Xhemaluddin Muhammed ibën Ahmed El Esnevi, para të cilit mësonte në lëminë e baza-ve të fikhut (el usul) i cili shpesh herë dëgjonte mendimet e nxënësit dhe thoshte logjika e tij është e shëndoshë, ajo nuk e pranon gabimin.

Shumicën e kohës Hafidh El-Iraki e kalonte në lexim shkrim dhe ligjërata.

Disa nga virtytet e tij:

El Hafidh Tekijuddin ibën Rafi' thoshte: El Kadi Ibën Xhema'a dhe Abdur Rahimi (El Iraki) janë të vetmit dijetarë të hadithit në Kairo.

Ibën Xhema'a thonte: Çdokush që përpos tij pretendon dijen e hadithit nuk e flet të vërtetën.

Kështu e përshkruanin: Ishte njeri i mirë i dalluar, fetar, i përmbajtur, i ndershëm, modest, me moral të mirë, i ndritur dhe i bukur në fytyrë, i qetë, nuk fliste shumë dhe folte fjalë të thjeshta që kuptoheshin, kujdesej shumë për pastërtinë.

Dallohej me turpshmëri, nuk kishte armi-

qësi me asnjërin, i butë dhe shpirtgjërë, nuk hidhërohej përpos për çështje madhore, kujdesej që mos t'u drejtohet njerëzve me fjalë që nuk u pëlqejnë, e fliste të vërtetën dhe nuk frikohej nga qortimi i qortuesit kur në pyetje ishte feja e All-llahut. Nuk frikohej nga sulltanët e as nga emirët kur ishte në pyetje e vërteta. Ishte i ashpër kur kërkohesh ashpërsia, i butë kur kërkohesh butësia.

Kur'anin e lexonte shumë, falte namaz të natës dhe agjëronte nafilë. Pas namazit të sabahut ulej në xhami dhe priste lindjen e diellit.

Librat e tij:

- Ihbarul Ahja an Ahbaril Ihja

- El Mugni an Hamilil esfar fi tehrixh ma fil Ihja minel Ahbar (ky libër ishte shkaku i afër sipas dëshmisë së tij personale që Muhadithi i kohës tonë Muhammed Nasiruddin Albani, rahimehull-llah, të fillon studimin e gjërë në lëminë e hadithit)

- El Keshf el Mubin an Tahrixh Ihja Ulumid Din (këto tre libra janë tahrixh i haditheve dhe transmetimeve në librin "Ihjau Ulumid-Din" të Ebu Hamid el-Gazali sh.r.)

- Tekribul Esanid ve Tertibul Mesanid një pjesë e të cilit e komentoj në librin Tarhu Tethrib bi sherhi Et Tekrib

- Et Tebsire ve Tedhkire

- Et Tekjid vel Idah li kitab Ibën Salah

- En Nexhm El Veh-haxh fi nedhm El Minhaxh

- Ed Durer Es Sunnije fi nedhm Es Sijer Ez Zekijje

- Kurretul Ajn bi vefaid Dejn

- El Isti'adhetu bil Vahid min ikameti Xhumu'atejn fi mekanin vahid etj.

Jeta e tij në këtë botë përfundoi në Kairo më 8 Sha'ban të vitit 806 H. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë. Amin.

Përgatiti: Talha Kurtishi
13.8.2004

Tema: Kurani

Numri: 1183

Data: 13.08.2004

Pyetje:

Kuptimi i përemrit "Ne" siç është i përdorur në Kur'an?

Përgjigje:

Është një karakteristikë e stilit letrar arab që folësi mund ta referojë veten me përemrin nahnu (Ne) për respekt ose madhërim. Ai mund gjithashtu të përdorë fjalën ene (unë) duke treguar një tjetër ose një të tretë hu-ua (Ai). Të tre këto stilet janë të përdorura në Kur'an, ku Allahu i adresohet arabëve në vet gjuhën e tyre. (Fetava el-Lexhne ed-Daime, 4/143)

Allahu, subhanehu ve teala ngandonjëherë i referohet vetes së Tij në njëjës, me emër ose duke përdorur një përemër dhe ngandonjëherë përdorë shumësin, si në: "Ne ty të dhamë (vendosëm për) një fitore të sigurt". [Feth 48: 1] dhe të tjera të ngjashme. Por Allahu kurrë nuk i referohet Vetes së Tij në shumës duke nënkuptuar se është më shumë se Një, kjo sepse ky shumës i referohet respektit që Ai meriton dhe mund t'i referohet emrave dhe attributeve të Tij...". (El-Akide et-Tedmurije nga Shejhul Islam Ibën Tejmijje, f. 75)

Këto fjalë, inna ("Me të vërtetë Ne") dhe nahnu ("Ne") dhe forma të tjera të shumësit mund të përdoren nga cilido folës që flet për një grup ose ata mund të përdoren nga një folës për qëllime respekti ose madhështie, siç është bërë nga shumë mbretër kur ata japin dëshmi ose urdhëra në të cilat ata thonë "Ne kemi vendosur..." etj. Në të tilla raste vetëm një person është duke folur por shumësi është përdorur për respekt. E Ai i cili që e meriton më shumë respektin është Allahu, subhanehu ve teala, kështu kur Ai thotë në Kur'an inna ("Me të vërtetë Ne") dhe nahnu ("Ne"), është për respekt dhe madhërim, jo për të treguar shumësinë numërore. Nëse një ajet i këtij lloji duket se shkakton konfuzion, është esenciale të referohet ajeteve tjera të qarta, të paturbullta për sqarim dhe nëse një i krishter për shembull polemizon duke marrë ajete si: "Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij". [El-Hixhr 15: 9] si fakt për shumësin e hyjnisë, ne mund ta refuzojmë këtë thënie duke cituar ajete të qarta si:

"Zoti juaj (që meriton adhurim) është një, All-llahu, nuk ka zot pos Atij që është Mëshirëplotë, Gjithnjëmëshiron" [el-Bekare 2: 163] dhe "Thuaj: Ai, All-llahu është Një!". [el-Ihlas 112: 1] dhe të tjera ajete të cilat mund të interpretohen vetëm në një mënyrë.

Kështu konfuzioni do të zhduket për atë i cili është duke kërkuar të vërtetën. Çdo herë kur Allahu e përdor shumësin për t'iu referuar Vetes së Tij, është e bazuar mbi respekt dhe

nderin që meriton dhe numrit të madh të emrave dhe attributeve të Tij dhe numrit të ushtrive dhe melekëve të Tij. (El-Akide et-Tedmurije nga Shejhul Islam Ibën Tejmijje, faqe 109)

Jahja Adil Ibrahim
Marrë nga: i s l a m . n e t
Përktheu Ammar Ardit Kraja
13.08.2004

Numri: 597

Data: 27.02.2001

Pyetje:

...A ka fjalë të gjuhëve të tjera përveç gjuhës arabe në Kuran?...

Përgjigje:

Falënderojmë All-llahun, paqa dhe mëshira qofshin mbi Muhammedin.

Dijetarët kanë dy mendime kryesore rreth kësaj:

Pala e parë: thonë se s'ka asnjë fjalë të huaj në Kuran, edhe ato që janë, janë të arabizuara, ose në origjinë kanë qenë arabe, e pastaj i kanë përdorur edhe joarabët.

Sepse All-llahu i Lartësuar në Kuran thotë:

"Ne e zbritëm atë Kur'an arabisht, ashtu që ta kuptoni". (Jusuf: 2).

"Sikur Ne ta bënim Kur'anin në gjuhë të huaj, ata do të thoshin: "Përse nuk janë ajetet e tij të kuptueshme (të shkoqitura), a është ai (Kur'ani) në gjuhë të huaj, kurse ai (pejgamberi) është arab?" (Fussilet: 44)

Duke u nisur nga këto argumente Imam Shafiu, Ibn Xheriri dhe disa dijetarë tjerë kanë thënë se s'ka fjalë të huaja në Kuran, kurse

Pala e dytë thotë: se ka disa fjalë të huaja në Kuran, mirëpo ato janë shumë pakë, duke marur për argument ekzistimin e emrave, si psh. Ibrahim, etj...

Disa dijetarë kanë thënë se në Kuran ka prej të gjitha gjuhëve, sepse i është dedikuar mbarë njerëzimit. Dhe pasi që secili pejgamber i është dërguar popullit të vet me gjuhën e vet, kurse Pejgamberi alejhisselam është dërguar te mbarë popujt, atëhere patjetër se në Librin, i cili i është shpallur duhet të ketë prej çdo gjuhe.

Argument tjetër kanë sepse këto fjalë të gjërave që janë përmendur në Kuran, nuk kanë qenë të njohura për arabët, andaj përdorimi i tyre në origjinal është më me dobi dhe efekt.

Disa të tjerë kanë thënë se ka fjalë joarabe në Kuran, mirëpo ato janë të arabizuara, andaj edhe nuk konsiderohen joarabe. Kështu ai që thotë nuk ka fjalë joarabe e ka thënë të vërtetën sepse ato fjalë janë arabizuar dhe ai që thotë se ka fjalë joarabe e ka të vërtetën, sepse ato fjalë origjinën e kanë joarabe. All-llahu e di më së miri.

Marrë nga libri: "El-Itkan fi Ulumil-Kuran", Imam Sujuti, 2/105-108.

Bekir Halimi
13.03.2001

Numri: 231

Data: 05.01.2001

Pyetja:

Pse kapitulli 9 nuk përmban "bismilahun"?

Përgjigje:

Falënderojmë All-llahun, paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin.

Ka shumë mendime rreth kësaj çështje, disa kanë thënë se përmbajtja e këtyre dy sureve është e ngjajshme (me suren e mëparshme sh.r.) andaj nuk ka nevojë për ndarje me besmelën, kurse disa kanë thënë se kjo sure përmban luftë kundër pabesimtarëve, andaj nuk ka nevojë për përmendje të mëshirës, e cila gjindet në besmelën. All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi, 13.03.2001

Numri: 99

Data: 08.12.2000

Pyetja:

Cilat janë 6 suret të cilat ia kanë thinjur flokët Muhammedit a.s. nga brengat?

Përgjigje:

Falënderojmë All-llahun, kurse paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Vëlla i nderuar! Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Më kanë thinjur sureja Hud dhe suret simotra të saja: El-Vakia, Murselat, Amme jetesaelun, Idhash-shemsu kuvirret". hadithi është sahih.

Bekir Halimi, 31.01.2001

Një sqarim nga dy hadithe

1- Abdull-llah ibën Muavije El-Gadiri, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Kush i vepron tre gjëra e ka shijuar shijen e besimit: ai që adhuron All-llahun që është Një dhe se përveç Tij hyjni tjetër nuk ka, ai që jep zekatin e pasurisë së tij me vet-dëshirë, për çdo vjet, e nuk jep plakati, të ultat, të sëmurat e as këqijat (e begatisë sh.r.), por kualitetin mesatar të pasurisë së tij, sepse All-llahu nuk ua kërkon më të mirën e as nuk u ka urdhëruar ta jepni më të keqen". Në transmetimin tjetër qëndron: "dhe e pastron shpirtin". Një njeri tha: çka është pastrimi i shpirtit? Tha: "Ta dijë se All-llahu, az-ze ve xhel-le, është me te ku do që është ai". (Es-sahiha, nr. 1046).

Përfitim nga hadithi:

Për thënien e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: " Ta dijë se All-llahu, az-ze ve xhel-le, është me te ku do që është ai", Imam Muhamed ibën Jahja Dhuheliu, rahimehull-llah, thotë:

"Ka për qëllim se dija e All-llahut kaplon çdo gjë, kurse All-llahu është mbi Arsh". Këtë citat e përmend Imam Dhehebiu në librin e tij "El-Uluv", nr. 73 me redaktimin dhe revizionin tim.

Kurse thënia e masës së gjërë dhe një pjese të madhe të njerëzve me dije se All-llahu gjindet çdo kund, ose në mbarë ekzis-

tencën, duke patur për qëllim se gjindet me "Zat" Qenien e Tij, kjo shprehje pa dyshim se është devijim, madje e marrë nga ata që thonë për njëjësimin e ekzistencës (vahdetul-vuxhud), thënie të cilën e thonë sufistët ekstrem, të cilët nuk bëjnë dallim mes Krijuesit dhe krijesës, madje më i madhi i tyre thotë: "Çdo gjë që sheh me syrin tënd është All-llahu!". I lartësuar qoftë All-llahu nga kjo që thonë ata.

2- Abdull-llah ibn Amri, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Të mëshirshmit i mëshiron i Mëshirshmi, tebareke ve teala. Mëshironi ata që janë në tokë që t'ju mëshirojë Ai që është në Qiell. Mëshira është e këputër nga i Mëshirshmi, andaj ai që e lidhë ate, All-llahu e lidh, e kush e këputë ate, All-llahu e këputë". ("Es-Sahiha", nr. 925).

Përfitim nga hadithi:

Ky hadith është prej argumenteve të shumta se All-llahu, subhanehu ve teala, është mbi mbarë krijesat. Për këtë qëllim ka shkruar Hafidh Dhehebiu librin e tij "El-Uluv Li-Allijjil-Gaffar", të cilin libër unë e kam rezytuar dhe i kam shtuar hyrjen, i kam përpunuar hadithet dhe gjurmët nga selefi dhe e kam pastruar nga lajmet e dobëta. El-hamdulillah që All-llahu e lehtësoi botimin e tij".

Muhammed Nasiruddin Albani

Marrë nga: Silsiletu Ehadithis-Sahiha, hadithi nr.925 dhe nr. 1046

Përktheu: Bekir Halimi

13. Durimi

Transmeton Ebu Seid S'ad ibën Malik ibën Sinan El Hudriu, radijallahu anhu, se disa njerëz prej Ensarëve kërkuan diç prej Pejgamberit, salallahu alejhi ve sel-lem, e ai iu dha, ata përsëri kërkuan dhe ai përsëri iu dha derisa u harxhua gjithë ajo që pati, pastaj Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, iu tha: të gjitha të mirat që i posedoj nuk do t'i magazinohet për t'iu privuar nga ato, mirëpo ai i cili përmbahet (nga lypja) Allahu e bën të përmbajtur, atij që i majfton ajo që e posedon Allahu e pasuron, ai i cili soditë thellë Allahu ia ndriçon mendimin kurse asnjërit nuk i është dhënë ndonjë gjë më e mirë se sabri (durimi). (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "O ju besimtarë, bëni durim, bëhuni të qëndrueshëm kundër armikut, rriini të përgaditur dhe, që të shpëtoni, ruajuni dënimit të All-llahut. (Ali Imran-200), " Thuaj: "O robërit e Mi që keni besuar, keni frikë ndaj Zotit tuaj. Ata që bënë mirë në këtë jetë, kanë të mirë të madhe, e Toka e All-llahut është e gjërë, ndërsa të durueshmive u jepet shpërblimi i tyre pa masë!" (Zumer-10)

Erragib thotë: sabri etimologjikisht d.m.th. të përmbajturit në vështirësi kurse ne terminologji do të thotë: përmbyllja e vetes brenda vijave që i ka caktuar logjika dhe sheriatu.

Ibën Haxheri gjatë definimit të sabrit thotë: sabri është mbyllja dhe pengimi i vetes – fjalëve apo veprave - nga hakmarrja në raste dëmtimi. Ndonjëherë përdoret edhe me kuptimin "butësi" (hilm). Disa dijetarë kanë thënë: durimi gjatë mundimeve është xhihad ndaj egos. Allahu, subhanehu ve teala, e ka bërë natyrën e shpirtit (egos) që të ndiej dhimbje e ngashëri nëse dëmtohet me fjalë ose vepra, për këtë arsye Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, e gjeti veten në gjendje shumë të rëndë kur ia mveshën atij padrejtsinë gjatë ndarjes së plaçkës së luftës, mirëpo ai u sjell me butësi ndaj akuzuesit dhe bëri durim sepse e dinte shpërblimin e madh që fitojnë durimtarët dhe se Allahu, subhanehu ve teala, u jep të mira të panumërta. Durimtari ka shpërblim më të madh se ai që shpenzon pasurinë e tij në rrugë të Allahut, sepse shpërblimi i të dytit shumfishohet deri në shtatëqind herë edhe pse e mira ne esencë shpërblehet me dhjetë të ngjashme përveç nëse Allahu dëshiron që ta shumfishoj.

Në hadithin e sipërpërmendur vihet në pah vlera e madhe e sabrit si dhe nxitja në të. Sabri është cilësi e lavdëruar, virtyt i dëshiruar, moral i rrallë, përfundimin e ka të lakmuar, pasojat e kënaqshme, është dobiprurës i madh, shansë për të menduar në atë që të sjell dobi, të ngadalëson në marrjen e qëndrimeve derisa dobia të jetë e vërtetuar dhe rezultati i siguruar.

Sabri është tre llojesh:

1. Sabri ndaj vështirësive që hasim gjatë kryerjes se obligimeve fetare.

2. Sabri ndaj asaj që është e ndaluar në fenë e Allahut duke lënë pas shpine mëkatet, kënaqësitë e ndaluara, si dhe përpjekja që të mos iu afrohem atyre, nënshtrimi i epshit dhe frenimi i tij për të mos rënë në amoralitete. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: E kush iu frikësua paraqitjes para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve, Xhenneti është vendi i tij." (Naziat – 40, 41)

3. Sabri në fatkeqësitë e dhimbshme, tragjeditë befasuese dhe në sprovimet çkado që të jenë shkaqet.

Muslimani është i obliguar që të bëjë durim në kryerjen e obligimeve fetare dhe në të kapurit për fenë e Allahut, Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "O ju që keni besuar, kërkonin ndihmë me durim e me të falur, se vërtetë All-llahu është me durimtarët." (Bekare-153), "O ju që besuat, kur të konfrontoheni me ndonjë grup, përqëndrohuni dhe përmendni çdo herë All-llahun që të arrini fitoren e dëshiruar." (Enfal-45)

Sabri ndaj peripetive në rrugën e da'ves (thirrjes islame) është prej virtytetve të Pejgamberëve alejhim selam, lidhur më këtë Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Ti (Muahamed) duro, ashtu sikurse duruan të dër-

guarit e vendosur" (Ahkaf-35), sepse me sabër dhe bindje arrihet grada më e lartë në fe "prijja" – imamllëku, siç thotë Allahu, subhanehu ve teala, "Dhe prej tyre Ne bëmë prijës që me urdhërin Tonë udhëzojmë, pasi që ata (që i bëmë prijës) ishin të durueshëm dhe ndaj argumenteve Tona ishin të bindur." (Sexhde-45)

Këshillimi i njëri tjetrit për të bërë sabër është prej karakteristikave të shoqërisë islame, Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "E pastaj të bëhej prej atyre që besuan, që këshilluan njëri-tjetrin për durim dhe që këshilluan për mëshirë (për ndihmë)." (Beled-17)

Thënë në përgjithësi ai i cili bën sabër duke kërkuar me këtë Fytyrën e Allahut, subhanehu ve teala], përfundimi i tij është Xhenneti, Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Edhe ata që patën durim (ndaj të këqia) për të fituar kënaqësinë e Zotit të tyre dhe që e falën namazin, dhe nga ajo me çka Ne i furnizuar ata kanë dhënë fshehtas e haptas dhe me të mirë e largojnë të keqen. Të tillët kanë përfundim më të mirë. (përfundimi i mirë është) Xhennete të Adnit (vende të përjetshme) ku do të hyjnë ata, edhe prindërit, gratë dhe fëmijët e tyre të cilët kanë qenë vepërmirë ata do t'i vizitojnë engjëjt duke hyrë në secilën derë. (u thonë) Selamun alejkum, me durimin tuaj gjetët shpëtimin; sa përfundim i lavdishëm është ky vend." (RR'ad-23, 23, 24)

Dije se njerëzit që më së tepërmi sprovohen janë "pejgamberët, pastaj ata më të ngjashmit e më të ngjashmit. Çdonjëri sprovohet sipas të kapurit të tij për fenë, nëse të kapurit të tij është i fortë sprovimi është më i fortë, nëse në të kapurit e tij për fenë ka dobësi atëherë sprovohet sipas asaj dobësie. Vazhdimisht njeriu do të sprovohet derisa të ecë mbi tokë pa asnjë mëkat." (Transmeton Tirmidhiu i cili thotë: hadithi është hasen sahih)

Shembujt që flasin për sabrin e pejgamberëve janë të shumtë. Ibrahim dhe Ismaili alejhima selam pranuan urdhërin e Allahut me zemërgjërësi dhe sabër derisa Allahu ia lehtësoi Ismailit duke i dhënë një kurban. Nuhu, salallahu alejhi ve sel-lem, përjetoi nga populli i tij shumë pengime dhe mospërfillje mirëpo duroi e Allahu, subhanehu ve teala, i fundosi në ujin e vërshuar të gjithë përveç atyre që besuan atë. Poashtu Jakubi, Jusufi, Ejjubi, Musai, Zekerijjau, Jahja, Isai alejhim selam u sprovuan dhe duruan.

Zotëriu i të gjithë njerëzve, Muhamed ibën Abdullahu, salallahu alejhi ve sel-lem, përjetoi peripeti dhe vështirësi të mëdha nga populli i Taifit. Mendjelehtit, fëmijët dhe robërit e këtij populli e gjuajtën më gurrë derisa ia përgjakosën këmbët, si dhe para kësaj dhe pas ai përjetoi mundime të shumta nga kurejshitët pabesimtarë, më pastaj në Medine bëri sabër dhe luftoi derisa vuri themelet e shtetit më të madh që e njohi njerzimi dhe themelet e shoqërisë më të mirë që e pa njerëzimi.

Shejhul Islam Ibën Tejmijje, rahimehullah, thotë: Allahu, subhanehu ve teala, ka përmendur në Kur'an braktisjen e bukur (hexhër), faljen e bukur të gabimeve dhe durimin e bukur dhe në lidhje me këto është thënë: braktisje e bukur është ajo që bëhet pa cenim, falje e bukur kur ajo bëhet pa qortim kurse sabër i bukur kur nuk ka ankime te krijesat. Ahmed ibën Hanbelit duke qenë në shtrat të vdekjes i është lexuar se Tavusi ka urretur këlthitjet e vdekjes dhe ka thënë: të klithish don të thotë të ankohesh te njerëzit, pas kësaj ai (Ahmedi) nuk ka këlthitë deri sa ka vdekur. Sa i takon ankimeve te Krijuesi kjo gjë nuk e mohon sabrin e bukur siç tregon Allahu, subhanehu ve teala, fjalët e Jakubit, salallahu alejhi ve sel-lem, në Kur'an: "Ai (Jakubi) tha: "Jo, çështjen ua lehtësoi epshi juaj. (mua nuk më ka mbetur tjetër) Durim i mirë, është shpresë që All-llahu do të m'i sjellë të gjithë; Ai është më i dijsmi, më i urti!", "Ai (Jakubi) tha: "Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim, ia parashtroj All-llahut, e unë di për All-llahun atë që ju nuk dini". (Jusuf-83, 86)

Abdulaziz ibën Revvad ka thënë: tre gjëra janë prej thesarit të Xhennetit: fshehja e fatkeqësisë, sëmundjes dhe lëmoshës"

Abdullah ibën Muhamed elHerevij ka thënë: prej margaritarëve të mirësisë është fshehja e fatkeqësisë.

Aun ibën Abdullahu ka thënë: mirësia në të cilën nuk ka aspak të keqe është falenderimi Allahun duke qenë rehat dhe sabri gjatë fatkeqësisë.

Ahmed Muadh Hakkij

Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: katërdhjet hadithe mbi moralin)